



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2020 – Numri: 205

Tiranë – E hënë, 23 nëntor 2020

PËRMBAJTJA

	Faqe	
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 894, datë 18.11.2020	Për kalimin në përgjegjësi administrimi të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës të pasurisë 4/63-N129, të llojit “njësi”, me sipërfaqe 230 m ² , zona kadastrale 8514, Njësia Administrative Durrës, dhe për një shtesë në vendimin nr. 448, datë 16.6.2005, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi zyrës qendrore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme”, të ndryshuar.....	14489
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 895, datë 18.11.2020	Për një ndryshim në vendimin nr. 270, datë 2.5.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për pjesëmarrjen e personelit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë në Misionin e Kombeve të Bashkuara në Sudanin e Jugut (UNMISS)”, të ndryshuar.....	14492
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 899, datë 18.11.2020	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 921, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për personelin e administratës doganore”, të ndryshuar.....	14492
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 901, datë 18.11.2020	Për një shtesë në vendimin nr. 656, datë 31.10.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e masës së shpërblimit të anëtarëve të këshillave, bordeve ose komisioneve të përhershme të njësive të qeverisjes qendrore”, të ndryshuar.....	14493
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 902, datë 18.11.2020	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurisë së paluajtshme, pronë private, që preket nga ndërtimi i objektit “Rrjeti shpërndarës 20 kV, nënstationi Pogradec, fideri 1, 9, 10, rikonstruksion kabina, kabina të reja dhe linjë TU me përcjellës me vetëmbajtje ABC”.....	14494
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 903, datë 18.11.2020	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarit të pasurisë së paluajtshme, pronë private, që preket nga projekti “Ndërhyrje në infrastrukturën e rrugëve ‘Andrea Papaj’ degëzimi 1 djathtas, degëzimi 2 djathtas, Lushnjë”.....	14495

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 906, datë 18.11.2020	Për kalimin në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, të pronës shtetërore, me numra pasurie 46, 47, 48, 49, 50, 63, 64, 65, 66, pjesë e zonës kadastrale nr. 8517, Bashkia Durrës, Njësia Administrative Durrës, në zonën e ish-Kënetës, Spitalë.....	14496
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 907, datë 18.11.2020	Për kostot dhe mënyrën e mbulimit të shpenzimeve të sistemit të identifikimit të kafshëve dhe të regjistrimit të fermave blegtorale.....	14497
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 909, datë 18.11.2020	Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës së përfitimit të ndihmës financiare për punonjësit dhe ish-punonjësit e rafinerisë së naftës, Ballsh.....	14497
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 910, datë 18.11.2020	Për përdorimin e fondit të rindërtimit, për financimin e rindërtimit të konviktit të shkollës së mesme profesionale “Kolin Gjoka”, Bashkia Lezhë dhe caktimin e Bashkisë Lezhë si njësi zbatuese.....	14508
Vendim i Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut nr. 48756/14, datë 4.8.2020	Çështja Tërshana kundër Shqipërisë.....	14509
Vendim i Këshillit të Lartë të Prokurorisë nr. 260, datë 17.11.2020	Mbi funksionimin e komisionit disiplinor në zhvillimin e procedurave disiplinore ndaj prokurorëve.....	14534
Vendim i Këshillit të Lartë të Prokurorisë nr. 261, datë 17.11.2020	Për miratimin e rregullores “Për transferimin e prokurorëve nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele”.....	14550



VENDIM
Nr. 894, datë 18.11.2020

PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI TË AGJENCISË SHETËTËRORE TË KADASTRËS TË PASURISË 4/63-N129, TË LLOJIT “NJËSI”, ME SIPËRFAQE 230 m², ZONA KADASTRALE 8514, NJËSIA ADMINISTRATIVE DURRËS, DHE PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 448, DATË 16.6.2005, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHETËTËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI ZYRËS QENDRORE TË REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 13, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në përgjegjësi administrimi të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës të pasurisë 4/63-N129, të llojit “njësi”, me sipërfaqe 230 (dyqind e tridhjetë) m², zona kadastrale 8514, Njësia Administrative Durrës, sipas formularit gjithsej 1 (një) fletë, hartës treguese dhe planimetrisë, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij, me qëllim ushtrimin e funksioneve administrative të drejtorisë vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Durrës.

2. Pasuria e përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, i shtohet listës së inventarit të miratuar me vendimin nr. 448, datë 16.6.2005, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar.

3. Ngarkohet Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

1. FORMULAR PER INVENTARIZIMIN E PRONAVE TE PALUAJTSHME SHETËTËRORE
(Per inventarizimin e pronave te veçanta)

A				B			C			
Nr. Rend.	Zona Kadastr. & Indeksi i Hartës	Nr. Pasurisë	Lloji i Pronës	Emri i Pronës Adresa	Sip. Totale e Pronës m ²	Nga Sip. Totale: Sa Ndertese (m ²)	Funksioni per te cilin perdoret Prona	Institucioni / Enti me pergjegjese administrative	Institucioni / Enti perdorues Statusi juridik i perdorimit	Te dhena te tj (Shenime te veç)
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
1	8514 Dr,K-6	4/63-N129	Njësi	Ambiente të ASHK Durrës Rruga Skënderbej /4		230	Administratë	ASHK	Drejtoria Vendore ASHK Durrës	Vol 32 Fq 203

Drejtoria Vendore e ASHK Durrës

Identifikoi: **ILIR GJINALI** Specialist Hartograf
(emri, mbiemri, pozicioni zyrtar)

Supervizoi: **Albana Gjoni** Pergjegjese e Sektorit te shprehmeve te Sportelit te Kadastrës
(emri, mbiemri, pozicioni zyrtar)

Aprovoi: **Artur Çobani** Drejtor
(emri, mbiemri, pozicioni zyrtar, tel., firma, vulg)

Fusha e përdorimit të Pronës: Administratë.

Stampa: KADASTRALE - SHETËTËRORE - DURRËS



HARTA TREGUESE E REGJISTRIMIT

DREJTORIA VENDORE E AGJENCISE A. IDENTIFIKIMI I PASURISE

SHTETETORE TE KADASTRES

ZONA KADASTRALE 8514 NR.PASURISE 4/63-N129 VOL. 32 FQ. 203

INDEKSI I HARTES DR: K - 6 SHKALLA 1:500 SIP. = 230 m²

DURRES

ADRESA E PASURISE : Rrethi Durres Q/ë DURRES

Rr/L SKENDERBEJ / 4 P/B --- Sh --- K --- Ap ---

DREJTOR

B. KUFIZIME

C. PRONARI

V. PASURIA Nr ---

L. PASURIA Nr ---


J. PASURIA Nr ---


P. PASURIA Nr ---

SHTET

ARTUR COBANI

D. Data 24 / 09 / 2020 Ora 12:00







VENDIM

Nr. 895, datë 18.11.2020

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 270, DATË 2.5.2019, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PJESËMARRJEN E PERSONELIT TË FORCAVE TË ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË MISIONIN E KOMBEVE TË BASHKUARA NË SUDANIN E JUGUT (UNMISS)”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikave 2 e 5, të nenit 6, të ligjit nr. 9363, datë 24.3.2005, “Për dërgimin e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë jashtë vendit, si dhe për mënyrën e procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; të shkronjës “ç”, të nenit 11, të ligjit nr. 64/2014, “Për pushtetet dhe autoritetet e drejtimit e të komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; dhe të aktit normativ nr. 1, datë 20.3.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për pjesëmarrjen e personelit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë në misionin e Kombeve të Bashkuara në Sudanin e Jugut (UNMISS)”, miratuar me ligjin nr. 23/2019, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në pikën 1, të vendimit nr. 270, datë 2.5.2019, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, data 15.3.2021 ndryshohet dhe bëhet 22.9.2021.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTËR
Edi Rama**

VENDIM

Nr. 899, datë 18.11.2020

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 921, DATË 29.12.2014, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PERSONELIN E ADMINISTRATËS DOGANORE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 7, pika 3, 8, pika 12, e 15, të ligjit nr. 102/2014, “Kodi doganor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në pjesën VIII/1, të vendimit nr. 921, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

a) Në pikën 1, shkronja “a”, pas nënndarjes “ii”, shtohet nënndarja “ii/1”, me këtë përmbajtje:

“ii/1. Koordinator i Rrjetit Antikorrupsion.”;

b) Në pikën 1, shkronja “b”, pas nënndarjes “ii”, shtohet nënndarja “ii/1”, me këtë përmbajtje:

“ii/1. Koordinator i Rrjetit Antikorrupsion luan një rol të posaçëm në luftën kundër korrupsionit, duke mbledhur, analizuar e koordinuar të gjithë informacionin për rastet korruptive të referuara nga burime të ndryshme. Koordinator raporton pranë strukturës përgjegjëse për antikorrupsion, në ministrinë përgjegjëse për çështjet e antikorrupsionit, me qëllim parandalimin e goditjen e korrupsionit në administratën doganore, si dhe vlerësimin e rrezikut kundër korrupsionit dhe propozimin e rregullave për menaxhimin e këtij rreziku.”;

c) Në pikën 2, shkronja “d”, në fund të nënndarjes “i”, shtohen paragrafët, me këtë përmbajtje:

“Koordinatori i Rrjetit Antikorrupsion emërohet e lirohet nga drejtori i Përgjithshëm i Doganave pas marrjes së propozimit nga ministri përgjegjës për çështjet e antikorrupsionit, në rolin e Koordinatorit Kombëtar kundër Korrupsionit, për një afat 2- (dy-) vjeçar”.

Koordinatori i Rrjetit Antikorrupsion përgjigjet para ministrit përgjegjës për çështjet e



antikorrupsionit për të gjithë veprimtarinë e ushtruar në rolin e koordinatorit, pjesë e rrjetit.

Koordinatori, në ushtrimin e detyrës e sipas nevojës, ka të drejtë të kërkojë mbështetje nga Drejtoria Antikorrupsion dhe e Standardeve Profesionale, si dhe nga strukturat e tjera doganore.

Detyrat, përgjegjësitë e koordinatorit, mënyra e funksionimit të rrjetit të koordinatorëve antikorrupsion, sistemi elektronik specifik, aksesit në të, përcaktohen me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi për çështjet e antikorrupsionit.”

2. Në aneksin nr.1 bëhen shtesat dhe ndryshimet, si më poshtë vijon:

a) Te zyra e drejtorit të Përgjithshëm, poshtë rreshtit “Drejtor i Përgjithshëm”, shtohet rreshti si vijon:

Koordinatori i Rrjetit Antikorrupsion		1	
---------------------------------------	--	---	--

b) Totali i numrit për zyrën e drejtorit të Përgjithshëm të bëhet 8 (tetë);

c) Numri i pozicioneve “specialist”, në sektorin e Koordinimit për Mashtrimet Fiskale, në Drejtorinë e Hetimit, të bëhet 7 (shtatë);

ç) Totali i numrit të punonjësve për Drejtorinë e Hetimit të bëhet 24 (njëzet e katër) dhe totali i punonjësve për Departamentin Operativo-Hetimor të bëhet 206 (dyqind e gjashtë).

3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM

Nr. 901, datë 18.11.2020

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 656, DATË 31.10.2018, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E MASËS SË SHPËRBLIMIT TË ANËTARËVE TË KËSHILLAVE, BORDEVE OSE KOMISIONEVE TË PËRHERSHME TË NJËSIVE TË QEVERISJES QENDRORE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 4, të ligjit nr. 10405, datë 24.3.2011, “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe shpërblimeve”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në fund të lidhjes nr. 1, të përmendur në pikën 3, të vendimit nr. 656, datë 31.10.2018, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, shtohet tabela që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Efektet financiare për Komitetin Ndërinstitucional për Masat Kundër Krimit të Organizuar fillojnë nga momenti i funksionimit të këtij komiteti dhe përballohen nga buxheti i Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, nga të ardhurat e realizuara nga administrimi i pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara.

3. Ngarkohet Ministria e Brendshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

Tabela

Emërtesa e Bordit/Këshilli/Komisionit	Numri maksimal i pagesave në një vit	Përbërja		Masa e shpërblimit në Lekë	
		Kryetari	Nr. i Anëtarëve	Kryetari	Anëtari
Komiteti Ndërinstitucional për Masat Kundër Krimit të Organizuar	12	1	8	20,000	20,000



VENDIM
Nr. 902, datë 18.11.2020

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURISË SË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKET NGA NDËRTIMI I OBJEKTIT “RRJETI SHPËRNDARËS 20 kV, NËNSTACIONI POGRADEC, FIDERI 1, 9, 10, RIKONSTRUKSION KABINA, KABINA TË REJA DHE LINJË TU ME PËRCJELLËS ME VETËMBAJTJE ABC”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 88/2019, “Për buxhetin e vitit 2020”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurisë së paluajtshme, pronë private, që preket nga ndërtimi i objektit “Rrjeti shpërndarës 20 kV, nënstacioni Pogradec, fideri 1, 9, 10, rikonstrukcion kabina, kabina të reja dhe linjë TU me përcjellës me vetëmbajtje ABC”.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a.

3. Pronarët e pasurisë së paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, në shumën e përgjithshme prej 4 999.68 (katër mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë pikë gjashtëdhjetë e tetë) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, në shumën 4 999.68 (katër mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë pikë gjashtëdhjetë e tetë) lekë, të përballohet nga Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a.

5. Vlera për shpenzimet procedurale, në shumën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, të

përballohet nga fondet e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë.

6. Afati i përfundimit të shpronësimit të jetë brenda tre muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

7. Pronarët e pasurisë së paluajtshme, pronë private, të pasqyruar në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, do të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin për likuidim, certifikatën e pronësisë, kartelën e pasurisë si dhe hartën treguese të regjistrimit, në zyrat e Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a.

8. Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike të kryejë procedurat për likuidimin e pronarëve të pasurisë së paluajtshme, pronë private, të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.

9. Afati i përfundimit të punimeve të jetë në përputhje me afatet e parashikuara.

10. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Pogradec, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Operatorin e Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a., të fillojë procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale të regjistrimit, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar dhe të bëjë kalimin e pronësisë për pasurinë e shpronësuar në favor të Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a.

11. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Pogradec, të pezullojë të gjitha transaksionet me pasurinë e shpronësuar, deri në momentin kur do të realizohet procesi i hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartat kadastrale dhe kalimi i pronësisë në favor të Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a.

12. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a., Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Pogradec dhe Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës pranë këshillit të Qarkut Korçë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama



LISTA EMËRORE E PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I OBJEKTIT “RRJETI SHPËRNDARËS 20 kV, NËNSTACIONI POGRADEC FIDERI 1, 9, 10, RIKONSTRUKSION KABINA, KABINA TË REJA DHE LINJË TU ME PËRCJELLËS ME VETËMBAJTJE ABC”

Nr.	Numri i kabinës	Emër	Atësia	Mbiemër	Lloji i pasurisë	Zona Kadastrale	Nr. i Pasurisë	Sip. totale (m ²)	Sip. e prekur (m ²)	Çmimi truall lek/m ²	Vlera në lek	Shënime në kartelë
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	14	15
POGRADEC, VENDORE ZONA KADASTRALE 3745												
1	1/8 Kalceto	Luan Selviko Edison	Feti Selman Luan	Musollari Musollari Musollari	Arë	3745	29/1/31	2000	26.04	192	4999.68	Konfirmuar nga ASHK-ja Drejtoria Vendore Pogradec Bashkëpronësi
Vlera paraprake e shpronësimit											4999.68	

Për tokën “are” çmimi i llogaritur është marrë nga VKM nr. 89, datë 3.2.2016.

**VENDIM
Nr. 903, datë 18.11.2020**

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARIT TË PASURISË SË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKET NGA PROJEKTI “NDËRHYRJE NË INFRASTRUKTURËN E RRUGËVE ‘ANDREA PAPAJ’ DEGËZIMI 1 DJATHTAS, DEGËZIMI 2 DJATHTAS, LUSHNJË”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarit të pasurisë së paluajtshme, pronë private, që preket nga projekti “Ndërhyrje në infrastrukturën e rrugëve ‘Andrea Papaj’ degëzimi 1 djathtas, degëzimi 2 djathtas, Lushnjë”.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Bashkisë Lushnjë.

3. Pronari i pasurisë së paluajtshme, pronë private, që shpronësohet, të kompensohet në vlerë të plotë sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasurinë e llojit tokë “truall”, me vlerë 136 996 (njëqind e tridhjetë e gjashtë mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e gjashtë) lekë.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 136 996 (njëqind e tridhjetë e gjashtë mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e gjashtë) lekësh, të përballohet nga Bashkia Lushnjë.

5. Shpenzimet procedurale, në shumën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga buxheti i

vitit 2020, miratuar për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë.

6. Afati i përfundimit të shpronësimit të jetë brenda tre muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

7. Pronari i pasurisë së paluajtshme, pronë private, i pasqyruar në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, do të kompensohet, për efekt shpronësimi, pasi të ketë paraqitur certifikatën e pronësisë, kartelën e pasurisë si dhe hartën treguese të regjistrimit, në zyrat e Bashkisë Lushnjë.

8. Bashkia Lushnjë të kryejë procedurat për likuidimin e pronarit të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.

9. Përfundimi i punimeve të jetë në përputhje me afatet e parashikuara në kontratat e lidhura nga Bashkia Lushnjë me sipërmarrësit e punimeve.

10. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Lushnjë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Bashkinë Lushnjë, të fillojë procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale të regjistrimit, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar dhe të bëjë kalimin e pronësisë për pasurinë e shpronësuar në favor të Bashkisë Lushnjë.

11. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Lushnjë, të pezullojë të gjitha transaksionet me pasurinë e shpronësuar, deri në momentin kur do të realizohet procesi i hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale dhe kalimi i pronësisë në favor të Bashkisë Lushnjë.

12. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Bashkia Lushnjë dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Lushnjë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR

Edi Rama

Faqe | 14495



LISTA E PRONARIT TË PASURISË, PRONË PRIVATE, QË SHPRONËSOHET NGA REALIZIMI I PROJEKTIT “NDËRHYRJE NË INFRASTRUKTURËN E RRUGËVE ‘ANDREA PAPAJ’ DEGËZIMI 1 DJATHTAS, DEGËZIMI 2 DJATHTAS, LUSHNJË”

Vlerësimi i tokës truall dhe tokës arë është llogaritur bazuar në VKM-së nr. 89, datë 3.2.2016.

Nr.	Emër Mbiemër	Lloji i pasurisë	ZK	Nr. i pasurisë	Sip. totale m ²	Sip. e shpronësuar m ²	Çmimi (lek)	Vlera totale për shpronësim	Shënime
1	Harallamb Mihail Çeka	Truall	8572	14/138	760	15.3	8954	136,996.00	Konfirmuar nga ZVRPP-ja Lushnjë, me shkresën nr. 5064/1 prot., datë 5.7.2018 + vërtetimin hipotekar datë 30.8.2018.
Vlera totale					760			136,996	

VENDIM
Nr. 906, datë 18.11.2020

PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI TË MINISTRISË SË INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË, TË PRONËS SHTETËRORE, ME NUMRA PASURIE 46, 47, 48, 49, 50, 63, 64, 65, 66, PJESË E ZONËS KADASTRALE NR. 8517, BASHKIA DURRËS, NJËSIA ADMINISTRATIVE DURRËS, NË ZONËN E ISH-KËNETËS, SPITALLË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, të pronës shtetërore, me numra pasurie 46, 47, 48, 49, 50, 63, 64, 65, 66, pjesë e zonës kadastrale 8517,

Bashkia Durrës, Njësia Administrative Durrës, në zonën e ish-Kënetës, Spitalle, me vendndodhje dhe sipërfaqe sipas aneksit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Pronat e përcaktuara në pikën 1, të këtij vendimi, do të përdoren nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë për zhvillimin e një parku fotovoltai.

3. Sipërfaqes së zonës teknologjike dhe zhvillimit ekonomik, të shpallur me vendimin nr. 262, datë 6.4.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për shpalljen e zonës së teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik në Spitalle, Durrës”, i hiqen pronat shtetërore të përcaktuara në pikën 1, të këtij vendimi.

4. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

ANEKSI I

Zona kadastrale 8517, Bashkia Durrës, njësia administrative Durrës

ZONIMI	Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sip. ha
ZONA FOTOVOLTAIKE	8517	46	arë	14,25
	8517	63	arë	11,72
	8517	64	arë	12,72
	8517	65	arë	12,27
	8517	66	arë	12,35
	8517	47	arë	14,10
	8517	48	arë	14,00
	8517	49	arë	14,60
	8517	50	arë	13,50

119,51
KANALE: 1,34
TOTALI: 120,85

**VENDIM****Nr. 907, datë 18.11.2020**

**PËR KOSTOT DHE MËNYRËN E
MBULIMIT TË SHPENZIMEVE TË
SISTEMIT TË IDENTIFIKIMIT TË
KAFSHËVE DHE TË REGJISTRIMIT TË
FERMAVE BLEGTORALE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës e të pikës 2, të nenit 7, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kafshët dhe fermat blegtorale identifikohen e regjistrohen, sipas programit kombëtar të identifikimit dhe të regjistrimit (IR) të hartuar nga struktura përgjegjëse për veterinarinë në ministrinë përgjegjëse për veterinarinë.

2. Të gjithë termat e përdorur në këtë vendim kanë të njëjtin kuptim me ata të përcaktuar në nenin 4, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, ndërsa termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

a) “Pronar ose kujdestar”, çdo person fizik apo juridik, që ka në pronësi kafshët ose është i ngarkuar të kujdeset për kafshët, me ose pa shpërblim financiar;

b) “Bazë materiale për procesin e identifikimit të kafshëve dhe regjistrimin e fermave blegtorale”, identifikuesit e kafshëve, regjistrat, pasaportat, kartelat, certifikatat shëndetësore veterinarë për lëvizjen e kafshëve dhe formularët për regjistrimin e kafshëve.

3. Kostoja e blerjes së bazës materiale për procesin e identifikimit të kafshëve dhe regjistrimin e fermave blegtorale përballohet nga buxheti i shtetit i alokuar për veterinarinë.

4. Vendosja e matrikujve, plotësimi i formularëve të identifikimit të kafshëve dhe të regjistrimit të fermave blegtorale, përditësimi e ndryshimet në Sistemin e Informacionit Blegtoral dhe Veterinar (RUDA) dhe lëshimi i certifikatave shëndetësore veterinarë për lëvizjen e kafshëve kryhen nga shërbimi veterinar rajonal, pa pagesë. Shpenzimet përballohen nga buxheti i shtetit i alokuar për veterinarinë.

5. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, fondi i grumbulluar nga shitja e matrikujve në llogarinë e të ardhurave jashtë limitit të përdoret për blerjen e bazës materiale për procesin e identifikimit të kafshëve dhe regjistrimin e fermave blegtorale.

6. Vendimi nr. 957, datë 7.12.2016, i Këshillit të Ministrave, “Për pagesën e kostos financiare të sistemit të identifikimit dhe regjistrimit të kafshëve dhe fermave blegtorale nga fermerët”, shfuqizohet.

7. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTËR
Edi Rama**

VENDIM**Nr. 909, datë 18.11.2020**

**PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE,
TË DOKUMENTACIONIT DHE TË
MASËS SË PËRFITIMIT TË NDIHMËS
FINANCIARE PËR PUNONJËSIT DHE
ISH-PUNONJËSIT E RAFINERISË SË
NAFTËS, BALLSH**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr. 88/2019, “Për buxhetin e vitit 2020”, të ndryshuar, propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:**I. TË PËRGJITHSHME**

1. Dhënie ndihme financiare prej 40 000 (dyzet mijë) lekësh në muaj për punonjësit dhe ish-punonjësit e rafinerisë së naftës, Ballsh, sipas listës bashkëlidhur këtij vendimi, për periudhën nëntor 2020–tetor 2021.

2. Punonjësvë, sipas pikës 1, të këtij kreu, t’u paguhen kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për periudhën nëntor 2020–tetor 2021, duke iu transferuar fondi përkatës Institutit të Sigurimeve Shoqërore dhe Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor.

**II. KRITERET DHE DOKUMENTA-
CIONI PËR PËRFITIMIN E NDIHMËS
FINANCIARE**



1. Ndhimja financiare llogaritet dhe jepet çdo muaj për punonjësit e rafinerisë së naftës, Ballsh, për periudhën nëntor 2020–tetor 2021.

2. Ndhimën financiare e përfitojnë punonjësit si më sipër, pavarësisht nëse kanë përfitur apo jo ndihmë financiare më parë.

3. Aplikimi për të përfitur ndihmën financiare për punonjësit të cilët nuk kanë përfitur ndihmë financiare, sipas vendimit nr. 305, datë 16.4.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e procedurës, të dokumentacionit dhe të masës së përfitimit të ndihmës financiare për të punësuarit aktualë dhe të larguarit nga puna si pasojë e COVID-19”, bëhet nga vetë subjekti/individit nëpërmjet dorëzimit elektronik të të dhënave të përcaktuara në pikën 4, të këtij kreu.

Miratimi kryhet pas verifikimit të kriterëve, bazuar në të dhënat që administrata tatimore disponon apo të dhënave që të punësuarit do të dorëzojnë.

4. Subjekti/individit aplikues duhet të paraqesë, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, elektronikisht, të dhënat e përfituesit, ku përfshihen:

a) të dhënat identifikuese të subjektit tatimpagues të pajisur me NIUS ku janë/kanë qenë të punësuar;

b) të dhënat identifikuese të individit, si:

i. emrin, mbiemrin e përfituesit;

ii. numrin personal të identifikimit të përfituesit;

iii. bankën ku përfituesi ka llogarinë rrjedhëse bankare;

iv. IBAN-in e llogarisë bankare.

III. PROCEDURA E VERIFIKIMIT PËR PËRFITIMIN E NDIHMËS FINANCIARE

1. Administrata tatimore, brenda 5 (pesë) ditëve pune nga data e aplikimit, verifikon në sistemin tatimor, identifikon aplikuesit dhe të dhënat në kërkesën e tyre, duke verifikuar tatimpaguesin nëse është apo jo përfitues i ndihmës financiare.

2. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, pas verifikimeve sipas pikës 1, të këtij kreu, përpilon listat përmbledhëse të përfituesve, të ndara për çdo bankë të nivelit të dytë ku përfituesit kanë llogarinë rrjedhëse bankare. Për çdo listë përmbledhëse, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve përgatit një urdher shpenzim të cilin ia paraqet Degës së Thesarit Tiranë për ekzekutim. Paralelisht me dërgimin e urdhrimit të shpenzimit në Degën e Thesarit Tiranë, Drejtoria e Përgjithshme e

Tatimeve paraqet në bankën respektive të nivelit të dytë listën përmbledhëse të individëve përfitues të ndihmës financiare, me qëllim transferimin e shumës së çdo individit në llogarinë e tij rrjedhëse, pranë kësaj banke. Lista përmbledhëse e individëve përfitues të ndihmës financiare, që paraqitet pranë bankës së nivelit të dytë, duhet të përmbajë të dhënat e mëposhtme:

a) emrin, mbiemrin e përfituesit;

b) numrin personal të identifikimit të përfituesit;

c) bankën ku përfituesi ka llogarinë rrjedhëse bankare;

ç) IBAN-in e llogarisë bankare.

3. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve ruan dhe administron dokumentacionin e përcaktuar sipas këtij vendimi, sipas dispozitave ligjore e nënligjore të parashikuara për ruajtjen e dokumentacionit dhe arkivat.

4. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor miratojnë rregullat procedurale për zbatimin e këtij vendimi.

IV. MASA E NDIHMËS FINANCIARE

1. Ndhimja financiare, që përfitojnë punonjësit / ish-punonjësit, përcaktohet në kreun I, të këtij vendimi.

2. Ndhimja financiare do të jepet çdo muaj për periudhën nëntor 2020–tetor 2021.

V. ÇËSHTJE TË FUNDIT

1. Efekti financiar për dymujorin nëntor–dhjetor 2020, në masën 92 261 140 (nëntëdhjetë e dy milionë e dyqind e gjashtëdhjetë e një mijë e njëqind e dyzet) lekë, të përballohet nga fondi i alokuar Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve për dhënien e ndihmës financiare sipas paketave përkatëse për përballimin situatës së krijuar nga COVID-19. Efekti financiar, për vitin 2021, në masën në masën 461 305 700 (katërqind e gjashtëdhjetë e një milionë e treqind e pesë mijë e shtatëqind) lekë, përballohet nga buxheti i vitit 2021, nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit.

2. Ngarkohen ministri i Shtetit për Rindërtimin, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama



ANEKS 1
LISTA EMËRORE E PUNONJËSVE/ISH
PUNONJËSVE PËRFITUES

	Emër	Mbiemër
1	Fiqiri	Agalliu
2	Hysni	Agalliu
3	Arjol	Filipi
4	Përparim	Agalliu
5	Fëllëzë	Xhaferaj
6	Adrian	Rapi
7	Qerem	Agalliu
8	Adrian	Haraj
9	Adriatik	Ferhataj
10	Xhevit	Agalliu
11	Adriatik	Duro
12	Afërdita	Zizolli
13	Afërdita	Llaka
14	Kastriot	Ahmetaj
15	Rudin	Dervishaj
16	Bashkim	Ajbikaj
17	Arben	Aliaj
18	Vangjel	Hoxhaj
19	Bledar	Aliaj
20	Brunilda	Aliaj
21	Fadil	Aliaj
22	Agim	Gjoka
23	Faik	Aliaj
24	Fiqirete	Ahmeti
25	Agim	Iliazi
26	Iris	Velçani
27	Dajlan	Shehaj
28	Agim	Veliaj
29	Luan	Aliaj
30	Luan	Aliaj
31	Syrja	Duraj
32	Luan	Aliaj
33	Shkelqim	Aliaj
34	Avni	Alliaj
35	Lefter	Alliaj
36	Amarildo	Osmënaj
37	Bardhul	Merkaj
38	Agron	Alushaj
39	Agron	Alushaj

40	Sokrat	Alushaj
41	Bukurosh	Sadikaj
42	Luan	Arranjaku
43	Agron	Zanaj
44	Ali	Asllanaj
45	Kareman	Asllanaj
46	Petrit	Asllanaj
47	Gjinovefa	Shehaj
48	Erjon	Avdulaj
49	Kastriot	Avdulaj
50	Leonard	Avdulaj
51	Mirela	Avdulaj
52	Mirela	Banaj
53	Qani	Baraj
54	Albana	Tushe
55	Tefta	Baraj
56	Albert	Çobaj
57	Albert	Kodhelaj
58	Aleksandër	Mici
59	Ylli	Baraj
60	Xhuljano	Duraj
61	Dano	Barjamaj
62	Aleksandër	Mejdani
63	Aleksandër	Fiku
64	Fatmir	Barjamaj
65	Novrus	Barjamaj
66	Përparim	Barjamaj
67	Aleksandër	Vasili
68	Teferi	Shehaj
69	Artur	Begaj
70	Batjar	Begaj
71	Tafil	Arizi
72	Flamur	Begaj
73	Alit	Kuçuku
74	Bilbil	Bektashaj
75	Gëzim	Bendaj
76	Ramadan	Bendaj
77	Ervis	Muhametaj
78	Xhevair	Bendaj
79	Arben	Arap
80	Afrim	Resulaj
81	Bilbil	Bendo
82	Erikseni	Sulaj



83	Eliana	Kapllani
84	Ballëm	Myrtaj
85	Andrea	Zotaj
86	Arben	Ngresi
87	Elton	Kapllani
88	Mimoza	Bendo
89	Mynyr	Bendo
90	Barjam	Binjaku
91	Hateme	Binjaku
92	Iirjana	Naka
93	Vladimir	Binjaku
94	Flori	Brakaj
95	Ardjan	Llanaj
96	Fetah	Bektashaj
97	Albenc	Zotaj
98	Arben	Brahimaj
99	Arbër	Brahimaj
100	Ardjan	Ajdinaj
101	Arian	Korini
102	Aristir	Moçi
103	Todi	Llagone
104	Agur	Brahushaj
105	Gëzim	Brahushaj
106	Kozma	Kule
107	Xhelal	Merkaj
108	Arjan	Allkaj
109	Valentina	Asimetaj
110	Sabri	Brahushaj
111	Elmir	Ymeraj
112	Edmond	Braka
113	Xhevair	Braka
114	Arjan	Rapushi
115	Riza	Brakaj
116	Ilmie	Imeralilaj
117	Fatime	Lamaj
118	Zamir	Llapashtica
119	Arqile	Gjata
120	Xhemil	Sinaj
121	Arqile	Bushi
122	Artur	Bregasi
123	Mystehak	Çakaj
124	Artan	Voshtina
125	Pranvera	Hysenaj

126	Lulzime	Sulka
127	Myzafer	Llanaj
128	Artan	Spahillari
129	Artur	Ibro
130	Mbarime	Minaj
131	Ramis	Çakaj
132	Gjenci	Lila
133	Asqeri	Caushaj
134	Artur	Metanaj
135	Laver	Caushaj
136	Asqeri	Zyka
137	Shkelqim	Çaushaj
138	Ritvan	Beqiraj
139	Ajet	Çelaj
140	Arjan	Çelaj
141	Flamur	Çelaj
142	Gazment	Çelaj
143	Astrit	Pasha
144	Idajet	Çelaj
145	Agron	Dautaj
146	Luan	Dautaj
147	Zamira	Xhafaj
148	Sokol	Dautaj
149	Viktor	Dautaj
150	Bujar	Dervishaj
151	Bukuroshe	Salaj
152	Skënder	Dervishaj
153	Ferdi	Sulejmanaj
154	Mitat	Duraj
155	Zinaida	Ahmetaj
156	Avni	Dervishi
157	Shkëlqim	Duraj
158	Malo	Buzi
159	Durim	Durraj
160	Kareman	Durraj
161	Gani	Dushkaj
162	Bardhyl	Çela
163	Zyrako	Matohitaj
164	Juljan	Sulaj
165	Vitmon	Çakaj
166	Elena	Elmazaj
167	Pllumb	Elmazaj
168	Vladimir	Fezaj



169	Yzedin	Fejzaj
170	Bedri	Ferzaj
171	Kujtim	Filaj
172	Kujtim	Filaj
173	Baço	Aliaj
174	Dule	Çelaj
175	Saimir	Filaj
176	Razim	Gega
177	Teuta	Gega
178	Flamur	Goxhaj
179	Ilmi	Goxhaj
180	Eltjon	Pashaj
181	Lindita	Hajdaraj
182	Bedri	Llakaj
183	Bedri	Sakaj
184	Florentina	Merkaj
185	Edlira	Hajdinaj
186	Petrit	Hajdinaj
187	Kalem	Hysenaj
188	Behar	Luto
189	Perllat	Beqaj
190	Luan	Halimi
191	Thanas	Prifti
192	Behar	Reçica
193	Eriselda	Bitraj
194	Idai	Beraj
195	Spiro	Goga
196	Astrit	Hanaj
197	Xhevaire	Hanaj
198	Gëzim	Hasanaj
199	Besnik	Koroveshaj
200	Ramadan	Hasanaj
201	Sotiraq	Papa
202	Bexhet	Korçari
203	Jetnor	Hasanbashaj
204	Petrit	Hasanbashaj
205	Artan	Hasani
206	Faik	Hasani
207	Qani	Hasani
208	Eduart	Haxhiaj
209	Vjollca	Haxhiaj
210	Bledar	Manxharaj
211	Adrian	Hazizaj

212	Astrit	Hazizaj
213	Kastriot	Hazizaj
214	Genci	Myftaraj
215	Arber	Osmani
216	Shahin	Malaj
217	Servet	Beqiraj
218	Kozeta	Rista
219	Arjan	Hodaj
220	Fatmir	Hodaj
221	Gramos	Hodaj
222	Adrian	Hoxha
223	Hyqmet	Asllanaj
224	Fatmir	Hoxha
225	Bujar	Sino
226	Burbuqe	Salaj
227	Liljana	Hoxha
228	Lulzim	Hoxha
229	Zakije	Skëndaj
230	Xhevahir	Metaj
231	Hair	Lezaj
232	Violeta	Hoxha
233	Ali	Hoxhaj
234	Et'hem	Manxhari
235	Tefik	Zylalaj
236	Bujar	Hoxhaj
237	Eduart	Hoxhaj
238	Vullnet	Agaj
239	Dritan	Avllaj
240	Dritan	Mullaj
241	Nazif	Skënderaj
242	Ridvan	Salaj
243	Festim	Hoxhaj
244	Andelina	Myrtellari
245	Hajdër	Hoxhaj
246	Mitat	Hoxhaj
247	Artan	Hoxhallari
248	Beshir	Halla
249	Fisnik	Sopa
250	Qemal	Hoxhallari
251	Avni	Hysenaj
252	Erjon	Hysenaj
253	Jasin	Sulejmani
254	Edlira	Shkëlzeni



255	Sulçe	Mingaj
256	Faik	Hysenaj
257	Floresha	Hysenaj
258	Bihënë	Skënderaj
259	Erjon	Islamaj
260	Edmond	Plepi
261	Aleksandër	Ismailaj
262	Ylmi	Veizaj
263	Laze	Harizaj
264	Edmond	Iljazi
265	Arta	Rizaj
266	Ardjan	Isufaj
267	Rapi	Serjani
268	Liljana	Isufaj
269	Xhevdet	Isufaj
270	Agur	Jahaj
271	Silva	Selami
272	Esat	Taullaj
273	Selam	Hoxhaj
274	Elena	Zoi
275	Dashnor	Ismailaj
276	Elvira	Hamitaj
277	Elvira	Omari
278	Brunilda	Jahaj
279	Emiljano	Cenaj
280	Endrit	Jahaj
281	Bezat	Ymeraj
282	Muharem	Sulaj
283	Bastri	Sabaj
284	Endrit	Pupi
285	Enver	Maçastena
286	Enver	Xhaferraj
287	Donald	Sulkaj
288	Sabaudin	Troka
289	Nezir	Muçaj
290	Festim	Jahaj
291	Feim	Shpata
292	Kastriot	Jahaj
293	Novrus	Jahaj
294	Shpëtim	Jahaj
295	Ylli	Jahaj
296	Ismet	Manaj
297	Nevreze	Toska

298	Engjëll	Xhanari
299	Bujar	Jaupaj
300	Anila	Troka
301	Redion	Rrapaj
302	Ferdinant	Jaupaj
303	Asaf	Yzeiraj
304	Marjus	Jaupaj
305	Olsi	Suloavdulaj
306	Tatjana	Jaupaj
307	Viktor	Jaupaj
308	Seit	Jazaj
309	Rajmonda	Kalemaj
310	Ervin	Toraj
311	Rajmonda	Kalemaj
312	Selman	Kamaj
313	Arjan	Kapaj
314	Hazbi	Ymeraj
315	Arjan	Kapaj
316	Klement	Muhametaj
317	Dano	Kapaj
318	Zaçe	Muçi
319	Gëzim	Kapaj
320	Fatbardha	Dino
321	Merjeme	Ferzaj
322	Habil	Hoxha
323	Gjolek	Isufaj
324	Klevis	Leli
325	Sabri	Kapllanaj
326	Ferko	Saliaj
327	Fatmir	Delibashi
328	Hateme	Kasaj
329	Vilson	Muçaj
330	Tomor	Kasaj
331	Erald	Liçaj
332	Agim	Koçiaj
333	Arben	Koçiaj
334	Fatmir	Fetahu
335	Stoli	Xhemalaj
336	Festim	Lalaj
337	Sami	Lalaj
338	Adem	Lamaj
339	Nazime	Rrapaj
340	Myzejene	Papaj



341	Çoman	Malaj
342	Agim	Lamaj
343	Fatmir	Groballi
344	Agron	Lamaj
345	Astrit	Lamaj
346	Fatos	Xhufi
347	Fatos	Bushaj
348	Nertil	Malaj
349	Shpejtım	Hoxha
350	Fatos	Seitaj
351	Baftjar	Lamaj
352	Fadil	Lamaj
353	Rauf	Meraj
354	Yllka	Koliçi
355	Nadile	Pajaj
356	Gentjan	Lamaj
357	Hekuran	Lamaj
358	Safet	Skënderaj
359	Hysen	Lamaj
360	Idajet	Lamaj
361	Skënder	Lamaj
362	Mane	Jaupaj
363	Festim	Berberaj
364	Festim	Bregu
365	Fiqiri	Koxhaj
366	Sokrat	Lamaj
367	Xhevair	Lamaj
368	Bujar	Lanaj
369	Dhimitraq	Kule
370	Bilbil	Lazaj
371	Flamur	Lezaj
372	Shqiponjë	Muhaj
373	Agur	Likaj
374	Bexhet	Likaj
375	Floresha	Hazizi
376	Fatos	Likaj
377	Gazmir	Likaj
378	Kastriot	Likaj
379	Shpëtim	Likaj
380	Gani	Haxhija
381	Ylli	Likaj
382	Fatbardha	Mahmutaj
383	Gezim	Mahmutaj

384	Viktor	Mahmutaj
385	Bedri	Malaj
386	Blerim	Malaj
387	Dilaver	Malaj
388	Kudret	Hyskaj
389	Gezim	Morina
390	Dritan	Malaj
391	Dhurata	Ali
392	Ervin	Malaj
393	Fatmir	Malaj
394	Gëzim	Malaj
395	Altin	Skënderaj
396	Luljan	Isufaj
397	Muharrem	Goxhaj
398	Lulëzim	Islamaj
399	Alfred	Brahushi
400	Petref	Çaushaj
401	Ilir	Malaj
402	Lefter	Malaj
403	Juela	Malasi
404	Novrus	Malaj
405	Destan	Elmazaj
406	Musan	Malaj
407	Qani	Malaj
408	Qemal	Malaj
409	Fatmir	Malasi
410	Qemal	Malasi
411	Besnike	Silaj
412	Gramos	Bregaj
413	Bedri	Malkaj
414	Erigeld	Nazëraj
415	Ferik	Meçanaj
416	Isa	Merkaj
417	Jonus	Muçaj
418	Gramoz	Fejzo
419	Gëzim	Malkaj
420	Klarenta	Dollani
421	Esma	Hajdaraj
422	Mehmet	Hyska
423	Fatmir	Manaj
424	Sefedin	Manaj
425	Agron	Maraj
426	Pëllumb	Maraj



427	Shaban	Maraj
428	Romario	Mehmetaj
429	Enea	Mahmutaj
430	Shpëtim	Maraj
431	Petraç	Kitani
432	Enver	Meçaj
433	Durim	Meçanaj
434	Ismail	Meçanaj
435	Nderim	Pashaj
436	Kujtim	Mehmetaj
437	Laver	Mehmetaj
438	Seit	Mehmetaj
439	Adriatik	Memushaj
440	Brahim	Hoxhaj
441	Elena	Memushaj
442	Hysni	Demo
443	Aleksandër	Meraj
444	Drita	Zotaj
445	Adem	Merdanaj
446	Dilaver	Merdanaj
447	Shpresa	Baho
448	Illir	Aliu
449	Arbër	Merkaj
450	Gazment	Merkaj
451	Vask	Yzeiraj
452	Petrit	Merkaj
453	Shaip	Rexhepaj
454	Arjan	Metaj
455	Nazmi	Lamaj
456	Ismail	Mernica
457	Bektash	Metaj
458	Shyqyri	Çelaj
459	Florika	Ruzhdija
460	Jetnor	Zaçaj
461	Luan	Metaj
462	Iraklit	Prifti
463	Marigona	Metaj
464	Tefta	Metaj
465	Agim	Muçaj
466	Aida	Mehmetaj
467	Alban	Muçaj
468	Engjillushe	Jazaj
469	Kastriot	Xhoxhaj

470	Ardian	Varfi
471	Durim	Muçaj
472	Feti	Alushaj
473	Ferdinant	Muçaj
474	Shaban	Muçaj
475	Shpëtim	Muçaj
476	Xhezmi	Muçaj
477	Kastriot	Salaj
478	Krenar	Beshaj
479	Veledin	Muhaj
480	Xhevaire	Muhaj
481	Rapo	Shehaj
482	Hajdër	Muhametaj
483	Kovaç	Pashaj
484	Kujtim	Lamçaj
485	Mimoza	Muhametaj
486	Petrit	Muhametaj
487	Dilaver	Muharremi
488	Ermal	Muharremi
489	Zeço	Agaj
490	Elmira	Manaj
491	Bashkim	Mukaj
492	Ledia	Plasa
493	Bujar	Mukaj
494	Vasilika	Manaj
495	Dashamir	Dervishaj
496	Petrit	Mukaj
497	Ilirjan	Ago
498	Astrit	Musaraj
499	Bektash	Musaraj
500	Ylli	Musaraj
501	Leonidha	Dhefto
502	Zeni	Gishto
503	Leonidha	Sotiri
504	Besnik	Muskaj
505	Donalda	Zhuga
506	Entela	Lamaj
507	Elona	Goxhaj
508	Luan	Muskaj
509	Mirela	Muskaj
510	Flamur	Myselaj
511	Lindita	Kumaraku
512	Pëllumb	Myselaj



513	Laureta	Xhafa
514	Besene	Karemani
515	Tomor	Myselaj
516	Sali	Saliu
517	Ardit	Tasholli
518	Agim	Nazëraj
519	Arben	Nazëraj
520	Bilbil	Nazëraj
521	Luan	Kila
522	Dano	Nazëraj
523	Novrus	Nazëraj
524	Saimir	Nazëraj
525	Abenë	Hoxhaj
526	Shaban	Nazëraj
527	Luan	Brahamaj
528	Ramazan	Arranjaku
529	Agron	Nuhaj
530	Fatos	Nuhaj
531	Luljeta	Tahiraj
532	Luljeta	Sinanrrapaj
533	Benard	Lazaj
534	Nuredin	Ferzaj
535	Luljeta	Lena
536	Pirro	Hoxharaj
537	Floresha	Nuhaj
538	Hekuran	Nuhaj
539	Albiana	Metaj
540	Hëna	Baraj
541	Kastriot	Nuhaj
542	Barjam	Osmënaj
543	Lumturi	Kamberaj
544	Barjam	Osmënaj
545	Behar	Osmënaj
546	Erjon	Osmënaj
547	Abedin	Baraj
548	Gazmir	Osmënaj
549	Lirim	Osmënaj
550	Rexhep	Alimerkaj
551	Sokrat	Osmënaj
552	Xhevdet	Osmënaj
553	Flamur	Paja
554	Idaet	Isufaj
555	Bilbil	Pajaj

556	Mirela	Oshafi
557	Ilir	Pajaj
558	Agron	Pashaj
559	Edmond	Pashaj
560	Selami	Muçka
561	Hysen	Pashaj
562	Ilmi	Pashaj
563	Mitat	Pashaj
564	Zoica	Golloshi
565	Hajrije	Duraj
566	Neim	Fezaj
567	Adrjan	Isufaj
568	Novrus	Pashaj
569	Rakip	Jaupaj
570	Pëllumb	Pashaj
571	Mystehak	Levanaj
572	Mystehak	Pelanaj
573	Ledjan	Ajbikaj
574	Melaize	Shametaj
575	Alvin	Ajbikaj
576	Adelina	Robo
577	Përparim	Pashaj
578	Luftar	Asllanaj
579	Mefail	Xhafaj
580	Artjon	Malaj
581	Erlind	Malasi
582	Skënder	Pashaj
583	Natasha	Çako
584	Remzi	Harizaj
585	Aranit	Sinani
586	Panajot	Kamaj
587	Vladimir	Pashaj
588	Aristir	Plaku
589	Denis	Malaj
590	Erjon	Plaku
591	Alban	Qamiranaaj
592	Burhan	Ymeraj
593	Shqiponja	Ruzhdije
594	Pëllumb	Qamiranaaj
595	Asqeri	Ramaj
596	Batjar	Ramaj
597	Emiljano	Ramaj
598	Festim	Ramaj



599	Kujtim	Resulaj
600	Suzana	Resulaj
601	Agron	Rizaj
602	Përparim	Jonuzaj
603	Floresha	Rizaj
604	Luan	Rizaj
605	Mitat	Rizaj
606	Rajmonda	Rizaj
607	Përparim	Rabiaj
608	Ylli	Rizaj
609	Elida	Gjergji
610	Islam	Begaj
611	Bazo	Ymeraj
612	Ledia	Rudi
613	Agim	Sadikaj
614	Klajdi	Musaraj
615	Fadil	Sadikaj
616	Petrit	Velçanaku
617	Leonard	Sadikaj
618	Yzedin	Sadikaj
619	Agim	Saliaj
620	Arben	Saliaj
621	Baftjar	Saliaj
622	Sabri	Saliaj
623	Eqerem	Saliu
624	Fatmir	Selami
625	Pllumb	Bektashi
626	Kasëm	Osmëni
627	Ylli	Selami
628	Qani	Avdaj
629	Aleksandër	Selimaj
630	Nexhmije	Meçaj
631	Festim	Selimaj
632	Hasan	Selimaj
633	Saimir	Selimaj
634	Manuela	Goxhaj
635	Tomorr	Serjani
636	Qemal	Mezani
637	Astrit	Shametaj
638	Miklovan	Bejdaj
639	Lirim	Shametaj
640	Çerçis	Kapaj
641	Yzedin	Shametaj

642	Besnik	Shanaj
643	Rajmonda	Demaj
644	Eqerem	Shanaj
645	Riza	Shanaj
646	Entiljan	Sulaj
647	Roland	Shanaj
648	Ramadan	Buzali
649	Sefedin	Shanaj
650	Bedri	Shateri
651	Fatmir	Shateri
652	Alban	Shehaj
653	Razim	Dimeraj
654	Albert	Shehaj
655	Aleksandër	Shehaj
656	Klodiana	Osmani
657	Riza	Hasanago
658	Bedri	Shehaj
659	Durim	Shehaj
660	Gentjan	Shehaj
661	Gëzim	Shehaj
662	Gramos	Shehaj
663	Simon	Toska
664	Gramoz	Shehaj
665	Hasan	Shehaj
666	Saimir	Mamo
667	Eglantjano	Xhaferaj
668	Perrie	Shehaj
669	Enkelejd	Kapllanaj
670	Petrit	Shehaj
671	Engjell	Zotaj
672	Pellump	Aliaj
673	Shkëlqim	Shehaj
674	Sybi	Shehaj
675	Viktor	Shehaj
676	Mesut	Taraj
677	Vladimir	Shehaj
678	Lutfi	Hajdëraj
679	Vladimir	Shehaj
680	Veledin	Shehu
681	Vjollca	Shehu
682	Selman	Alibehaj
683	Kastriot	Silaj
684	Mimoza	Silaj



685	Shpetim	Halimi
686	Myfit	Myrtellari
687	Sokrat	Sinaj
688	Telha	Jahaj
689	Ylli	Sinaj
690	Isuf	Hazizaj
691	Haredin	Nuhaj
692	Mynyr	Sinanaj
693	Shkelqim	Bakiaj
694	Zini	Sinanaj
695	Agim	Skënderaj
696	Alit	Skënderaj
697	Shkëlqim	Hajdari
698	Asqeri	Skënderaj
699	Engjëllushe	Hoxhallari
700	Durim	Skënderaj
701	Margarit	Bare
702	Eqerem	Skënderaj
703	Hekuran	Skënderaj
704	Liljana	Skënderaj
705	Shpëtim	Fejzulla
706	Mehdine	Shehaj
707	Skënder	Bihuci
708	Saimir	Skënderaj
709	Meçan	Duraj
710	Albana	Stafa
711	Iilir	Stafa
712	Ajet	Sulaj
713	Nikollaç	Divija
714	Aleksandër	Sulaj
715	Lavdosh	Lazaj
716	Markeljan	Isufaj
717	Sokol	Nexhipi
718	Astrit	Sulaj
719	Baftjar	Sulaj
720	Bardhyl	Sulaj
721	Hasan	Sulaj
722	Sokrat	Kullsi
723	Marjus	Sulaj
724	Suzana	Zylali
725	Suzana	Gjylbegu
726	Përparim	Sulaj
727	Zija	Lamaj

728	Petrit	Sulaj
729	Petrit	Sulaj
730	Tatjana	Ramollari
731	Petrit	Sulaj
732	Xhevair	Sulaj
733	Aben	Shehaj
734	Taulant	Kallashi
735	Artur	Sulejmanaj
736	Arben	Suloavdulaj
737	Roland	Suloavdulaj
738	Tetem	Hasimaj
739	Neritan	Shanaj
740	Teuta	Ikonomi
741	Sybi	Taraj
742	Qemal	Toska
743	Aleksandër	Troka
744	Erblin	Dushkaj
745	Tomorr	Çarçani
746	Arben	Varfaj
747	Sokol	Varfaj
748	Dritëro	Aliaj
749	Alket	Merkaj
750	Astrit	Veizaj
751	Migjen	Çelaj
752	Ylli	Veizaj
753	Myqerem	Rushitaj
754	Astrit	Velaj
755	Novrus	Velaj
756	Zenel	Xhafa
757	Viktor	Koçi
758	Merita	Banaj
759	Hasan	Xhafaj
760	Violeta	Ndini
761	Tone	Karameti
762	Violeta	Muho
763	Edmond	Xhaferaj
764	Haki	Paja
765	Sami	Xhaferaj
766	Nertila	Ismaili
767	Vjollca	Kalivaçi
768	Ermal	Xhanaj
769	Vladimir	Vrenaj
770	Mandi	Aliaj



771	Naim	Dervishaj
772	Xhentiljano	Rizaj
773	Lumturi	Xhanaj
774	Robert	Asllanaj
775	Ardjan	Xhelaj
776	Resmi	Jaupaj
777	Gramos	Xhelaj
778	Tetem	Xhelaj
779	Kastriot	Xhemalaj
780	Gjergji	Bregasi
781	Fjordi	Hodaj
782	Përparim	Xhemalaj
783	Olger	Harasani
784	Geron	Pashaj
785	Barjam	Ymeraj
786	Oltion	Rudi
787	Durim	Ymeraj
788	Krenar	Ymeraj
789	Leonard	Ymeraj
790	Lumturi	Ymeraj
791	Natasha	Ymeraj
792	Xhevit	Serjanaj
793	Agim	Yzeiraj
794	Ermelind	Paja
795	Astrit	Yzeiraj
796	Xhezmi	Rakipaj
797	Ergest	Malaj
798	Ylli	Lapshi
799	Yllke	Abdullahu
800	Petrit	Yzeiraj
801	Erlinda	Hoxhaj
802	Elis	Mehja
803	Shkëlqim	Yzeiraj
804	Taulant	Yzeiraj
805	Ela	Haxhiraj
806	Hysen	Zenelaj
807	Pëllumb	Zenelaj
808	Qerem	Zenelaj
809	Ramis	Zenelaj
810	Ylli	Demiraj
811	Flogert	Goreaj
812	Barjam	Zeneli
813	Gëzim	Zeneli

814	Lulzim	Zeneli
815	Abas	Harrunaj
816	Agim	Zotaj
817	Taulant	Zotaj
818	Zenel	Zotaj
819	Nimet	Sinanaj
820	Zini	Canaj
821	Hamet	Ametaj
822	Muhamet	Shanaj
823	Irfan	Shanaj
824	Lulzim	Zylalaj
825	Zini	Heqimaj
826	Perparim	Hasani
827	Gëzim	Mehmetaj

VENDIM
Nr. 910, datë 18.11.2020

**PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË
RINDËRTIMIT, PËR FINANCIMIN E
RINDËRTIMIT TË KONVIKTIT TË
SHKOLLËS SË MESME PROFESIONALE
“KOLIN GJOKA”, BASHKIA LEZHË
DHE CAKTIMIN E BASHKISË LEZHË SI
NJËSI ZBATUESE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja “b”, nënndarjet “i” dhe “iii”, 16 e 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 88/2019, “Për buxhetin e vitit 2020”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përdorimin e fondit të rindërtimit, për financimin e rindërtimit të konviktit të shkollës së mesme profesionale “Kolin Gjoka”, Bashkia Lezhë, në vlerën 155 000 000 (njëqind e pesëdhjetë e pesë milionë) lekë.

2. Përdorimi i fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2020, për financimin e rindërtimit të konviktit të shkollës së mesme profesionale “Kolin Gjoka”,



Bashkia Lezhë, të jetë në vlerën 31 000 000 (tridhjetë e një milionë) lekë dhe të përballohet nga pjesa e financuar nga grantet e fondit të rindërtimit.

3. Caktimin e Bashkisë Lezhë si njësi zbatuese për financimin e rindërtimit të konviktit të shkollës së mesme profesionale “Kolin Gjoka”, Bashkia Lezhë.

4. Fondi për financimin e rindërtimit të konviktit të shkollës së mesme profesionale “Kolin Gjoka”, Bashkia Lezhë, i transferohet njësisë zbatuese, Bashkisë Lezhë.

5. Ngarkohen ministri i Shtetit për Rindërtimin, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Bashkia Lezhë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

SEKSIONI I DYTË

ÇËSHTJA TËRSHANA K. SHQIPËRISË

(Ankimi nr. 48756/14)

VENDIM

Neni 2 (material) - Detyrimet pozitive - Sulm me acid ndaj një gruaje në rrugë

- Ekzistenca e një kuadri të ligjit penal efektiv
- Rreziku për jetën e ankueses nga ish-bashkëshorti i dyshuar nuk është sjellë në vëmendje të autoriteteve para sulmit

- Autoritetet shtetërore nuk janë përgjegjëse,
neni 2 (procedural) - Hetim efektiv - Gjykata ka parasysh situatën e përgjithshme të dhunës ndaj grave në Shqipëri

- Qasje joefektive ndaj dhunës ndaj grave nga zyrtarët e zbatimit të ligjit

- Detyrimi nga ana e autoriteteve hetimore për të reaguar me kujdes të veçantë në kryerjen e një hetimi të plotë

- Moskryerje me shpejtësinë dhe vendosmërinë e duhur të masave hetimore të një rëndësie thelbësore

- Pamundësi e ankueses për të apeluar vendimin për pezullimin e hetimit, për të kundërshtuar (mungesën e) hapave hetimorë ose paraqitjen e kërkesës për dëmshpërblim.

STRASBURG

4 gusht 2020

Ky vendim do të marrë formë të prerë në rrethanat e përcaktuara në nenin 44§2 të Konventës. Ai mund t'i nënshtrohet rishikimit redaktues.

Në çështjen Tërshana kundër Shqipërisë,
Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Seksioni i Dytë), me trup gjykues të përbërë nga:

Robert Spano, president,

Paul Lemmens,

Ledi Bianku,

Valeriu Griçco,

Jon Fridrik Kjolbro,

Stéphanie Mourou-Vikström,

Arnfinn Bårdsen, gjyqtarë,

dhe Stanley Naismith, sekretar i Seksionit,

pas shqyrtimit me dyer të mbyllura më 3 korrik 2018 dhe 23 qershor 2020,

shpall vendimin e mëposhtëm, i cili u miratua në po atë datë:

PROCEDURA

1. Çështja e ka zanafillën në ankimin (nr. 48756/14) kundër Republikës së Shqipërisë depozituar pranë Gjykatës, sipas nenit 34 të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (Konventa) nga një shtetase shqiptare, znj. Dhurata Tërshana (ankuesja), më 30 qershor 2014.

2. Ankuesja u përfaqësua nga z. N. Marku, avokat që ushtron aktivitetin e tij në Tiranë. Qeveria shqiptare (Qeveria) u përfaqësua nga agentja e saj, në atë kohë, znj. Alma Hicka nga Avokatura e Shtetit.

3. Ankuesja pretendonte se autoritetet kanë dështuar në mbrojtjen e jetës së saj dhe të së drejtës së saj për jetë private, sipas neneve 2, 3, 8, 13 dhe 14 të Konventës. Ajo, gjithashtu, u ankua për dështimin e autoriteteve për të kryer një investigim të shpejtë dhe efektiv që do të çonte në identifikimin, ndjekjen dhe dënimin e autorit të sulmit.

4. Më 6 tetor 2014 ankimi iu komunikua Qeverisë.

FAKTET

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

5. Ankuesja ka lindur në vitin 1984 dhe banon në Tiranë.



A. Historiku i çështjes

6. Më 29 korrik 2009, rreth orës 4 pm, ndërsa ecte në një nga rrugicat e Tiranës, ankuesja pësoi dëmtime të rënda në një sulm me acid nga një autor i paidentifikuar. Ajo u dërgua menjëherë në Spitalin Nënë Tereza për të marrë trajtim urgjent mjekësor. Raporti i spitalit tregonte se njëzet e pesë për qind e trupit të ankueses, kryesisht fytyra dhe pjesa e sipërme e trupit ishte djegur (*combustio corporis, facies et extremitas superior*), për shkak të sulmit me acid dhe se ishte në gjendje kritike. Më 1 gusht 2009 ajo u dërgua në Itali për një trajtim mjekësor më të specializuar. Raporti i spitalit i datës 2 tetor 2009 tregonte se ankuesja kishte djegie të shkallës së mesme deri në thellësi të fytyrës, qafës dhe trupit (*ustioni intermedio-profonde di volto, collo, tronco, arti superiori ed inferiori*) të shkaktuara nga acidi sulfurik. Sipas raportit të trajtimit të saj spitalor në Itali, ankuesja iu nënshtrua të paktën katërmbëdhjetë operacioneve në periudhën midis viteve 2009 dhe 2012. Shpenzimet e këtyre operacioneve u përballuan nga Krahinat e Pulias dhe Marche, Itali si dhe nga ankuesja. Ajo vuante nga ankthi dhe probleme psikologjike dhe kishte frikë të kthehej në Shqipëri. Ajo përfitoi raport mjekësor për të paktën shtatë muaj nga autoritetet shqiptare, por duket se nuk ishte në gjendje të punonte për disa vjet.

B. Hetimi i çështjes së sulmit të 29 korrikut 2009

7. Më 29 korrik 2009 prokurori hapi një hetim për sulmin me acid, sipas nenit 88 të Kodit Penal (shih paragrafin 64 më poshtë). Ankuesja bëri një deklaratë në të cilën u shpreh se nuk e kishte njohur autorin e sulmit ndaj saj. Ajo deklaroi se nuk kishte mosmarrëveshje me askënd, por dyshonte se sulmi ishte organizuar nga ish-bashkëshorti i saj (E.A.) si një akt hakmarrjeje dhe vazhdimësisë së dhunës që kishte pësuar në të kaluarën. Ai e kishte kërcënuar në të kaluarën se do ta vriste. Ajo dhe E.A. ishin ndarë përfundimisht, pasi ai kishte refuzuar ta lejonte atë që të ndiqte një kurs trajnimi të specializuar në Itali. Përveç kësaj, ajo deklaroi se në kohën e sulmit, autori mbante një kapelë ngjyrë kafe/bezhë, syze dielli të zeza dhe këmbë të zezë. Autori i sulmit kishte hedhur një substancë mbi fytyrën dhe trupin e saj dhe më pas ishte larguar. Ajo kishte ndjerë që fytyra dhe gjoksi i saj po digjeshin dhe rrobat e saj po shkriheshin. Substanca ishte hedhur edhe mbi kolegen e saj. Ajo

më tej deklaroi se E.A. kishte qenë i burgosur në Itali dhe se kishte miq me rekorde kriminale.

8. Po atë ditë, prokurori mori një deklaratë nga kolegia e ankueses, e cila kishte qenë me të gjatë sulmit me acid dhe kishte pësuar, gjithashtu, dëmtime të rënda. Edhe kolegia e ankueses deklaroi se nuk e kishte njohur autorin e sulmit. Autori kishte veshur pantallona të errëta dhe këmbë të zezë dhe mbante një enë që kishte brenda një substancë të kuqe. Ndërkohë që ecte drejt saj dhe ankueses, ai kishte hapur enën dhe kishte hedhur përmbajtjen e saj mbi trupat e tyre. Ajo deklaroi se nuk kishte mosmarrëveshje me askënd dhe se kishte dëgjuar nga pjesëtarët e familjes së ankueses se dyshonin për ish-bashkëshortin e ankueses. Ajo, gjithashtu, deklaroi se kishte parë njerëz të tjerë në vendngjarjen e sulmit dhe një burrë në rrugën kryesore.

9. Më 29 korrik dhe 6 gusht 2009 E.D., një nga kolegët e ankueses dha një deklaratë ku shprehej se nuk kishte qenë në gjendje të dallonte fytyrën e autorit të krimit, sepse kishte qenë me shpinë ndaj tij. Sipas përshkrimit të tij, autori kishte veshur këmbë të kuqe, xhins me vija të bardha dhe syze dielli. Ai, më tej, përshkroi se si e kishte ndihmuar ankuesen dhe viktimën tjetër, dhe se, së bashku me një kolege tjetër, E.S., i kishin dërguar të dyja në spital. Ai, gjithashtu, deklaroi se në vendngjarje kishin ardhur njerëz të tjerë dhe ishin përpjekur të ndihmonin viktimat. Kolegia e lartpërmendur E.S. deklaroi se kishte ndihmuar për t'i dërguar viktimat në spital. Ajo nuk e kishte parë fare autorin e krimit.

10. Më 29 korrik 2009 B.D., motra e ankueses, deklaroi se e motra i kishte treguar më parë që E.A. ishte xheloz dhe ushtronte dhunë ndaj saj. Ajo kishte dashur të ndiqte një kurs trajnimi të specializuar në Itali, por E.A. nuk e kishte lejuar. Ai e kishte kërcënuar se do ta vriste nëse do të divorcoheshin. Ajo, gjithashtu, deklaroi se kushëriri i saj, R.T., ishte takuar me E.A. për t'i kthyer disa sende në emër të ankueses. E.A. i kishte thënë R.T. se nuk do t'i shkaktonte ankueses asnjë problem dhe se ajo mund të vazhdonte jetën e saj normale. B.D. deklaroi, gjithashtu, se në maj 2009 ajo ishte takuar me E.A. dhe nënën e tij në prani të motrës së saj për të diskutuar mbi vazhdimësinë e marrëdhënies së tyre. Sipas B.D., ishte e qartë nga diskutimet që patën se E.A. kishte ushtruar dhunë ndaj motrës së saj. Më 21 dhjetor 2009 B.D. dha



një deklaratë tjetër në të cilën konfirmonte deklaratat e saj të datës 29 korrik 2009 dhe u shpreh se ende kishte dyshime që E.A. mund të ketë kryer sulmin.

11. Më 29 korrik 2009 R.T., kushëri i ankueses, deklaroi se ishte në dijeni që E.A. kishte përdorur dhunë ndaj ankueses dhe ishte xheloz. Ai kishte takuar E.A. dy muaj më parë dhe i kishte dhënë disa sende në emër të ankueses. E.A. i kishte thënë R.T. se nuk do të kontaktonte me ankuesen dhe nuk do t'i shkaktonte asaj asnjë problem.

12. Më 29 korrik 2009 L.D., kunati i ankueses deklaroi se kishte mësuar nga gruaja e tij B.D., se kunata e tij i ishte nënshtruar dhunës dhe fyerjeve nga bashkëshorti i saj.

13. Më 29 korrik 2009 V.T., nëna e ankueses deklaroi se E.A. ishte përfshirë në vepra penale, të tilla si vjedhja e kasafortave dhe vrasja. Ai kishte përdorur dhunë ndaj ankueses. Një herë, ai e kishte mbyllur atë në banesën e tij për tri ditë, duke e penguar të shkonte në punë, në shenjë hakmarrjeje për kërcënimin se do ta denonconte atë në polici. Pas divorcit ata kishin pasur disa herë grindje në lidhje me sende të caktuara që duhej t'i kthenin njëri-tjetrit.

14. Më 29 korrik 2009, një tjetër dëshmitar, G.D., i cili kishte qenë duke pirë kafe në një kafene aty pranë në kohën e sulmit, deklaroi se kishte shkuar për të ndihmuar ankuesen dhe viktimën tjetër pasi dëgjoji britma. Ai nuk e kishte parë kush e kishte kryer sulmin. Ai kishte parë një enë në rrugë dhe e kishte shkëmbuar. Sipas tij, substanca e cila u derdh nëpër rrugë kishte qenë acid.

15. Në një deklaratë të dhënë po atë ditë, E.A. deklaroi se më 29 korrik 2009 ai kishte qenë në Durrës deri në orën 6 pasdite. Më tej ai deklaroi se me ankuesen ishin divorcuar në maj 2009, sepse kishin probleme; ai nuk kishte qenë dakord me ankuesen kur ajo kishte dashur të shkonte në Itali për të ndjekur një kurs profesional të specializuar. Ai, gjithashtu, deklaroi se procesi i divorcit kishte shkuar normalisht dhe që nga ajo kohë nuk kishte pasur asnjë kontakt me ankuesen. Ai nuk kishte asnjë informacion se kush mund të ketë qenë autori i krimin. Ai, gjithashtu, dha informacion për njerëzit që njihje, konkretisht familjarët, miqtë dhe të afërmit.

16. Më 29 korrik 2009 F.P., nëna e E.A., deklaroi se djali i saj dhe ankuesja kishin pasur marrëdhënie të mira, por ishin divorcuar në vitin

2009, sepse ankuesja kishte dashur të ndiqte një kurs trajnimi të specializuar në Itali dhe E.A. nuk ishte pajtuar me idenë. Ajo më tej deklaroi se ditën që ata u divorcuan ajo kishte takuar djalin e saj, ankuesen dhe motrën e ankueses për të gjetur një zgjidhje. Megjithatë, djali i saj dhe ankuesja kishin vendosur t'i jepnin fund marrëdhënies së tyre. Që nga ajo kohë, me sa ishte në dijeni, ata nuk kishin pasur asnjë kontakt. Ajo konfirmoi se djali i saj kishte qenë në Durrës gjatë gjithë ditës. Kushëri i E.A., L.A., deklaroi, gjithashtu, se me sa ishte në dijeni, kushëri i tij nuk kishte asnjë mosmarrëveshje me ankuesen.

17. Më 29 korrik 2009, një oficer i policisë gjyqësore kreu një ekzaminim në vendngjarje dhe siguroi disa prova, përfshirë rrobat e ankueses dhe koleges së saj dhe një enë qelqi që përmbante një sasi të vogël të një substance të lëngshme të kuqe.

18. Më 29 korrik dhe 1 tetor 2009 oficeri i policisë gjyqësore vendosi që duhej të përpiloheshin disa raporte, përkatësisht një raport mjekoligjor, një raport ekspertimi i gjurmëve të gishtave mbi enën prej qelqi të përdorur për hedhjen e acidit, një raport ekspertimi kimik dhe toksikologjik mbi enën prej qelqi për të identifikuar substancën e lëngshme dhe metodën me të cilën ishte prodhuar lëngu, si dhe një raport ekspertimi kimik dhe toksikologjik mbi rrobat e ankueses dhe viktimës tjetër për të identifikuar substancën e lëngshme dhe për të përcaktuar nëse dëmtimi i rrobave kishte ndodhur si rezultat i përdorimit të asaj lënde.

19. Më 29 korrik 2009 prokurori urdhëroi përgjimin e bisedave telefonike të E.A. për periudhën 29 korrik deri më 12 gusht 2009, që më pas u aprovua nga gjykata e rrethit më 30 korrik 2009. Më 13 gusht 2009 prokurori i përgjithshëm i dërgoi rezultatet e përgjimit prokurorit të rrethit.

20. Më 30 korrik 2009 oficeri i policisë gjyqësore referoi pranë prokurorisë së rrethit, veprën penale të shkaktimit të plagosjes së rëndë me dashje që i atribuohet E.A. Ai u shpreh se më 29 korrik 2009 në një rrugicë pranë Ministrisë së Drejtësisë, një person i paidentifikuar kishte hedhur acid mbi ankuesen dhe viktimën tjetër, duke i lënë të dyja në gjendje kritike. Ai vlerësonte se në bazë të dëshmimeve në dosje, si dhe deklaratave të dhëna nga ankuesja, viktimja tjetër dhe familjarët e tjerë, ishte e qartë se kishte dyshime që E.A. mund të ketë kryer sulmin.



21. Më 31 korrik 2009 ankuesja dha një deklaratë tjetër, duke thënë se ende kishte dyshime që E.A. kishte dashur të hakmerret për shkak të divorcit. Ajo, gjithashtu, shtoi se në të kaluarën ai kishte kryer vepra penale – përkatësisht vjedhje nga kasaforta dhe shtëpi – dhe se posedonte një armë.

22. Më 3 gusht 2009, prokurori i rrethit urdhëroi që të ndërmerren një sërë veprimesh procedurale, të tilla si ekzaminimi i raport ekspertimit të gjurmëve të gishtave mbi enën e përdorur për hedhjen e acidit dhe që rezultatet të krahasohen me gjurmët e gishtave të personave të tjerë të dyshuar, si dhe çdo personi tjetër të përfshirë në listën e personave të dyshuar në Laboratorin Qendror të Kriminologjisë; ekzaminimi i raportit mjekoligjor dhe i raporteve të tjera të ekspertimit; pyetja e çdo personi që ka dijeni për ngjarjen; ekzaminimi i përgjimeve telefonike; marrja e tabulateve telefonike të viktimave dhe E.A., si dhe të çdo personi tjetër që mund të ketë lidhje me hetimin; gjetja dhe verifikimi i numrave telefonikë të përdorur nga E.A. në internet; konfiskimi i pamjeve filmike të disa kamerave aty pranë, pasi ndonjëra prej tyre mund të ketë kapur dhe regjistruar autorin e krimit; përcaktimi i aparateve të gjetura në banesën e E.A. (shih paragrafin 44 më poshtë); si dhe çdo veprim tjetër që gjykohej me vend.

23. Më 3 gusht 2009, një raport ekspertimi i përgatitur nga Instituti i Policisë Shkencore (ISP) konkludonte se nuk mund të identifikohet asnjë gjurmë gishtash në enën prej qelqi.

24. Më 6 gusht 2009 një raport mjekoligjor i përgatitur nga Instituti i Mjekësisë Ligjore (FMI) konkludonte se njëzet e pesë për qind e fytyrës, e barkut dhe e gjymtyrëve të sipërme të ankueses ishin djegur, ku dëmtimet ishin shkaktuar nga një substancë gërryese. Raporti më tej konkludonte se ishte e pamundur që duke u bazuar vetëm në raportin mjekoligjor të jepej një konkluzion i saktë në lidhje me kategorinë e dëmtimeve të ankueses. Prandaj ishte e nevojshme që ankuesja të ekzaminohet tre muaj pas datës në të cilën ishte dëmtuar.

25. Më 11 gusht 2009 oficeri i policisë gjyqësore kreu kërkime në internet për të gjetur numrat e telefonit të renditur në emër të E.A. Po atë ditë, prokurori kërkoi që një kompani e telefonisë celulare t'i siguronte historikun e regjistrimit të thirrjeve, në lidhje me disa nga numra telefonikë të

E.A. për periudhën 25 deri më 30 korrik 2009, si dhe vendndodhjen dhe zonën e mbulimit më 29 korrik 2009. Më 18 gusht kompania e telefonisë celulare paraqiti informacionin e kërkuar nga prokurori.

26. Më 15 gusht dhe 15 dhjetor 2009 u kërkuan informacione të tjera në lidhje me disa numra telefonikë për të identifikuar personat që u përkisnin dhe që mund të kenë bërë thirrje telefonike gjatë orëve kur ka ndodhur sulmi. Më 21 dhjetor 2009 kompania e telefonisë celulare dorëzoi informacionin e kërkuar nga prokurori. Në janar 2011 dy individët e pyetur nga oficeri i policisë gjyqësore deklaruan se nuk kishin asnjë informacion për incidentin e datës 29 korrik 2009. Megjithatë ishin miq me E.A., ata pohuan se ai nuk e kishte diskutuar ngjarjen me ta. Një person tjetër i pyetur deklaroi se nuk e njohte fare E.A.

27. Më 11 gusht 2009 prokurori i rrethit kërkoi që t'i siguroheshin pamjet filmike nga tri banka aty pranë, pasi kamerat e tyre të sigurisë mendohej të kenë regjistruar imazhet e ngjarjeve të datës 29 korrik 2009. Më 13 dhe 18 gusht 2009 dy banka dorëzuan pamjet filmike në CD-ROM. Raporti i shkruar nga oficeri i policisë gjyqësore më 24 shtator 2009 mbi shqyrtimin e provave shprehte se ishin ekzaminuar CD-ROM-ët, me qëllim identifikimin e ndonjë personi që kishte të njëjtat karakteristika me personin e përshkruar në deklaratat e dhëna nga dëshmitarët. Ato u ekzaminuan edhe nga ankuesja dhe kolegja e saj. Sidoqoftë, askush nuk mund të identifikohet si autori i dyshuar.

28. Më 9 shtator 2009 një dëshmitare tjetër, G.V., kolege e ankueses, u pyet dhe përshkroi se si ishte veshur një burrë të cilin ajo e kishte parë pranë vendit të ngjarjes. Sipas saj, autori i sulmit mbante një kapele të errët, syze dielli dhe rroba të errëta. Po atë ditë, një tjetër dëshmitare, Y.K., deklaroi se kishte parë dy të rinj që mbanin një enë qelqi, njëri prej të cilëve kishte veshur një këmishë të kuqe dhe tjetri një këmishë të zezë.

29. Më 16 dhjetor 2009, E.K. – motra e E.A. – dha një deklaratë përpara oficerit të policisë gjyqësore, në të cilën konfirmonte se më 29 korrik 2009, E.A. kishte qenë në Durrës me të. Ajo deklaroi se ankuesja dhe E.A. kishin pasur një marrëdhënie të mirë. Ata ishin divorcuar sepse ankuesja kishte dashur të shkonte në Itali për të ndjekur një kurs trajnimit të specializuar dhe E.A.



nuk kishte rënë dakord me idenë për arsyet e tij personale.

30. Më 30 shtator 2009, Fakulteti i Shkencave të Natyrës (FNS) informoi oficerin e policisë gjyqësore se nuk ishte në gjendje të përpilonte raportin e ekspertimit kimik të kërkuar (ka të ngjarë duke iu referuar raportit të ekspertimit që do të hartohej në lidhje me substancën e kuqe – shih paragrafin 18), pasi i mungonin pajisjet e nevojshme të specializuara.

31. Më 23 tetor 2009 ISP informoi oficerin e policisë gjyqësore se nuk mund të përpilonte një raport ekspertimi mbi rrobat e ankueses dhe viktimës tjetër, pasi nuk binte në sferën e tij të kompetencës.

32. Më 7 dhjetor 2009 oficeri i policisë gjyqësore vendosi që FMI-ja duhej të përpilonte një raport tjetër mjekoligjor në funksion të konkluzioneve të nxjerra në raportin e datës 6 gusht 2009 (shih paragrafin 24 më lart). Më 15 dhjetor 2009 mjeku u përgjigj se raporti mund të përgatitej sapo t'i vihej në dispozicion një kopje e raporteve mjekësore të ankueses përgatitur nga spitali italian.

33. Më 15 dhjetor 2009 një grup ekspertësh i FMI-së përgatiti një raport tjetër mjekoligjor. Ata vunë në dukje se nuk mund të ekzaminonin ankuesen, pasi ajo ishte në Itali duke marrë trajtim special dhe nuk kishin qenë në gjendje të shqyrtonin raportet mjekësore të ardhura nga spitali italian. Ata përsëritën konkluzionin e shprehur në raportin mjekoligjor të datës 6 gusht 2009. Ata konkluduan, se, në bazë të dokumenteve që dispononin, në kohën kur u shkaktuan dëmtimet, ishin aq të rënda sa do të përbënin rrezik për jetën e ankueses, nëse nuk do t'i ishte dhënë ndihmë e specializuar mjekësore.

34. Më 2 shkurt 2010 prokurori i rrethit, në një vendim të arsyetuar, vendosi të pezullojë hetimin në lidhje me veprën penale të shkaktimit të plagosjes së rëndë me dashje, në përputhje me nenin 326 të Kodit të Procedurës Penale, për veprime të mëtejshme për identifikimin e autorit. Vendimi përshkruante të gjitha provat e marra dhe deklaratat e dhëna nga ankuesja dhe personat e tjerë. Vendimi shprehte, për aq sa është e arsyeshme, si më poshtë:

“... raportet mjekoligjore konkluduan se njëzet e pesë për qind e fytyrës, të barkut dhe të gjymtyrëve të sipërme të ankueses ishin djegur. Dëmtimet ishin shkaktuar nga një substancë

gërryese. Dëmtimet ishin aq të rënda sa do të përbënin rrezik për jetën e ankueses nëse nuk do t'i ishte dhënë ndihmë e specializuar mjekësore ... raporti i ekspertimit të gjurmëve të gishtave konkludonte se asnjë gjurmë gishtash nuk mund të identifikohet ...

FNS-ja u përgjigj se i mungonin pajisjet e specializuara të nevojshme për të hartuar raportet përkatëse të ekspertimit ...

ISP-ja u përgjigj se nuk ishte detyra e këtij institucioni që të kryente raportin e ekspertimit të kërkuar, në lidhje me ekzaminimin e rrobave që kishte veshur ankuesja në kohën e sulmit ...

Pas ekzaminimit të pamjeve filmike nga dy kamera aty pranë, askush nuk mund të identifikohet si i dyshuar për kryerjen e krimit, duke marrë parasysh tiparet e përmendura nga dëshmitarët në deklaratat e tyre; marrja e një kopje të CD-ROM-it nga banka tjetër ishte e pamundur, për shkak të vështirësive teknike të hasura me zbardhjen e saj ...

Përgjimet e komunikimeve telefonike nuk zbuluan asnjë bisedë me rëndësi për hetimin ...

U morën në pyetje tre individë të tjerë të cilët kishin kryer komunikime telefonike gjatë periudhës kur ndodhi sulmi, por pa rezultat ...

Është e qartë se prokurori i rrethit ndërmori veprime të shumta hetimore, të tilla si shqyrtimi i shumë provave, si dhe pyetja e ankueses. Për arsyet e mësipërme, janë kryer të gjitha veprimet e mundshme hetimore, por nuk ka qenë e mundur të identifikohet autori/ët e veprës penale ...”

35. Ankuesja, duke mos marrë asnjë komunikim tjetër zyrtar pas fillimit të hetimit, më 10 mars 2012 autorizoi Qendrën Shqiptare për Rehabilitimin e Traumës dhe Torturës (Qendra) për të ndjekur çështjen e saj.

36. Më 2 prill 2012 Qendra kërkoi informacion nga prokurori në lidhje me ecurinë e hetimit.

37. Më 17 prill 2012 prokurori informoi Qendrën se hetimi ishte pezulluar dhe dosja e çështjes i kishte kaluar policisë për veprime të mëtejshme, me qëllim identifikimin e autorit të sulmit. Qendra u informua se duhej të kërkonte kopje të dokumenteve që kërkonte nga autoriteti përkatës policor.

38. Më 19 prill 2012 Qendra kërkoi nga Drejtoria e Policisë Tiranë (DPT) që t'i dërgonte informacion në lidhje me ecurinë e hetimit.



39. Më 23 maj 2012, DPT-ja informoi Qendrën se hetimi vijonte dhe i vuri në dispozicion një kopje të raporteve mjekësore. Një kopje e vendimit të prokurorit ku pezullonte hetimin nuk mund të sigurohej pa autorizimin paraprak të prokurorit.

40. Më 5 dhjetor 2013 Qendra kërkoi nga prokurori që t'i siguronte një kopje të dosjes hetimore. Qendra, gjithashtu, nxiti prokurorin për gjetjen dhe dënimin e autorit.

41. Më 8 janar 2014 prokurori informoi Qendrën se hetimi ishte pezulluar, pasi autori i sulmit nuk mund të identifikohet. Dosja e çështjes i kishte kaluar tërësisht autoritetit policor, nga ku Qendra mund të merrte një kopje.

42. Dosja penale që u paraqit nga Qeveria si pjesë e vëzhgimeve të tyre tregonte se ishte hapur një hetim mbi veprat penale të shkakimit të plagosjes së rëndë me dashje dhe prodhimit dhe mbajtjes pa leje të armëve parashikuar respektivisht në nenet 88 dhe 279 të Kodit Penal. Në dy raste, më 30 tetor dhe 31 dhjetor 2009, prokurori ka zgjedhur hetimin me argumentin se hetimi ishte kompleks dhe se ishte e nevojshme pyetja e shumë individëve dhe ekzaminimi i disa akteve të tjera.

43. Duket se deri në fund të vitit 2015, kur palët dorëzuan parashtrimet e tyre me shkrim përpara Gjykatës, çështja ishte ende në pritje përpara autoriteteve policore, dhe palët nuk kanë dhënë ndonjë informacion të azhurnuar.

C. Procedimet gjyqësore në lidhje me veprën penale të prodhimit dhe mbajtjes pa leje të armëve

44. Më 29 korrik 2009, në banesën e E.A. u ushtrua kontroll dhe u gjetën dy thika, katër televizorë, dy kompjutera laptopë dhe një aparat telefonik. Këto mjete u konfiskuan më pas.

45. Më 30 korrik 2009 prokurori i rrethit i atribuoi E.A. veprën penale të prodhimit dhe të mbajtjes pa leje të armëve, sipas nenit 279 të Kodit Penal, me argumentin se ishin gjetur dy thika në banesën e E.A. (shih paragrafin 64 më poshtë).

46. Më 30 korrik 2009 E.A. u arrestua për kryerjen e veprës penale të prodhimit dhe të mbajtjes pa leje të armëve të ftohta. Më pas, prokurori caktoi ndaj tij masën e detyrimit për t'u paraqitur përpara policisë gjyqësore (masë shtrënguese), e cila u miratua nga gjykata e rrethit më 1 gusht 2009.

47. Më 6 gusht 2009 Komisariati i Policisë Tiranë deklaroi se sendet e sekuestruara në banesën

e E.A., më 29 korrik 2009, nuk përputheshin me përshkrimin e asnjë objekti që ishte vjedhur në territorin e mbuluar nga ai Komisariat.

48. Më 11 janar 2010 Ministria e Kulturës informoi prokurorin e rrethit se të dy thikat ishin për përdorim thjesht dekorativ.

49. Më 2 shkurt 2010 prokurori i rrethit, në një vendim të arsyetuar, pushoi hetimin në lidhje me veprën penale të prodhimit dhe mbajtjes pa leje të armëve të ftohta, në përputhje me të drejtën e procedurës penale (shih paragrafin 61 më poshtë). Gjithashtu urdhëroi heqjen e masës shtrënguese ndaj E.A. Vendimi përshkruante të gjitha provat e marra dhe deklarimet e dhëna nga ankuesja dhe të tjerët. Vendimi arsyetonte se meqenëse thikat ishin gjetur në banesën e E.A. dhe jo në një vend publik dhe se shkresa e Ministrisë së Kulturës e datës 11 janar 2010 deklaronte se ato ishin vetëm për përdorim dekorativ, ishte e qartë se nuk ishte kryer asnjë vepër penale.

D. Procedimet gjyqësore në lidhje me kërkesën e ankueses për dëmshpërblim

50. Më 2 maj 2012 ankuesja, duke u mbështetur në Konventën Evropiane për Kompensimin e Viktimave të Krimeve të Dhunshme (Konventa Evropiane për Kompensimin e Viktimave), depozitoi një kërkesë pranë Ministrisë së Drejtësisë ku kërkonte kompensim nga Shteti si rezultat i sulmit me acid (shih paragrafin 89 më poshtë).

51. Më 3 shtator 2012 ankuesja, duke u mbështetur në Konventën Evropiane për Kompensimin e Viktimave, nenet 625, 640 dhe 641 të Kodit Civil, si dhe në vendimin nr. 12/2007 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë (shih paragrafin 73 më poshtë), depozitoi një kërkesë për dëmshpërblim pranë Gjykatës së Rrethit Tiranë kundër Ministrisë së Drejtësisë, duke kërkuar kompensim nga Shteti si rezultat i sulmit me acid. Ajo, gjithashtu, kërkoi që të përjashtohet nga pagesa e tarifave gjyqësore, për shkak të mungesës së mjeteve financiare, dhe t'i përcaktohej masa e kompensimit nga ekspertë.

52. Ankuesja parashtrroi se e kishte tërhequr çështjen pasi e kishte të pamundur të paguante tarifat gjyqësore.

53. Më 30 maj 2013 Gjykata e Rrethit Tiranë vendosi pushimin e gjykimit kur ankuesja dhe avokati i saj nuk u paraqitën në seancë.



II. E DREJTA DHE PRAKTIKA E BRENDSHME PËRKATËSE

A. Kushtetuta

54. Dispozitat përkatëse të Kushtetutës parashikojnë si më poshtë:

Neni 21

“Jeta e personit mbrohet me ligj.”

Neni 25

“Askush nuk mund t’u nënshtrohet torturës, dënimit apo trajtimit mizor, çnjerëzor ose poshtërues.”

Neni 44

“Kushdo ka të drejtë të rehabilitohet dhe/ose të zhdëmtohet në përputhje me ligjin, në rast se është dëmtuar, për shkak të një akti, veprimi ose mosveprimi të paligjshëm të organeve shtetërore.”

B. Kodi i Procedurës Penale (KPP)

55. Dispozitat e KPP-së që ishin në fuqi në kohën materiale kishin përmbajtjen e mëposhtme.

56. Neni 24§4 parashikonte se urdhrat dhe direktivat e një prokurori të një niveli më të lartë ishin të detyrueshme për një prokuror të një niveli më të ulët. Neni 24§5 parashikonte se një prokuror i një niveli më të lartë, qoftë *proprio motu* ose pas një apelimi, kishte të drejtë të ndryshonte ose shfuqizonte vendimet e një prokurori të një niveli më të ulët.

57. Sipas nenit 61, personi që ka pësuar dëm pasuror si rezultat i kryerjes së një vepre penale mund të ngrejë padi civile gjatë procesit penal për të kërkuar dëmshpërblim. Sipas nenit 62§1, kërkesa duhej të depozitohet para fillimit të shqyrtimit gjyqësor. Në përputhjen me nenin 62§3, gjykata mund të vendosë veçimin e padisë civile nga procesi penal nëse gjykimi i saj vështirëson ose zvarrit procesin penal.

58. Neni 105 i KPP-së parashikonte të drejtën e çdo pale të interesuar të kërkojë, me shpenzimet e veta, kopje dhe ekstrakte të akteve të veçanta.

59. Neni 326 i KPP-së, që parashikonte të drejtën e prokurorit për pezullimin e hetimeve, citon si më poshtë:

“1. Kur nuk njihet autori i veprës penale (...), prokurori mund të vendosë pezullimin e hetimeve.

2. Pezullimi i hetimeve vendoset pasi të jenë kryer të gjitha veprimet e mundshme.

3. Hetimi i pezulluar mund të rifillojë me vendim të prokurorit.”

60. Në kohën materiale, KPP-ja nuk përmbante asnjë dispozitë specifike mbi të drejtën e ankimit kundër vendimit të prokurorit për pezullimin e çështjes/hetimit.

61. Neni 328 i KPP parashikon të drejtën e prokurorit për pushimin e çështjes/hetimit. Kundër vendimit të prokurorit që ka pushuar çështjen/hetimin mund të bëhet ankim në gjykatë në përputhje me nenin 329 të KPP-së.

Praktika ligjore e brendshme përkatëse në lidhje me pezullimin e hetimit

62. Në një rast, një ankues, H.S., paraqiti një ankesë pranë prokurorisë lidhur me vdekjen e motrës së tij. Prokurori e kishte pezulluar hetimin në bazë të nenit 326§1 të KPP-së me arsyetimin se nuk mund të gjendej asnjë autor i krimit. Ankuesi nisi procedurën ligjore kundër pezullimit të çështjes. Ai u ankua se nuk ishte informuar mbi përmbajtjen e dosjes hetimore dhe as mbi pezullimin e çështjes, se prokurori nuk kishte pyetur të gjithë dëshmitarët, dhe se ai nuk kishte mjet juridik efektiv për t’u ankuar, në lidhje me vendimin e pezullimit të çështjes. Gjykatat e brendshme e rrëzuan padinë e tij. Gjykata e Apelit Tiranë u shpreh, se, meqenëse hetimi vazhdonte dhe meqenëse prokuroria kishte diskrecionin për të vendosur kryerjen e veprimeve hetimore, ankuesi nuk kishte kompetencë ligjore. Ajo ripohoi se nuk ekzistonte e drejta e apelit kundër vendimit për pezullimin e procedimit penal, sipas legjislacionit procedural penal. Ankuesi paraqiti një ankesë kushtetuese pranë Gjykatës Kushtetuese, e cila u refuzua me vendimin nr. 4, datë 18 janar 2013. Gjykata Kushtetuese u shpreh, ndër të tjera, se nuk ekzistonte asnjë mjet juridik, sipas ligjit të brendshëm kundër vendimit të prokurorit për pezullimin e çështjes. Sidoqoftë, fakti që ankuesi kishte pasur akses në gjykatat e brendshme, tregonte se ai kishte të drejtën efektive për t’u ankuar në gjykatë.

C. Kodi Penal (KP)

63. KP-ja përbëhet nga kapituj të ndarë në seksione. Kapitulli II i pjesës specifike të KP-së u është kushtuar veprave penale kundër njeriut. Seksioni I i kapitullit mbulon krimet me dashje kundër jetës dhe, në kohën përkatëse, përmbante



më shumë se dhjetë dispozita të ndryshme për vrasje. Seksioni III i kapitullit II trajton krimet me dashje kundër shëndetit. Veprat e sulmit, të cilat më tej karakterizohen sipas nivelit të ashpërsisë së dëmit të shkaktuar, bien në seksionin III, të tilla si tortura (neni 86), shkaktimi i plagosjes së rëndë me dashje (neni 88), plagosja e lehtë me dashje (neni 89), dhe dëmtime të tjera me dashje (neni 90). Nga këto vepra, vetëm vepra penale e shkakimit të plagosjes së lehtë me dashje (neni 89) bie në kategorinë e çështjeve të ndjekjes private, të cilat duhet të dërgohen nga personi i interesuar drejtpërdrejt në gjykatën kompetente, dhe mund të tërhiqen në çdo fazë të procedurës (neni 284 i KKP-së).

64. Neni 88 i KP-së parashikon se shkaktimi i plagosjes së rëndë me dashje që ka sjellë si pasojë, gjymtimin, shpërfytyrimin ose çdo dëmtim tjetër të përhershëm të shëndetit, dënohet me burgim nga tre gjer në dhjetë vjet. neni 279 i KP-së parashikon, ndër të tjera, se prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve të ftohta dënohet me gjobë ose me burgim deri në pesë vjet.

65. Pas ndryshimeve të bëra në KP në vitin 2012, neni 130/a përcaktoi dhunën në familje si vepër penale. Rrahja, si dhe çdo vepër tjetër dhune, kanosja serioze për vrasje ose plagosje të rëndë, plagosja e kryer me dashje ndaj personit që është bashkëshort, ish-bashkëshort, bashkëjetues apo ish-bashkëjetues, gjini e afërt ose krushqi e afërt me autorin e veprës penale, me pasojë cenimin e integritetit fizik, psikosocial dhe ekonomik të tij, dënohet me burgim nga dy deri në pesë vjet.

66. Në vitin 2013 u bënë ndryshime në nenin 50 të KP-së, i cili konsideron si rrethanë rënduese kryerjen e një vepre penale gjatë ose pas dhënies së urdhrat gjyqësor të mbrojtjes të dhënë në lidhje me dhunën në familje.

D. Kodi Civil

67. Neni 608 i Kodit Civil parashikon se kushdo që në mënyrë të paligjshme dhe gabimisht i shkakton dëm një personi tjetër ose pasurisë së tij, është i detyruar të paguajë kompensim për dëmin. Personi që ka shkaktuar dëmin nuk përgjigjet kur provon se nuk ka faj.

68. Neni 609 parashikon se dëmi duhet të jetë rrjedhim i veprimi a mosveprimi të drejtpërdrejtë dhe të menjëhershëm.

69. Neni 625 parashikon se personi që pëson një dëm, të ndryshëm nga ai pasuror, ka të drejtë të

kërkojë kompensim kur ka pësuar dëmtim të shëndetit apo integritetit fizik ose mendor të tij ose nëse ose është cenuar në nderin, personalitetin ose reputacionin e tij, ose nëse është cenuar e drejta e tij e respektimit të jetës private.

70. Sipas nenit 640, dëmi pasuror përfshin humbjen e pësuar dhe fitimin e munguar. Shpenzimet e arsyeshme dhe ato të nevojshme mund të jenë gjithashtu subjekt kompensimi.

71. Sipas nenit 641, personi që i ka shkaktuar tjetrit një dëm në shëndetin e tij, duhet ta kompensojë dëmin, duke pasur parasysh humbjen ose pakësimin e aftësisë për punë të të dëmtuarit, shpenzimet që janë bërë për mjekimin e tij, si dhe shpenzime të tjera që kanë lidhje me dëmin e shkaktuar.

Praktika ligjore e brendshme përkatëse në lidhje me shlyerjen e dëmeve

72. Qeveria paraqiti disa praktika ligjore në lidhje me shlyerjen e dëmeve si pjesë e vëzhgimeve të saj.

73. Në vendimin unifikues nr. 12, datë 14 shtator 2007, pas kërkesës civile për dëmshpërblim dhe shpenzimet kundër Institucionit Shqiptar të Sigurimeve (subjekt shtetëror) për vdekjen e tre personave në një aksident automobilistik, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë vendosën, për sa është e rëndësishme, si më poshtë:

“... gjykatat e brendshme kanë pranuar që tre persona humbën jetën në një aksident automobilistik ... në thelb, sipas nenit 608 të Kodit Civil ... legjislacioni parashikon mbrojtjen e të drejtës së jetës, shëndetit, personalitetit, dinjitetit, jetës private e kështu me radhë nga aktet e paligjshme të një pale të tretë. Nëse ka shkelje të ndonjë prej këtyre të drejtave, si rrjedhojë e aktit të paligjshëm, pala e dëmtuar ka të drejtën e kompensimit ekstrakontraktual ... Në zbatim të nenit 609 të Kodit Civil, duhet të provohet lidhja materiale shkakësore ndërmjet sjelljes së paligjshme (veprimi a mosveprimi) si dhe fajit dhe dëmit. Në përcaktimin e dëmit real të shkaktuar nga fakti i paligjshëm dhe kompensimit përkatës, duhet të provohet, gjithashtu, lidhja juridike shkakësore midis tyre. Lidhja materiale shkakësore shërben për të identifikuar personin përgjegjës dhe lidhjet shkakësore midis tri elementeve të aktit të paligjshëm: sjellja e paligjshme, faji dhe pasoja që rrjedh prej tyre, që do të thotë dëmi i një personi tjetër ose pronës së tij ... Lidhja juridike shkakësore



shërben për të demonstruar lidhjet shkakësore midis aktit të paligjshëm, të marrë në tërësinë e tij, dhe shkeljes specifike të të drejtave dhe interesave të ligjshëm [të një personi tjetër]

...

Humbja e përfutimit [parashikuar në nenin 640 të Kodit Civil] ka të bëjë me pamundësinë për të marrë kompensim pasuror në të ardhmen, që është një aset që nuk i përkiste personit të dëmtuar në kohën kur është shkaktuar dëmi.

...

Kompensimi jopasuror për dëmtimin e shëndetit të personit, sipas nenit 625 të Kodit Civil, mund të kërkohet pavarësisht kërkesës për kompensim pasuror si rezultat i humbjes ose pakësimit të aftësisë për punë parashikuar në nenin 641 të Kodit Civil. Personi i dëmtuar që kërkon kompensim në zbatim të nenit 641 të Kodit Civil, ka barrën e provës së shumës së të ardhurave, që nuk mund t'i fitojë më për shkak të humbjes ose pakësimit të aftësisë për punë, pas përmbushjes së detyrimit për të demonstruar dëmtimin e shëndetit të tij, natyrën e përhershme ose të përkohshme të tij, si dhe shkallën e dëmit.”

74. Në një rast tjetër, një ankues kishte kërkuar kompensim nga subjekti shtetëror sipas nenit 640 të Kodit Civil, për dëmin e shkaktuar në shëndetin e tij nga një plagosje me armë zjarri shkaktuar nga oficerët e policisë së Shtetit. Me vendimin nr. 275, datë 24 shtator 2009, Gjykata e Lartë ia kaloi çështjen për rishqyrtim gjykatës përkatëse të apelit. Ajo arsyetonte se, për shkak të plagosjes së ankuesit nga oficerët e policisë së Shtetit, ishte provuar dëmi i shkaktuar në shëndetin e tij.

75. Në një vendim të datës 25 nëntor 2011, Gjykata e Rrethit Tiranë pranoi nga ankuesit një kërkesë civile për kompensim solidar kundër autoriteteve shtetërore dhe dy kompanive private të depozituar, *inter alia*, sipas nenit 625 dhe 640 të Kodit Civil, për shkak të vdekjes së familjarit të tyre nga një shpërthim masiv në një fabrikë të çmontimit të armëve. Gjykata arsyetoi se përgjegjësia penale ishte e pavarur nga detyrimi civil për të paguar kompensim, që lidhej vetëm me kompensimin për dëmin e shkaktuar nga aktiviteti i rrezikshëm i çmontimit.

E. Ligji për Dhunën në Familje (ligji nr. 9669 për masat kundër dhunës në marrëdhëniet familjare, datë 18 janar 2006, i ndryshuar me ligjet nr. 9914, datë 12 maj 2008,

nr. 10329, datë 30 shtator 2010 dhe nr. 47/2018 datë 23 korrik 2018)

76. Ligji për Dhunën në Familje, i cili hyri në fuqi më 1 qershor 2007, përcaktoi mekanizmin për mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje përmes një urdhri mbrojtjeje (UM), i cili mund të lëshohet nga gjykata civile me kërkesën e viktimës. Gjykata mund të japë përkohësisht urdhër të menjëhershëm mbrojtjeje (UMM), nëse autori ka kërcënuar se do të kryejë akte të dhunës në familje ose nëse autori paraqet një kërcënim të drejtpërdrejtë dhe të menjëhershëm për sigurinë, shëndetin apo mirëqenien e viktimës ose pjesëtarëve të tjerë të familjes (neni 19). UMM-ja është i vlefshëm deri në lëshimin e urdhrit të mbrojtjes me vendim gjykate. Ligji parashikon një mbrojtje më të mirë, jo vetëm për personat që janë aktualisht në marrëdhënie familjare, por edhe për personat që nuk janë më në një marrëdhënie të tillë, siç janë ish-bashkëshortët dhe ish-partnerët (neni 3).

77. Miratimi i një urdhri mbrojtjeje apo i një urdhri të menjëhershëm mbrojtjeje nuk e pengon viktimën që të nisë procedimin penal sipas Kodit Penal (neni 24). Policia, prokurori ose një organizatë joqeveritare mund të kërkojnë, gjithashtu, miratimin e një urdhri mbrojtjeje apo të një urdhri të menjëhershëm mbrojtjeje (neni 13). Kur kërkesa është bërë nga policia ose prokurori, tërheqja nga ana e viktimës nuk sjell pushimin e çështjes (neni 16).

78. Neni 10 rendit masat mbrojtëse me vendim gjykate. Pra, një urdhër mbrojtjeje mund të përfshijë, midis masave të tjera, largimin e autorit nga banesa e viktimës (pavarësisht të drejtave pronësore të autorit), ndalimin e autorit që t'i afrohet përtej një distance të caktuar viktimës apo pjesëtarëve të familjes së viktimës, ndalimin e autorit që të hyjë apo qëndrojë në banesën e përkohshme apo të përhershme të viktimës ose në ndonjë pjesë të saj, vendosjen e grave dhe fëmijëve të tyre në strehime të përkohshme apo një urdhër për pjesëmarrjen e autorit në programe rehabilitimi.

79. Ligji për dhunën në familje, gjithashtu, parashikon krijimin e një strehe për viktimat e dhunës në familje (neni 6 i ndryshuar) dhe një sistem të koordinuar për referimin pranë autoriteteve të çështjeve të dhunës në familje.

80. Shkelja e urdhrit të mbrojtjes përbën veprë penale sipas nenit 321 të KP-së dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në dy vjet.



III. E DREJTA DHE MATERIALET NDËRKOMBËTARE PËRKATËSE, NË LIDHJE ME DHUNËN ME BAZË GJINORE

A. Konventa e Kombeve të Bashkuara për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave

81. Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (Konventa CEDAW) u miratua në vitin 1979 nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara dhe Shqipëria e ratifikoi më 9 nëntor 1993. Zbatimi i Konventës CEDAW monitorohet nga Komiteti për Eliminimin e Diskriminimit ndaj Grave (Komiteti CEDAW), i cili bën rekomandime për shtetet palë mbi çështjet specifike që lidhen me eliminimin e diskriminimit ndaj grave.

82. Në sesionin e njëmbëdhjetë në vitin 1992, Komiteti CEDAW miratoi rekomandimin e përgjithshëm nr. 19 për dhunën ndaj grave (A/47/38). Rekomandimi përcaktonte dhunën me bazë gjinore, si: “dhunë që drejtohet ndaj një gruaje, sepse është grua ose që prek gratë në mënyrë disproporcionale”. Rekomandimi i përgjithshëm nr. 19 shprehte, se: “Shtetet mund të jenë, gjithashtu, përgjegjëse për aktet private, nëse dështojnë që të veprojnë me kujdesin e duhur për të parandaluar shkeljet e të drejtave ose për të hetuar dhe dënuar aktet e dhunës dhe për të siguruar kompensim”. Lidhur me komentet për nenet specifike të Konventës CEDAW, Rekomandimi i përgjithshëm nr. 19 thekson më tej, se: “qëndrimet tradicionale nga të cilat gratë vlerësohen si të varura nga burrat ose me role stereotipike, mbajnë gjallë praktika të përhapura që përfshijnë dhunën ose shtrëngimin, të tilla si: dhuna në familje dhe abuzimi, martesë e detyruar, vdekjet me motiv prikën, sulmet me acid dhe gjymtimi gjenital femëror. Paragjykime dhe praktika të tilla mund të justifikojnë dhunën me bazë gjinore si një formë e mbrojtjes ose kontrollit të grave. Efekti i një dhune të tillë në integritetin fizik dhe mendor të grave është privimi i tyre nga barazia në gëzimin, ushtrimin dhe njohjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore. Ndërsa ky koment adreson kryesisht dhunën aktuale ose kërcënuese, pasojat themelore të këtyre formave të dhunës me bazë gjinore ndihmojnë në mbajtjen e grave në role vartëse dhe kontribuojnë në nivelin e tyre të ulët të pjesëmarrjes politike, si dhe në nivelin e tyre më të ulët të arsimit, aftësive dhe mundësive për punë”.

83. Më 26 korrik 2017 Komiteti CEDAW azhurnoi rekomandimin e përgjithshëm të tij nr. 19, duke miratuar rekomandimin e përgjithshëm nr. 35, mbi dhunën me bazë gjinore ndaj grave (CEDAW/C/GC/35). Sipas rekomandimit të përgjithshëm nr. 35, dhuna me bazë gjinore ndaj grave: “është një nga mjetet themelore shoqërore, politike dhe ekonomike, me të cilat vazhdon pozita vartëse e grave në lidhje me burrat dhe rolet e tyre stereotipike”. Gjatë gjithë punës së tij, Komiteti [CEDAW] e ka bërë të qartë se kjo dhunë është një pengesë kritike për arritjen e barazisë thelbësore midis grave dhe burrave, si dhe për gëzimin nga gratë të të drejtave të njeriut dhe lirive themelore të parashikuara në Konventë. Kjo dhunë merr forma të shumfishta, duke përfshirë veprime ose mosveprime, që synojnë ose mund të shkaktojnë, apo rezultojnë në vdekje ose dëmtime, apo vuajtje fizike, seksuale, psikologjike ose ekonomike të grave, kërcënime për veprime të tilla, ngacmime, shtrëngime dhe privime arbitrare të lirisë. (...) Dhuna me bazë gjinore ndaj grave mund të arrijë në torturë ose trajtim mizor, çnjerëzor ose poshtërues në rrethana të caktuara, përfshirë rastet e përdhunimit, dhunës në familje ose praktikave të dëmshme. (...) Kur aktet e dhunës me bazë gjinore ndaj grave arrijnë në tortura ose trajtim mizor, çnjerëzor ose degradues, kërkohet një qasje me bazë ndjeshmërie gjinore për të kuptuar nivelin e dhimbjes dhe vuajtjeve të përjetuara nga gratë, dhe për të kuptuar se kërkesat e qëllimit për klasifikimin e akteve të tilla si torturë plotësohen, kur veprimet ose mosveprimet janë specifike gjinore ose kryhen ndaj një personi në bazë të gjinisë.

84. Komiteti CEDAW rekomandoi që masat të merren në fushën e parandalimit, mbrojtjes, ndjekjes penale dhe dënimit, kompensimit, mbledhjes së të dhënave dhe monitorimit, si dhe bashkëpunimit ndërkombëtar për të përsheptuar eliminimin e dhunës me bazë gjinore ndaj grave.

85. Sa i përket mbrojtjes, Komiteti CEDAW rekomandoi që Shtetet palë, ndër të tjera, “të miratojnë dhe të zbatojnë masa efektive për të mbrojtur dhe ndihmuar gratë ankuese dhe dëshmitare të dhunës me bazë gjinore përpara, gjatë dhe pas procedurave ligjore dhe për të siguruar që të gjitha procedurat ligjore, masat mbrojtëse dhe mbështetëse, si dhe shërbimet në lidhje me viktimat/të mbijetuarat respektojnë dhe forcojnë autonominë e tyre”.



86. Sa i përket ndjekjes penale dhe dënimit, Komiteti CEDAW rekomandoi që Shtetet palë, ndër të tjera: “a) të sigurojnë qasje efektive për viktimat në gjykata dhe që autoritetet t’u përgjigjen në mënyrën e duhur të gjitha rasteve të dhunës me bazë gjinore ndaj grave, përmes zbatimit të së drejtës penale dhe, sipas rastit, ndjekjes penale kryesisht për të dërguar autorët e dyshuar në gjyq në një mënyrë të drejtë, të paanshme, në kohë dhe të shpejtë dhe përmes dhënies së dënimeve të përshtatshme; tarifat gjyqësore nuk duhet të vihen për viktimat/të mbijetuarat; dhe b) të adresojnë faktorët që rrisin rrezikun e ekspozimit për gratë ndaj formave të rënda të dhunës me bazë gjinore, siç janë aksesueshmëria e gatshme dhe disponueshmëria e armëve të zjarrit, përfshirë këtu eksportin e tyre, një shkallë të lartë krimi dhe pandëshkueshmërie të përhapur, që mund të rriten në situata të konfliktit të armatosur apo pasigurisë së shtuar. Duhet bërë përpjekje për të kontrolluar disponueshmërinë dhe aksesueshmërinë e acidit dhe të substancave të tjera të përdorura për të sulmuar gratë”.

87. Sa i përket kompensimit, Komiteti CEDAW rekomandoi që Shtetet palë, ndër të tjera: “a) të sigurojnë kompensime efektive për viktimat/të mbijetuarat e dhunës me bazë gjinore ndaj grave. Kompensimet duhet të përfshijnë masa të ndryshme, të tilla si kompensimi monetar, sigurimi i shërbimeve ligjore, sociale dhe shëndetësore, përfshirë shërbimet seksuale, riprodhuese dhe të shëndetit mendor për një rikuperim të plotë, si dhe shpërbimin dhe garancitë e mospërsëritjes. Kompensime të tilla duhet të jenë të përshtatshme, të atribuara menjëherë, holistike dhe proporcionale me seriozitetin e dëmit të pësuar; dhe b) të krijojnë fonde specifike për kompensime ose të përfshijnë alokime në buxhetet e fondeve ekzistuese, përfshirë përdorimin e mekanizmave të drejtësisë tranzicionale për kompensimin e viktimave të dhunës me bazë gjinore ndaj grave”.

B. Materialet e Këshillit të Evropës

1. Konventa e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (Konventa e Stambollit)

88. Konventa e Stambollit u miratua nga Komiteti i Ministrave më 7 prill 2011. Konventa u hap për nënshkrim më 11 maj 2011 dhe hyri në fuqi më 1 gusht 2014. Shqipëria e ratifikoi Konventën e Stambollit më 4 shkurt 2013.

Konventa e Stambollit zbatohet për të gjitha format e dhunës ndaj grave, përfshirë dhunën në familje dhe siguron një kuadër gjithëpërfshirës për parandalimin, ndjekjen penale dhe eliminimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, si dhe mbrojtjen e viktimave.

2. Konventa Evropiane për Kompensimin e Viktimave të Krimeve të Dhunshme

89. Konventa Evropiane për Kompensimin e Viktimave u ratifikua nga Shqipëria më 26 nëntor 2004 dhe hyri në fuqi për Shqipërinë më 1 mars 2005. Ministria e Drejtësisë është Autoriteti Qendror për qëllime të Konventës Evropiane për Kompensimin e Viktimave. Konventa Evropiane për Kompensimin e Viktimave i kërkon Palëve Kontraktuese, në mungesë të kompensimit nga burime të tjera, të kontribuojnë në kompensimin e viktimave të veprave të qëllimshme dhe të dhunshme, të cilat janë kryer në territorin e tyre dhe kanë rezultuar në lëndime trupore ose vdekje. Kompensimi duhet të akordohet edhe nëse shkelësi i ligjit/fajtori nuk është ndjekur penalisht ose dënuar.

90. Raporti Shpjegues i Konventës shpreh se Konventa Evropiane për Kompensimin e Viktimave nuk është drejtpërdrejt e zbatueshme dhe se u takon “Shteteve kontraktuese të përcaktojnë bazën ligjore, kuadrin administrativ dhe metodat e funksionimit të skemave të kompensimit”.

3. Rekomandimi i Komitetit të Ministrave (2002)5 për mbrojtjen e grave kundër dhunës

91. Në Rekomandimin (2002)5 të datës 30 prill 2002 për mbrojtjen e grave kundër dhunës, Komiteti i Ministrave të Këshillit të Evropës rekomandoi, ndër të tjera, që Shtetet anëtare duhet “të kenë detyrimin për të treguar kujdesin e duhur për parandalimin, hetimin dhe dënimin e akteve të dhunës, qoftë këto të kryera nga shteti apo persona privatë, dhe të sigurojnë mbrojtje për viktimat”.

92. Komiteti i Ministrave rekomandoi, në veçanti, që Shtetet anëtare duhet të penalizojnë dhunën serioze ndaj grave, të tillë si dhuna seksuale dhe përdhunimi, abuzimi me cënueshmërinë e viktimave shtatzëna, të pambrojtura, të sëmura, me aftësi të kufizuara ose të varura, si dhe penalizimin e abuzimit me pozitën nga autori. Rekomandimi, gjithashtu, shprehte se shtetet anëtare duhet të sigurojnë që të gjitha viktimat e dhunës janë në gjendje të nisin procedurat, të marrin masa për të



siguruar që procedimet penale mund të fillojnë nga prokurori publik, të inkurajojnë prokurorët që ta konsiderojnë dhunën ndaj grave si një faktor rëndues ose vendimtar në marrjen e vendimit, nëse do të ndiqet penalisht apo jo për interes publik, të sigurojnë kur është e nevojshme marrjen e masave për të mbrojtur viktimat në mënyrë efektive nga kërcënimet dhe aktet e mundshme të hakmarrjes, si dhe të marrin masa specifike për të siguruar mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve gjatë procedimeve.

C. Raportet për dhunën me acid

1. Raporti i Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara për dhunën ndaj grave

93. Në një raport për dhunën ndaj grave të datës 20 gusht 2004 (A/59/281), Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara paraqiti informacion në lidhje me legjislativin, politikën dhe masat e tjera të ndërmarra nga vende të ndryshme dhe institucione të tjera ndërkombëtare, për të luftuar të gjitha format e dhunës ndaj grave, si dhe krimet ndaj grave të kryera në emër të nderit. Me rëndësi të veçantë për rastin në fjalë ishte fakti që Bangladeshi kishte miratuar, ndër të tjera, Aktin e Kontrollit të Acidit në vitin 2002 dhe që një gjykatë speciale ishte krijuar në të gjithë vendin për të trajtuar rastet që kishin të bënin me dhunën ndaj grave.

2. Raporti i Raportueses Speciale të Kombeve të Bashkuara për dhunën ndaj grave, shkaqet dhe pasojat për misionin e saj në Bangladesh

94. Në vitin 2013 Raportuesja Speciale e Kombeve të Bashkuara për dhunën ndaj grave kreu një vizitë zyrtare në Bangladesh për të shqyrtuar situatën e dhunës ndaj grave në këtë vend. Në raportin e saj për Asamblenë e Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara (A/HRC/26/38/Add.2), Raportuesja Speciale u shpreh, *inter alia*, si më poshtë:

“11. Përhapja e sulmeve me acid mbetet një çështje problematike në vend, dhe këto sulme ndodhin në familje dhe në komunitet. Organizatat e shoqërisë civile raportuan 31 raste të dhunës me acid në Bangladesh për periudhën nga janari deri në gusht 2013. Nga këto raste, 22 sulme janë kryer kundër ndaj grave dhe 4 ndaj vajzave. Po kështu, në vitin 2012 gratë dhe vajzat ishin viktimat kryesore të sulmit me acid, ku nga një total prej 105 rastesh, 58 gra dhe 20 vajza ishin shënjestra e një sulmi të tillë. Acidi, përgjithësisht, hidhet në fytyrë ose organet seksuale të viktimave femra kur

refuzojnë kërkesat për marrëdhënie seksuale apo propozimet për martesë. Qëllimi përfundimtar është dëmtimi i paraqitjes së viktimës për t'i shkatërruar perspektivën e saj për martesë.

55. Për sa u përket sulmeve me acid, Akti i Kontrollit të Krimeve me Acid i vitit 2002 përcakton se dënimi për vrasjen e një personi me acid ose plagosja e personit me pasojë humbjen e shikimit, dëgjimit, apo dëmtimin ose shpërftyrimin e fytyrës, gjoksit ose organeve seksuale, mund të rezultojë në dënimin kapital ose burgim të përjetshëm dhe një gjobë që nuk tejkalon një *lakh taka* (afërsisht 1190 USD). Gjithashtu, dëmtimi ose shpërftyrimi i ndonjë pjese të trupit do të rezultojë në një dënim me 14 vjet burg ose të paktën 7 vjet ‘burgim i rreptë’.”

3. Opinioni i Komisionit për Liritë Civile, Drejtësinë dhe Çështjet e Brendshme i Parlamentit Evropian për dhunën ndaj grave.

95. Më 14 janar 2014 Komisioni për Liritë Civile, Drejtësinë dhe Çështjet e Brendshme i Parlamentit Evropian i dhanë një opinion Komisionit të Parlamentit Evropian për luftimin e Dhunës ndaj Grave në një mocion për një rezolutë të Parlamentit Evropian, në lidhje me dhunën ndaj grave. Opinioni deklaronte se dhuna ndaj grave mund të përfshijë, pa kufizim, “dhunën në marrëdhënie të afërta, përdhunimin, përfshirë dhunimin martesor, dhunën me motiv prikën, gjymtimin gjenital femëror, hedhjen e acidit, martesën e detyruar, abuzimin seksual, prostitucionin e detyruar dhe pornografinë, trafikimin e grave dhe vetëvrasjen e detyruar”.

4. Materiale të tjera përkatëse

a) Luftimi i dhunës me acid në Bangladesh, Indi dhe Kamboxhia

96. Në vitin 2011, Qendra Avon Global për Gratë dhe Drejtësi në *Cornell Law School*, Komiteti për të Drejtat Ndërkombëtare të Njeriut të Dhomës së Avokatisë së *New York*-ut, Klinika për të Drejtat Ndërkombëtare të Njeriut e *Cornell Law School* dhe *Virtue Foundation*, duke pasur parasysh incidencën e lartë të regjistruar të dhunës me acid në Bangladesh, Indi dhe Kamboxhia, nxorën një raport për luftimin e dhunës me acid në këto vende. Raporti theksonte se shpesh sulmet me acid kryhen ndaj grave, sepse ato shkelin normat gjinore që i kalojnë ato në pozita vartëse. Për më tepër, detyra për të parandaluar shkeljen e të drejtave të njeriut përfshin detyrimin për të miratuar



legjislacionin e hartuar për frenimin e dhunës me acid. Përveç legjislacionit, qeveritë duhet: 1. të kryejnë hetime të duhura për sulmet me acid; 2. të mbrojnë viktimat nga kërcënimet që mund të minojnë këto hetime; dhe 3. të ndjekin penalisht dhe të ndëshkojnë autorët e sulmeve me acid.

b) Drejtësi? Çfarë drejtësie? Trajtimi i dhunës me acid dhe sigurimi i drejtësisë për të mbijetuarit

97. Në vitin 2015, Fondacioni *Thompson Reuters, Acid Trust international* dhe *J. Sagar Associates* nxorën një studim krahasues mbi legjislacionin ekzistues dhe zbatimin e tij për luftimin e dhunës me acid në katër vende: Kamboxhia, Kolumbi, Indi dhe Mbretërinë e Bashkuar. Për sa i takon ekzistencës së kuadrit ligjor, raporti deklaronte se në Kolumbi ekzistonte një ligj i veçantë për acidin, sipas të cilit dhuna me acid ishte një vepër penale e veçantë dhe specifike. Në Indi dhe në Mbretërinë e Bashkuar nuk ekzistonte ndonjë legjislacion i veçantë për trajtimin e dhunës me acid. Në vend të kësaj, ekzistonin dispozita në ligje të tjera penale të cilat e trajtonin plagosjen përmes përdorimit të substancës gërryese si vepër penale dhe parashikonin dënime të rënda për plagosje të tilla.

98. Për sa i përket ndjekjes penale të veprave penale, raporti thekson, se: “qëllimi për të kryer veprën penale *mens rea* dhe akti real që përben veprën *actus reus* janë të dy elemente thelbësore. Sidoqoftë, ka raste të caktuara kur përgjegjësia është absolute, d.m.th., thjesht ndodhja e incidentit është e mjaftueshme për të formuar një vepër penale pavarësisht ekzistencës apo mungesës së qëllimit. Raporti thekson se neni 20 i ligjit të veprave penale kundër personit (OAPA) i Mbretërisë së Bashkuar, që nuk zbatohet për Skocinë, e bën atë një vepër që i shkakton dëme të rënda trupore një personi pa ndonjë kërkesë për të synuar kryerjen e një dëmi të tillë. Sipas kësaj dispozite mund të ngrihen akuza për rastet kur kalimtarët janë lënduar rastësisht si rezultat i një sulmi. Nga ana tjetër, sipas nenit 29 të OAPA-së, një vepër thuhet se është kryer pavarësisht nëse në të vërtetë është shkaktuar dëmtimi nga kryerja e veprës, me kusht që shkelësi i ligjit të ketë qëllimin e nevojshëm”.

99. Sa u përket ndëshkimeve, raporti shtonte, se: “ligjet zakonisht parashikojnë një spektër dënimesh dhe gjykatësit vendosin për dënimin brenda këtij spektri, bazuar në një sërë faktorësh duke përdorur diskrecionin e tyre. Në Indi, konsideratat për rritjen

ose uljen e dënimeve janë shumë të paqëndrueshme dhe nuk ka udhëzime të qarta për dënimin. Për krahasim, manuali i dënimit i Shërbimit të Prokurorisë së Kurores në Angli dhe Uells vë në dukje përdorimin e acidit si një faktor që tregon për fajësinë më të lartë të shkelësit të ligjit, duke ndikuar kështu në ashpërsinë e dënimit. Në Kolumbi, dënimi varet edhe nga pjesa e trupit që preket dhe deformimi i fytyrës konsiderohet më i rëndë”.

IV. MATERIALI PËRKATËS KOMBËTAR DHE NDËRKOMBËTAR, NË LIDHJE ME SITUATËN E GRAVE NË SHQIPËRI

A. Raportet kombëtare

1. Vrojtimet kombëtare me bazë popullatën nga Instituti i Statistikave

100. Në mars 2009, Instituti i Statistikave (INSTAT) nxori një raport kërkimor mbi “Dhunën në familje në Shqipëri: Një vrojtim kombëtar me bazë popullatën” mbi bazën e të dhënave të mbledhura në vitin 2007. Qëllimi i sondazhit kombëtar të vitit 2007 ishte të gjeneronte të dhëna dhe gjetje të besueshme mbi natyrën dhe përhapjen e dhunës në familje në vend, që do të përdroreshin për të bërë të ditur hartimin e masave dhe politikave efektive parandaluese, mbrojtëse dhe ato ligjore. INSTAT-i kreu sondazhe të reja në vitin 2013 dhe 2018, ku gratë u pyetën për përvojat e tyre “ndonjëherë” dhe “aktualisht” për secilën nga format e ndryshme të dhunës në familje.

101. Të dyja vrojtimit kombëtare, me bazë popullatën, konfirmuan se dhuna në familje ndaj grave ishte një problem i përhapur në familjet dhe komunitetet në të gjithë Shqipërinë. Gjetjet zbuluan se raporti i grave që kishin përjetuar “ndonjëherë” një formë të dhunës në familje ishte rritur nga 56.09% në vitin 2007, në 59.4% në vitin 2013. Vrojtimet dokumentonin qartë se gratë vazhdonin të përjetonin lloje të shumta të dhunës në familje njëkohësisht në familjet e tyre dhe në marrëdhëniet intime, përfshirë format e shumta të dhunës psikologjike, fizike dhe seksuale.

102. Në vitet 2007 dhe 2013 gratë e dhunuara zbuluan se shpesh kanë përjetuar pak a shumë të njëjtat lëndime që lidhen me dhunën në familje me shkallë të ndryshme ashpërsie. Në vitin 2007, 48.3% e grave që përjetonin dhunë në familje raportuan se ishin plagosur me prerje, ënjtje ose dhimbje, ndërsa në vitin 2013 vetëm 18.8% e grave të abuzuara fizikisht “ndonjëherë” raportuan se



kanë përjetuar lëndime që lidhen me dhunën në familje.

103. Vrojtimi kombëtar, me bazë popullatën, i vitit 2018, i cili u botua në mars 2019, ishte përpjekja e tretë në Shqipëri për të mbledhur të dhëna mbi dhunën ndaj grave dhe vajzave, duke përfshirë jo vetëm dhunën në familje, por edhe dhunën në një lidhje, dhunën nga një jopartner, abuzimin seksual të fëmijëve, ngacmimin seksual dhe përndjekjen. Të dhënat në sondazhin e vitit 2019 siguruan prova se dhuna ndaj grave dhe vajzave ishte e përhapur dhe se prekte shumicën e grave. Sondazhi i vitit 2018 zbuloi se 52.9% e grave të moshës 18–74 përjetonin “ndonjëherë” një ose më shumë nga pesë llojet e ndryshme të dhunës (dhunë nga një partner intim, dhunë në një lidhje, dhunë nga një jopartner, ngacmim seksual dhe/ose përndjekje) gjatë jetës së tyre dhe 36.6% e grave përjetonin dhunë “aktualisht”. 75.4% e grave raportuan se dhuna në familje ndaj grave është një problem i madh në Shqipëri. 70.8% e grave raportuan se dhuna seksuale ndaj grave dhe vajzave është një problem i madh në Shqipëri, 69.9% raportuan se ngacmimi seksual i grave dhe vajzave është një problem i madh në Shqipëri, dhe 68.4% raportuan se përndjekja e grave dhe e vajzave është një problem i madh në Shqipëri. Duke pasur parasysh këto gjetje, nuk është për t'u habitur që shumica e grave pohonin se është shumë e rëndësishme që në Shqipëri të ketë ligje që mbrojnë gratë dhe vajzat nga dhuna në martesën/familjet e tyre (83.0%) dhe nga ngacmimi seksual dhe përdhunimi (81.9%).

104. Sondazhi i vitit 2018 mati, gjithashtu, normat sociale në lidhje me dhunën ndaj grave dhe vajzave, perceptimin e grave për seriozitetin e dhunës ndaj grave dhe vajzave dhe rëndësinë e ekzistencës së legjislacionit, në lidhje me dhunën ndaj grave dhe vajzave. Sa u takon normave sociale për dhunën në familje, sondazhi i vitit 2018 konstatoi se 52.2% e grave të moshës 18–74 mendonin se të gjithë apo shumica e njerëzve në komunitet besojnë se dhuna midis burrit dhe gruas është një çështje private dhe se të tjerët nuk duhet të ndërhyjnë, dhe 46.5% mendonin se të gjithë apo shumica e njerëzve në komunitet besojnë se gruaja duhet të tolerojë njëfarë dhune për të mbajtur familjen të bashkuar. Gjithashtu, 27.5% e grave mendonin se të gjithë apo shumica e njerëzve në komunitet besojnë se kur një grua rrihet nga burri i

saj, faji apo gabimi është pjesërisht i saj dhe se një grua duhet të ketë turp apo të ndihet keq të flasë me dikë jashtë familjes së saj për abuzimin apo dhunën në familjen e saj. Këto norma sociale mund të kontribuojnë në përhapjen e dhunës në familje nga një partner intim ndaj grave dhe të mbajnë gratë e dhunuara të mbërthyer në marrëdhënie abuzive dhe të dhunshme.

2. Raporti i Qendrës për Nisma Ligjore Qytetare

105. Në nëntor 2010, Qendra për Nisma Ligjore Qytetare botoi raportin për zbatimin e ligjit për dhunën në familje. Raporti monitoroi urdhrat e mbrojtjes dhe urdhrat e menjëhershëm të mbrojtjes të lëshuar nga Gjykata e Rrethit Tiranë, për periudhën 1 janar 2009 deri më 1 janar 2010. Sipas raportit, ka pasur një rritje të madhe të numrit të grave që raportojnë incidente në polici, gjë që ka ndodhur, për shkak të ndërgjegjësimit në rritje të grave mbi rëndësinë e raportimit të dhunës në familje, si dhe të përgatitjes më të mirë dhe kualifikimeve nga ana e organeve përkatëse që i pranuan dhe i ndihmuan viktimat e dhunës në familje.

3. Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi

106. Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi (Komisioneri kundër Diskriminimit) u krijua përmes aktit antidiskriminim (ligji nr. 10221, 4 shkurt 2010), dhe është organi kombëtar përgjegjës për sigurimin e barazisë dhe mbrojtjes efektive nga diskriminimi.

107. Në raportin vjetor të vitit 2011, Komisioneri kundër Diskriminimit deklaroi, se “gratë vuajnë nga dhuna në familje”. Në raportin vjetor të vitit 2012, Komisioneri kundër Diskriminimit deklaroi, se: “janë raportuar disa raste të dhunës ndaj grave, të cilat ndonjëherë kanë rezultuar në humbjen e jetës së grave të dhunuara. Sipas statistikave të siguruar nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë janë identifikuar 2,526 raste të dhunës në familje, gjë që shënoi një rritje me 345 raste krahasuar me një vit më parë. Një rritje e tillë është reflektuar edhe në rritjen e numrit të kërkesave për urdhër mbrojtjeje, të cilat kishin arritur në 1,562 në vitin 2012, pra 217 kërkesa më shumë se një vit më parë”.



B. Raportet ndërkombëtare

1. Materialet e Këshillit të Evropës

a) Raporti i Grupit të Ekspertëve kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje (GREVIO)

108. Monitorimi i Konventës së Stambollit sigurohet nga dy organe të dallueshme: Grupi i Ekspertëve kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje (GREVIO), një organ i pavarur ekspertësh dhe Komiteti i Palëve, një organ politik i përbërë nga përfaqësues të Shteteve palë të Konventës.

109. Raporti i vlerësimit i GREVIO-s për Shqipërinë i vitit 2017 (GREVIO/Inf(2017)13) deklaroi, se: “statistikat zyrtare për rastet e dhunës në familje portretizojnë një tablo të përzier, ku shifrat e larta janë ana tjetër e përpjekjeve që synojnë inkurajimin e raportimit. Nga viti 2010 deri më 2014-ën, rastet e raportuara të dhunës në familje u rritën ndjeshëm me afërsisht tri herë më shumë viktime gra se sa burra. Dhuna në familje tejkalon shumë të gjitha krimet e tjera si vepra penale me numrin më të madh të viktimave dhe në vitin 2015, vetëm vdekjet që lidhen me dhunën në familje përfaqësonin 37% të të gjitha vdekjeve të nxitura nga krimi”.

110. Në raportin e vlerësimit të GREVIO-s thuhet më tej, se: “të dhënat për dhunën në familje lejojnë krijimin e një tabloje të besueshme të realitetit të dhunës në familje në Shqipëri. Sidoqoftë, të dhënat për format e tjera të dhunës ndaj grave, të tilla si dhuna seksuale, mezi lënë të kuptohet për ekzistencën e një fenomeni i cili nga shumë dëshmi mbetet një territor kryesisht i panjohur, i rrethuar nga tabu dhe nga mosraportimi i theksuar”. Raporti i nxiste autoritetet “të bënin dhunën në familje ndaj grave dhe natyrën gjinore të formave të tjera të dhunës ndaj grave më të dukshme në statistikën e krimit të paraqitura në publik, duke identifikuar qartë numrin e viktimave gra, sipas llojit të veprës. Kjo do të përfshinte zbulimin qartazi para publikut të informacionit mbi numrin e vrasjeve të grave nga burrat (vrasjet e grave me lidhje gjinore); dhe hartimin e kategorive të të dhënave mbi llojin e marrëdhënies midis autorit dhe viktimës për të gjitha format e dhunës ndaj grave gjë që do të çonte në dokumentimin më specifik të natyrës së marrëdhënies së tyre”.

111. Për sa i përket së drejtës së viktimës për të kërkuar kompensim, raporti i vlerësimit të GREVIO-s citon si më poshtë:

“115. Në zbatim të nenëve 61 deri 68 të [Kodit të Procedurës Penale] (KPP), viktimat e dhunës kanë të drejtë të aplikojnë, në kuadër të procedimeve penale për kompensim në lidhje me dëmet e pësuar për veprën penale. Pretendimet për kompensim të zgjidhura në procedimet penale kufizohen në dëmshpërblimin ekonomik dhe shlyerja e tyre varet nga rezultati i gjyqimit penal. Në mënyrë alternative, viktimat mund të paraqesin një kërkesë për kompensim që shtrihet në të gjitha format e dëmit, përfshirë dëmin jopasuror, sipas nenit 625 të Kodit Civil. Nuk disponohet informacion që dëshmon se ndonjë viktimë e dhunës ndaj grave, përfshirë dhunën në familje, ka filluar ndonjëherë apo ka përfituar nga procedime të tilla. Raportet e paraqitura pranë GREVIO-s theksojnë tarifat e larta gjyqësore si një nga faktorët që pengojnë aksesin e viktimave në kompensim, pavarësisht parimit të përcaktuar me ligj se viktimat e dhunës në familje përjashtohen nga tarifat gjyqësore. Për më tepër, nuk ka asnjë skemë kompensimi shtetëror në dispozicion për viktimat e dhunës ndaj grave në Shqipëri. Asnjë rezervim nuk u përfshi nga Shqipëria, duke e përjashtuar atë nga zbatimi i nenit 30, paragrafi 2, i Konventës mbi kompensimin shtetëror ndihmës për lëndime të rënda trupore ose dëmtimin e shëndetit”.

112. Në dritën e masave të identifikuara në raportin e vlerësimit të GREVIO-s, Komiteti i Palëve rekomandoi që Qeveria të ndërmarrë hapa për të siguruar, ndër të tjera, aksesin e viktimave në mjetet juridike civile kundër autoriteteve shtetërore, në veçanti, përmes informimit të viktimave për të drejtat e tyre dhe ndërgjegjësimin të zyrtarëve publikë në lidhje me to, si dhe të krijojë dhe financojë në mënyrën e duhur një sistem efektiv të ndihmës ligjore për viktimat e të gjitha formave të dhunës ndaj grave që mbulohet nga Konventa dhe të nxisë ushtrimin e së drejtës së viktimave për akses në ndihmë juridike.

b) Raportet e Komisionerit për të Drejtat e Njeriut

113. Pas vizitës zyrtare në Shqipëri nga 27 tetori deri më 2 nëntor 2007, si pjesë e misionëve të rregullta në vend, Komisioneri botoi raportin e tij më 18 qershor 2008 (CommDH(2008)8), i cili thekson, për aq sa është e rëndësishme, se dhuna



ndaj grave, veçanërisht dhuna në familje, ishte një shkelle e përhapur e të drejtave të njeriut që karakterizohej nga mosraportimi, moshetimi, mosndjekja penale dhe mosdënimi në Shqipëri. Ekzistonte një numër i pacaktuar i shkelësve të ligjit që gëzonin pandëshkueshmëri, pasi krimi ende shihej si një çështje private dhe për këtë arsye raportohesh rrallë.

114. Pas një vizite zyrtare në Shqipëri, në intervalin 23 deri më 27 shtator 2013, Komisioneri nxori raportin e tij më 13 janar 2014 (CommDH(2014)1), i cili vinte në dukje se në maj 2013 ishin miratuar ndryshimet e bëra në ligjin për ndihmën juridike, të cilat e ngarkonin Komisionin Shtetëror me dhënien e përjashtimeve nga pagesa e tarifave gjyqësore në kushte të caktuara. Ato përcaktonin se përfituesit e ndihmës juridike, kur paraqesin ankesa civile ose administrative në gjykatë, mund të përjashtohen nga tarifat gjyqësore (dhe shpenzimet gjyqësore), nëse provojnë se janë, ndër të tjera, viktima të dhunës në familje. Kërkesa do të shqyrtohej nga Komisioni Shtetëror për Ndihmë Juridike, brenda dhjetë ditësh nga paraqitja e kërkesës. Nëse Komisioni nuk vendoste mbi kërkesën, brenda dhjetë ditësh ose e refuzonte atë, gjykata mund të vendoste mbi kërkesën për përjashtimin e tarifës në seancën paraprake.

2. Vëzhgimet përfundimtare të Komitetit CEDAW, në lidhje me Shqipërinë

115. Shqipëria ka paraqitur tri raporte periodike pranë Komitetit për Eliminimin e Diskriminimit ndaj Grave mbi zbatimin e vëzhgimeve të CEDAW-s.

116. Në vëzhgimet përfundimtare të vitit 2003 mbi raportet e kombinuara periodike fillestare dhe të dyta të paraqitura nga Shqipëria (A/58//38), Komiteti CEDAW shprehu: “shqetësimin për incidencën e lartë të dhunës ndaj grave, përfshirë dhunën në familje dhe mungesën e mbledhjes sistematike të të dhënave për dhunën ndaj grave, e posaçërisht për dhunën në familje”. Komiteti i kërkoj Shqipërisë: “të miratojë legjislacionin për dhunën në familje dhe të sigurojë se dhuna ndaj grave ndiqet penalisht dhe ndëshkohet me seriozitetin dhe shpejtësinë e kërkuar dhe të krijojë një strukturë për mbledhjen sistematike të të dhënave mbi dhunën ndaj grave, përfshirë këtu dhunën në familje”.

117. Në vëzhgimet përfundimtare të 16 shtatorit 2010 mbi raportin e tretë periodik të paraqitur nga

Shqipëria (CEDAW/C/ALB/CO/3), Komiteti CEDAW mbetej: “i shqetësuar për përhapjen e lartë e të vazhdueshme të dhunës ndaj grave në Shqipëri”. Komiteti ishte veçanërisht i shqetësuar, se: “dhuna në familje nuk është sanksionuar dhe kriminalizuar siç duhet” dhe për: “shkallën e lartë të vetëvrasjeve të femrat viktima të dhunës në familje, për mangësitë në [ligjin për dhunën në familje] dhe zbatimin e tij si dhe mungesën e të dhënave statistikore”. Komiteti CEDAW rekomandonte, ndër të tjera, që “[autoritetet] të forcojnë përpjekjet [e tyre] për të siguruar se femrat viktima të dhunës kanë mbrojtje të menjëhershme” dhe “zyrtarët publikë, veçanërisht zyrtarët e zbatimit të ligjit, anëtarët e pushtetit gjyqësor, ofruesit e kujdesit shëndetësor dhe punonjësit socialë, janë plotësisht të sensibilizuar për të gjitha format e dhunës ndaj grave dhe të krijohen struktura për të ndihmuar femrat viktima të dhunës për të rindërtuar jetën e tyre”.

118. Në vëzhgimet përfundimtare të 25 korrikut 2016 mbi raportin e katërt periodik të paraqitur nga Shqipëria (CEDAW/C/ALB/CO/4), Komiteti CEDAW ishte i shqetësuar: “për mungesën e zbatimit të legjislacionit mbi barazinë gjinore dhe mosdiskriminimin, si dhe mungesën e monitorimit të zbatimit të ligjeve dhe politikave të tilla, [dhe që] gratë, veçanërisht ato që u përkasin grupeve të pafavorizuara dhe të marginalizuara, mbeten të pavetëdijshme për të drejtën e tyre për ndihmë juridike dhe vazhdojnë të përballen me pengesa të konsiderueshme ligjore dhe praktike për të fituar akses në drejtësi, gjë që reflektohet në numrin e ulët të ankesave të depozituara. Komiteti është, gjithashtu, i shqetësuar për problemin e përhapur të mosekzekutimit të urdhrave të gjykatës, përfshirë këtu urdhrat për pagesën e detyrimit financiar”. Komiteti [CEDAW] është i shqetësuar se dhuna me bazë gjinore ndaj grave mbetej mbizotëruese, gjë që reflektohej nga: “a) shkalla e ulët e raportimit të rasteve të dhunës me bazë gjinore ndaj grave, për shkak të aksesit të kufizuar të grave në shërbimet e ndihmës juridike, veçanërisht në zonat rurale dhe të thella, si dhe mungesa e shërbimeve të linjës telefonike për gratë që janë viktima të një dhune të tillë; b) zbatimi i pamjaftueshëm i mekanizmit kombëtar të referimit që synon parandalimin dhe sigurimin e mbrojtjes nga dhuna me bazë gjinore, në veçanti në nivel lokal, për shkak të mungesës së koordinimit ndërmjet subjekteve përgjegjëse dhe



mungesës së aftësive dhe kapaciteteve të nevojshme në radhët e stafit përgjegjës; c) numri i pamjaftueshëm i strehëzave për gratë që janë viktime të dhunës me bazë gjinore dhe kriteret kufizuese për pranimin në strehëza, si dhe mungesa e shërbimeve rehabilituese mjekësore dhe psikologjike për gratë; dhe d) dështimi i vazhdueshëm për të zbatuar urdhrat e mbrojtjes dhe urdhrat e menjëhershëm të mbrojtjes”.

3. Progresraportet e Komisionit Evropian

119. Komisioni Evropian nxjerr progresraporte vjetore për vendet që dëshirojnë të aderojnë në Bashkimin Evropian. Progresraportet analizojnë, ndër të tjera, kapacitetet e këtyre vendeve për të zbatuar standardet evropiane.

120. Në progresraportin për Shqipërinë 2008 (SEC(2008) 2692) thuhej, ndër të tjera, se: “strategjia për parandalimin e dhunës në familje nuk është zbatuar, për shkak të mungesës së mekanizmave zbatues. Përqindja e grave që kanë vuajtur nga dhuna në familje është e konsiderueshme dhe në rritje. Ajo që nevojitet tani është alokimi i burimeve të mjaftueshme njerëzore dhe financiare për të siguruar zbatimin e plotë të legjislacionit”.

121. Në progresraportin e vitit 2009 (SEC(2009)1337) thuhej, ndër të tjera, se: “dhuna në familje mbetet e përhapur”. Shumë incidente nuk janë raportuar. Të dhëna të sakta mungojnë. Kërkohen masa të mëtejshme për të forcuar nivelin e mbrojtjes për gratë viktime të dhunës në familje, përfshirë fushatat ndërgjegjësuere të medieve dhe trajnimet e specializuara për gjyqtarët”.

122. Në raportin analitik të vitit 2010 (SEC(2010) 1335) thuhej: “Dhuna në familje është një fenomen i vazhdueshëm, që prek shumë familje në Shqipëri dhe është një çështje serioze shqetësuese (...) [Rastet] vazhdojnë të mos raportohen në shkallë të madhe, si dhe të hetohen dhe të ndiqen penalisht në mënyrë të pamjaftueshme, veçanërisht në zonat rurale. Një numër relativisht i vogël ankesash çojnë në ndjekje penale, pasi zakonisht është detyrë e viktimës për të nisur këtë procedurë. Detyra e prokurorit për të filluar një ndjekje penale ndodh vetëm në rastet që rezultojnë me vdekje, plagosje të rëndë ose kërcënim për jetën. Mbrojtja e grave dhe e viktimave të tjera ndaj të gjitha formave të dhunës duhet të forcohet në mënyrë të konsiderueshme”.

4. Raporti i *Amnesty International*

123. Në mars 2006, *Amnesty International*, bazuar në kërkimet e bëra përfshirë monitorimin e dokumentacionit për procedimet penale dhe raportet në medien shqiptare, për një periudhë trevjeçare, si dhe në kërkimet e OJQ-ve, profesionistëve dhe akademikëve, nxori një raport për Shqipërinë me titull: “Dhuna ndaj grave në familje: Nuk është turp për të”. Raporti, ndër të tjera, citonte si më poshtë:

“Të paktën një e treta e grave në Shqipëri vlerësohet se kanë përjetuar dhunë fizike në familjet e tyre. Ato janë goditur, rrahur, dhunuar dhe në disa raste edhe vrarë. Shumë të tjera kanë duruar dhunë psikologjike, kontroll fizik dhe ekonomik (...). Bashkëshortët, ish-bashkëshortët dhe partnerët janë përgjegjës për shumicën e abuzimeve të tilla, por edhe pjesëtarët e tjerë të familjes mund të bëhen pjesë apo mbështesin akte dhune, të cilat shpesh mund të pranohen nga komuniteti i gjerë në të cilin jeton gruaja.

Qëndrimet sociale dhe vlerat kulturore – jo vetëm nga publiku i gjerë, agjentët [shtetërorë], të tillë si policia, por edhe vetë gratë – i nxisin gratë të pranojnë dhunën. Një gjë e tillë nuk është e paevitueshme dhe as nuk nënkupton, se [Shteti] mund të heqë dorë nga përgjegjësia. Shqipëria është përgjegjëse për dështimin e saj në adresimin e qëndrimeve të tilla që mbështesin abuzimin e vazhdueshëm të grave. Për shkak të ndjenjës së fortë të turpësimit dhe të mungesës së besimit te policia, gratë rrallë i drejtohen policisë, por edhe kur në raste të veçanta e bëjnë një gjë të tillë, policia nuk arrin të njohë dhunën në familje si çështje penale dhe shpesh dështon të hetojë pretendimet/akuzat e dhunës në familje. Për më tepër, prokurorët, në përgjithësi, ngrenë akuza vetëm në rastet e vdekjes ose të plagosjes serioze ose të kanosjeve me armë zjarri ose me armë të tjera. Gratë, zakonisht, nuk inkurajohen të paraqesin ankesa ndaj sulmuesve të tyre, dhe nuk marrin mbrojtje efektive nga sulmet ose kërcënimet, përfshirë ato me armë zjarri, nga burrat dhe të afërmit e tyre. Personat përgjegjës – me përjashtim të rasteve të vdekjes apo të plagosjes shumë të rëndë – shpesh nuk vihen para drejtësisë. Ekziston mungesë qëndrueshmërie në qasjen nga ana e gjyqësorit dhe të paktën në një rast të njohur nga *Amnesty International*, gjykatat kanë treguar butësi ndaj autorëve që vrasin gra për shkak të ‘nderit’”.



124. Raporti kërkonte: “përgjigje të koordinuar kundër dhunës ndaj grave në familje, qasje të integruar të multiagjencive që përfshin jo vetëm autoritetet ligjzbatuese dhe ligjore, por edhe profesionistët e kujdesit shëndetësor dhe të arsimit (...) Kur masat parandaluese dështojnë, zyrtarët e zbatimit të ligjit dhe prokurorët duhet të regjistrojnë dhe të monitorojnë incidentet e raportuara, të veprojnë për mbrojtjen e viktimave të dhunës, si dhe t’u përgjigjen me shpejtësi dhe efektivitet pretendimeve apo kanosjeve të dhunës ndaj grave. Prokurorët dhe gjyqësori duhet të sigurojnë vënien para drejtësisë të autorëve të krimit. Gratë duhet të kenë aksesin e duhur në mekanizmat ligjorë, që ofrojnë mbrojtjen e tyre, si dhe në kujdesin shëndetësor dhe strehëzat që sigurojnë mbrojtje fizike, ndihmë mjekësore dhe mbështetje psikologjike”.

E DREJTA

I. SHKELJA E PRETENDUAR E NENIT 2 TË KONVENTËS

125. Ankuesja u ankua, sipas neneve 2, 3 dhe 8 të Konventës, se autoritet kishin dështuar të mbronin jetën e saj. Ajo më tej u ankua për dështimin e autoriteteve në kryerjen e një hetimi të plotë dhe efektiv që do të çonte në identifikimin, ndjekjen penale dhe dënimin e autorit të sulmit.

126. Duke qenë master i karakterizimit që u duhet dhënë fakteve të çështjes me ligj, Gjykata nuk është e detyruar nga karakterizimi i dhënë nga ankuesja ose një qeveri (shih *Radomilja dhe të Tjerë k. Kroacisë* [GC], nr. 37685/10 dhe 22768112, §126, 20 mars 2018). Gjykata konsideron që ankimet e ankuesit të ngritura në bazë të neneve 3 dhe 8 duhet të shqyrtohen nga këndvështrimi i nenit 2, nën aspektet e saj thelbësore dhe procedurale, për aq sa ato lidhen me të drejtën e ankuesve për jetën. Dispozita, për sa është e rëndësishme, parashikon si më poshtë:

Neni 2

“E drejta e çdo njeriu për jetën mbrohet me ligj.”

A. Pranueshmëria

1. Parashtrimet e palëve

127. Qeveria parashtrroi se ankuesja nuk ka paraqitur asnjë ankim para gjykatave të brendshme. Ajo, gjithashtu, nuk ka arritur të paraqesë kërkesë

civile për dëmshpërblim, sipas neneve 608, 625 dhe 640 të Kodit Civil, si dhe vendimit unifikues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë të datës 14 shtator 2007, ose një kërkesë civile gjatë procedimeve penale, sipas nenit 61 të KPP-së. Kërkesa e ankueses për dëmshpërblim para gjykatës së rrethit është tërhequr, për shkak të mosparaqitjes në seancë. Për më tepër, ankuesja, ka abuzuar me të drejtën e saj të ankimit, pasi nuk ka apeluar kundër vendimit të prokurorit për pezullimin e hetimit dhe nuk ka përdorur mjete të tjera juridike. Asnjë vendim i formës së prerë nuk është dhënë ende nga autoritetet.

128. Qeveria, gjithashtu, parashtrroi se kërkesa është paraqitur përtej afatit gjashtëmuor, duke sjellë pezullimin e procedimeve më 26 shkurt 2010 dhe vendimin e formës së prerë më 30 maj 2013. Ankuesja është njoftuar sipas rregullave për vazhdimin e hetimit.

129. Ankuesja parashtrroi se nuk kishte asnjë mjet juridik efektiv që mund të përdorte. Ajo nuk i është drejtuar Gjykatës me një kërkesë të drejtpërdrejtë për kompensim; në vend të kësaj, ankimi i saj është përqendruar në paaftësinë e Qeverisë për të mbrojtur jetën dhe shëndetin e saj. Kërkesa civile për dëmshpërblim nuk do të çonte në identifikimin dhe dënimin e personave përgjegjës për shkeljen e nenit 2 të Konventës. Në çdo rast, përdorimi i mjetit juridik, sipas Kodit Civil, mund të ishte efektiv vetëm pasi të ishte identifikuar autori i veprës. Mjeti juridik, sipas nenit 61 të KPP-së mund të përdorej vetëm në rast se çështja do të ishte dërguar për gjykim para një gjykate të brendshme. Për më tepër, Qeveria ka dështuar të paraqesë praktikën e brendshme në lidhje me përdorimin e dhunës ndaj grave. Asnjë kompensim nuk i është akorduar ndonjëherë grave që kanë pësuar dhunë. Praktika ligjore e brendshme e paraqitur nga Qeveria nuk ishte e zbatueshme në rastin e ankueses, pasi të gjitha çështjet ishin të ndryshme nga çështja e saj.

130. Ankuesja, më tej, parashtrroi se autoritetet nuk kishin qenë të kujdesshme dhe nuk i ishin përgjigjur kërkesës së saj për informacion për herë të parë më 17 prill 2012. Për më tepër, prokurori nuk e ka njoftuar ankuesen për veprimet e tij hetimore dhe gjithashtu nuk i ka vënë në dispozicion një kopje të këtyre veprimeve, duke bërë kështu të pamundur për ankuesen kundërshtimin e tyre. Në çdo rast, ligji nuk



parashikonte asnjë apelim kundër vendimit të prokurorit për pezullimin e vendimit. Autoritetet nuk ishin në gjendje të identifikonin apo dënonin autorin e veprës për shkeljen e nenit 2 të Konventës. Pra, situata e ankueses vijonte të ishte e njëjtë.

2. Vlerësimi i Gjykatës

a) Zbatueshmëria e nenit 2

131. Në lidhje me zbatueshmërinë e nenit 2 të çështjes në fjalë, Gjykata konstaton se ankuesja pretendon se lëndimet e saj ishin shkaktuar nga një individ dhe jo nga një agjent i Shtetit. Sidoqoftë, Gjykata kujton se mungesa e një përgjegjësie të drejtpërdrejtë të Shtetit për vdekjen e një personi nuk përjashton zbatimin e nenit 2 të Konventës (shih, për shembull, *Yotova k. Bullgarisë*, nr. 43606/04, §68, 23 tetor 2012).

132. Gjykata më tej kujton se mbrojtja e kësaj dispozite të Konventës mund të bëhet jo vetëm në rastin e vdekjes së viktimës nga aktet e dhunshme. Neni 2 bëhet, gjithashtu, efektiv në situatat ku personi në fjalë ishte viktimë e një aktiviteti a sjelljeje, qoftë publike apo private, e cila nga natyra e vet e vuri jetën e tij/saj në një rrezik real dhe të pashmangshëm dhe ai/a jo ka pësuar dëmtime që duken me rrezik për jetën, edhe pse ai/a jo përfundimisht ka mbijetuar (shih, ndër të tjera, *Nicolae Virgiliu Tănase k. Rumanisë* [GC], nr. 41720/13, §140, 25 qershor 2019; *Makaratzis k. Greqisë* [GC], nr. 50385/99, §55, ECHR 2004-XI, dhe *Soare dhe të Tjerë k. Rumanisë*, nr. 24329/02, §108, 22 shkurt 2011). Në çështjen në fjalë Gjykata vëren se ankuesja iu nënshtrua një sulmi të dhunshëm, i cili rezultoi në dëmtime të rënda, dhimbje dhe shpërfytyrimin e njëzet e pesë për qind të trupit të saj. Ajo u dërgua në spital në gjendje kritike (shih paragrafin 6 më lart) dhe sipas raportit të datës 18 dhjetor 2009, jeta e saj do të ishte në rrezik nëse nuk do të ishte dhënë ndihmë e specializuar mjekësore (shih paragrafin 33 më lart). Rrjedhimisht, Gjykata vlerëson se metoda e përdorur nga sulmuesi ishte e një natyre dhe intensiteti që mund të rrezikonte jetën e ankueses. Rrjedhimisht, neni 2 i Konventës është i zbatueshëm në këtë rast.

b) Mosrespektimi i rregullit gjashtëmujor sipas nenit 35§1 të Konventës

133. Gjykata përsërit se qëllimi i rregullit gjashtëmujor sipas nenit 35§1 të Konventës është të promovojë sigurinë ligjore dhe të sigurojë që

çështjet e ngritura sipas Konventës të trajtohen brenda një kohe të arsyeshme (shih, për shembull, *Lopes de Sousa Fernandes k. Portugalisë* [GC], nr. 56080/13, §129, 19 dhjetor 2017, dhe *Opuz k. Turqisë*, nr. 33401/02, §110, ECHR 2009). Sipas praktikës së saj ligjore të mirëpërcaktuar, kur nuk ka mjet juridik të brendshëm në dispozicion, periudha gjashtëmujore fillon nga data e paraqitjes së ankimit për aktin.

134. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se ankuesja është sulmuar nga një person i panjohur më 29 korrik 2009. Një hetim është hapur nga prokurori, i cili më 2 shkurt 2010 e pezulloi hetimin. Ankuesja nuk u njoftua asnjëherë mbi rezultatin e hetimit. Më specifikisht, vetëm më 17 prill 2012, pas kërkesës së Qendrës për informacion, prokurori e informoi atë se hetimi ishte pezulluar. Megjithatë, prokurori e informoi Qendrën se dosja e çështjes i kishte kaluar policisë për veprime të mëtejshme me qëllim identifikimin e autorit të sulmit. Më 23 maj 2012 policia informoi Qendrën se hetimi vazhdonte. Vetëm më 8 janar 2014 prokurori informoi Qendrën se hetimi ishte pezulluar, për shkak të mosidentifikimit të autorit të sulmit (shih paragrafin 41 më lart).

135. Gjykata vëren, se meqenëse autoritetet informuan Qendrën më 8 janar 2014 se hetimi ishte pezulluar, për shkak të mosidentifikimit të autorit të sulmit, ky rast mund të konsiderohet si data në të cilën ankuesja u vu në dijeni mbi paefektshmërinë e mjeteve juridike në të drejtën e brendshme. Gjykata, gjithashtu, vëren se para kësaj, ankuesja kishte kontaktuar autoritetet disa herë për t'u informuar mbi ecurinë e hetimit. Duke pasur parasysh që këto rrethana tregojnë se ankuesja veproi me kujdesin e duhur në paraqitjen e ankimit të saj pasi u bë e qartë se nuk do të kishte ndreqje për ankesat e saj, Gjykata vlerëson se data përkatëse për qëllimet e afatit gjashtëmujor nuk duhet të konsiderohet të jetë më herët se 8 janari 2014 (shih, për shembull, *Mocanu dhe të Tjerë k. Rumanisë* [GC], nr. 10865/09 dhe 2 të tjerë, §§258-269, ECHR 2014 (ekstraktet)).

136. Në kontekstin specifik të kësaj çështjeje, rezulton se ankimet e ankueses janë paraqitur brenda afatit gjashtëmujor të parashikuar në nenin 35§1 të Konventës. Rrjedhimisht, Gjykata rrëzon kundërshtimin paraprak të Qeverisë në këtë drejtim.



c) Mosshterimi i mjeteve juridike të brendshme

137. Gjykata vëren, se Qeveria ka ngritur dy kundërshtime bazuar në kërkesën për shterimin e mjeteve juridike të brendshme. Së pari, Qeveria pretendonte se ankuesja nuk ka paraqitur kërkesë për dëmshpërblim dhe, së dyti, argumentoi se ankuesja nuk e kishte kundërshtuar vendimin e prokurorit për pezullimin e hetimit, ku për pasojë nuk ishte dhënë asnjë vendim i formës së prerë.

138. Në lidhje me kundërshtimin e parë të Qeverisë, Gjykata vëren se ishte hapur një hetim nga prokurori. Ankuesja kishte pritur se do të njoftohej për rezultatin e hetimit dhe se do t'i tregohet që autori ishte identifikuar dhe dënuar sipas së drejtës penale. Në lidhje me këtë, Gjykata vëren se, duke pasur parasysh përshkrimin e praktikës së brendshme të paraqitur nga Qeveria, do të ishte shumë e vështirë për ankuesen që të provonte çështjen e saj, nëse do t'i drejtohej procedimit civil sipas Kodit Civil, duke kërkuar dëmshpërblim për dëmtimet e pësuar pa identifikuar autorin. Sa i përket paraqitjes së një kërkesë civile gjatë procedimit penal, sipas nenit 61 të KPP-së, Gjykata vëren se një kërkesë e tillë mund të paraqitet vetëm nëse çështja ishte dërguar për gjykim para gjykatave të brendshme. Në rrethana të tilla si në këtë rast, kur çështja nuk është dërguar asnjëherë për gjykim, Gjykata nuk e sheh se si mund të ketë qenë efektiv ky mjet juridik (shih, gjithashtu, paragrafin 111 më lart).

139. Në çdo rast, Gjykata vlerëson se kërkohen dispozita efikase të së drejtës penale për të siguruar parandalimin efektiv kundër kërcënimeve ndaj së drejtës për jetën. Mjetet juridike civile ku bazohet Qeveria nuk mund të konsiderohen si të mjaftueshme për përmbushjen e detyrimeve të një shteti kontraktues, sipas nenit 2 të Konventës në raste të tilla si ky në fjalë, sepse qëllimi i tyre është përfundimi i dëmshpërblimit dhe jo parandalimi, pengimi dhe dënimi i shkeljeve, sipas dispozitave të tilla (shih *Akeliene k. Lituanisë*, nr. 54917/13, §69, 16 tetor 2018). Rrjedhimisht, Gjykata rrëzon kundërshtimin e parë të Qeverisë bazuar në mosshterimin e mjeteve juridike të brendshme në këtë drejtim.

140. Në lidhje me kundërshtimin e dytë të Qeverisë, Gjykata vëren se ankueses i është ndaluar të kundërshtonte vendimin e prokurorit për pezullimin e hetimit, pasi KPP nuk parashikonte

ndonjë të drejtë të tillë. Në vendimin e saj të datës 18 janar 2013 Gjykata Kushtetuese theksoi se nuk ekzistonte asnjë mjet juridik, sipas së drejtës së brendshme kundër vendimit të prokurorit për pezullimin e një hetimi (shih paragrafin 62 më lart). Ishte në diskrecionin e prokurorit për të rihapur ose jo një hetim, siç parashikohet në nenin 326 të KPP-së (shih paragrafin 59 më lart, si dhe *Piboni k. Shqipërisë*, nr. 74389/13, §95, 13 shkurt 2018). Në këto rrethana, Gjykata rrëzon kundërshtimin e dytë të Qeverisë.

d) Përfundim

141. Gjykata vëren se këto ankime nuk janë haptazi të pabazuara në kuptim të nenit 35§3 (a) të Kushtetutës. Gjykata, më tej, vëren se ato nuk janë të papranueshme për ndonjë arsye tjetër. Rrjedhimisht, ato duhet të deklarohen të pranueshme.

B. Themeli

1. Parashtrimet e palëve

a) Parashtrimet e ankueses

142. Sipas nenit 2 të Konventës, ankuesja parashtroi se sulmi me acid kundër saj ka qenë i rëndë dhe ka kërcënuar të drejtën e saj të jetës. Ajo parashtroi se kuadri legjislativ në vend nuk ofronte mbrojtje të mjaftueshme për gratë kundër dhunës, pasi autoritetet kishin dështuar të përmbushnin detyrimet e tyre sipas Konventës së Stambollit. Neni 88 i Kodit Penal, për shembull, nuk ishte në përputhje me Nenin 49 të Konventës së Stambollit. Për më tepër, Konventa nuk zbatohet nga autoritetet në nivel vendor në rastet e dhunës ndaj grave. Në dritën e të dhënave statistikore mbi frekuencën e dhunës ndaj grave, autoritetet duhet të kishin dijeni dhe të merrnin masat parandaluese të nevojshme për të mbrojtur ankuesen. Ajo, gjithashtu, parashtroi se hetimi nuk kishte qenë efektiv, i plotë dhe i shpejtë. Autoritetet kishin dështuar të merrnin masat e nevojshme, në faktin që ato nuk ishin në gjendje të ekzaminonin llojin e substancës së gjetur në enë ose të ekzaminonin enën që mbante autori, apo të identifikonin gjurmët e gishtave në enë, ose të ekzaminonin rrobat e ankueses. Për më tepër, nuk ishte marrë asnjë masë për të përcaktuar se si ishte blerë substanca gërryese ose si ishte përfunduar nga autori. Ankuesja nuk ishte njoftuar për zgjatjen e hetimit apo për vendimin e prokurorit për pushimin e hetimit ndaj E.A. Autoritetet nuk kishin arritur të ngrinin dyshime, në lidhje me ndonjë person tjetër dhe



asnjë veprim i mëtejshëm nuk ishte ndërmarrë prej tyre që nga pezullimi i hetimit. Ankuesja nuk ishte përfshirë në hetim dhe asnjëherë nuk i ishte ofruar dokumentacion që detajonte veprimet hetimore të ndërmarra.

b) Parashtrimet e Qeverisë

143. Qeveria parashtroi se ankuesja nuk i është nënshtruar dhunës në familje apo dhunës, sipas nenit 2 të Konventës. Kuadri legjislativ në fuqi në atë kohë parashikonte mbrojtjen e duhur për viktimat e dhunës në familje në formën e Kushtetutës, disa konventa për të drejtat e grave që ishin ratifikuar nga Shqipëria, dhe një ligj specifik mbi dhunën në familje që ishte në fuqi. Për më tepër, në vitin 2012, Kodi Penal ishte ndryshuar për të parashikuar një veprë specifike të dhunës në familje dhe abuzimit, dhe ishte hartuar një plan kombëtar veprimi.

144. Sa i përket situatës së përgjithshme, në lidhje me dhunën në familje në Shqipëri, Qeveria parashtroi disa të dhëna nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, për periudhën nga janari deri në dhjetor 2014. Sipas këtyre të dhënave policia kishte identifikuar 4,121 vepra penale të dhunës në familje dhe vepra të tjera penale që kishin ndodhur në ambientin familjar, në lidhje me 2,422 nga të cilat policia kishte krijuar procedurat e veta ligjore për nxjerrjen e një urdhri mbrojtjeje apo një urdhri të menjëhershëm mbrojtjeje. Policia kishte nisur procedimet penale dhe i kishte dërguar dosjet prokurorit për 1,797 rastet e mbetura. Numri i përgjithshëm i viktimave kishte qenë 3,090 nga të cilat 1,789 kishin qenë bashkëshortja e autorit të krimit. 551 autorë ishin arrestuar gjatë kryerjes së veprës; 48 ishin ndaluar dhe 147 të tjerë ishin ende në kërkim nga policia. Gjatë vitit 2014, janë identifikuar 17 raste vrasjesh me pasojë vdekjen e 22 personave. Ishin 10 viktima femra të vrasjeve në familje, nga të cilat 6 kishin qenë bashkëshortja e autorit përkatës.

145. Qeveria, më tej, parashtroi se, me qëllim mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje, policia kishte ndërmarrë hapat në vijim: një plan veprimi i datës 14 prill 2014, “Për zbatimin e plan veprimit kombëtar, 2011–2015”; përgatitja e kërkesave civile për nxjerrjen e urdhrave të mbrojtjes dhe urdhrave të menjëhershëm të mbrojtjes; ndjekja e zbatimit të vendimeve të gjykatave të brendshme; fillimi i procedimeve penale ndaj kujtdo që shkelte urdhrat e mbrojtjes; bashkëpunimi me institucione të tjera

dhe organizata të shoqërisë civile; fushata të ndryshme në qytete të ndryshme të vendit; trajnimi i oficerëve të policisë etj.

146. Duke iu kthyer çështjes në fjalë, Qeveria parashtroi se hetimi ka qenë efektiv dhe i plotë, ku ankuesja ka qenë në gjendje të përdorë të gjitha mjetet juridike për realizimin e të drejtave të saj. Prokurori kishte nisur hetimin menjëherë dhe kishte ndërmarrë disa veprime hetimore. Prokurori, gjithashtu, kishte arrestuar ish-bashkëshortin e ankuses. Ankuesja nuk e kishte kundërshtuar vendimin e prokurorit për pezullimin e hetimit. Hetimi është pezulluar për arsye që nuk varehin nga sjellja e palëve. Autoritetet nuk i kanë mohuar ankuses të drejtën e saj për t’u informuar dhe për të bashkëpunuar gjatë hetimit. Ishte vetë ankuesja që nuk i kishte dhënë ndihmën e duhur autoriteteve.

2. Vlerësimi i Gjykatës

a) Aspekti material

147. Gjykata përsërit, se fjalia e parë e nenit 2§1, jo vetëm ndalon Shtetin të kryejë marrjen e qëllimshme dhe të paligjshme të jetës, por edhe i kërkon të marrë hapat e duhur për të mbrojtur jetën e personave në juridiksionin e tij (shih *L.C.B. k. Mbretërisë së Bashkuar*, 9 qershor 1998, §36, Raportet e Gjykimeve dhe Vendimeve 1998-III). Kjo përfshin detyrën kryesore për Shtetin që të sigurojë të drejtën e jetës, duke vënë në zbatim dispozita të ligjit penal efektiv për parandalimin e kryerjes së veprave ndaj një personi të mbështetur nga mekanizmat ligjzbatues, me qëllim parandalimin, pengimin dhe dënimin e shkeljeve të dispozitave të tilla (*Mastromatteo k. Italisë* [GC], nr. 37703/97, §67, ECHR 2002-VIII). Kjo pjesë, gjithashtu, shtrihet në rrethana të përshtatshme për një detyrim pozitiv mbi autoritetet për të marrë masa operacionale dhe parandaluese për mbrojtjen e individit, jeta e të cilit është në rrezik nga aktet kriminale të një individi tjetër (shih *Osman k. Mbretërisë së Bashkuar*, 28 tetor 1998, §115, Raportet e gjykimeve dhe vendimeve 1998-VIII; *Giuliani dhe Gaggio k. Italisë* [GC], nr. 23458/02, §244, ECHR 2011 (ekstrakte); dhe *Fernandes de Oliveira k. Portugalisë* [GC], nr. 78103/14, §108, 31 janar 2019).

148. Duke pasur parasysh vështirësitë e qenësishme në policimin e shoqërive moderne, paparashikueshmërinë e sjelljes njerëzore dhe zgjedhjet operacionale që duhen bërë në drejtim të prioriteteve dhe burimeve, objekti i detyrimit



pozitiv për të marrë masa operacionale dhe parandaluese duhet të interpretohet në një mënyrë që nuk vendos barrë të pamundur dhe disproporcionale mbi autoritetet. Pra, jo çdo rrezik i pretenduar për jetën, mund të bëjë të nevojshme për autoritetet një kërkesë të Konventës për të marrë masa operacionale për të parandaluar materializimin e këtij rreziku. Që të lindë një detyrim pozitiv, duhet të përcaktohet se autoritetet kishin dijeni ose duhet të kishin dijeni në kohë, mbi ekzistencën e një rreziku real dhe të menjëhershëm për jetën e një individit të identifikuar, që rezulton nga aktet kriminale të një pale të tretë. Kur Gjykata konstaton se autoritetet kishin dijeni ose duhet të kishin dijeni për këtë rrezik, ajo duhet të vlerësojë nëse këto autoritete morën masat brenda objektit të kompetencave të tyre, të cilat, gjykuar në mënyrë të arsyeshme, mund të pritej që të shmangnin këtë rrezik (shih, mes shumë të tjerësh, *Osman, cituar më lart*, §116; *Fernandes de Oliveira* [GC], cituar më lart, §110; dhe *Nicolae Virgilin Tanase* [GC], cituar më lart, §136).

149. Për sa më lart, Gjykata duhet të përcaktojë nëse ka ekzistuar një kuadër legjislativ efektiv në Shqipëri në atë kohë dhe nëse autoritetet kishin dijeni, ose duhet të kishin dijeni mbi ekzistencën e një rreziku real dhe të menjëhershëm për jetën ose integritetin fizik të ankueses.

150. Gjykata vëren në fillim se faktet e çështjes kanë të bëjnë me një sulm të rëndë me acid mbi ankuesen të kryer nga një individ i paidentifikuar. Gjykata vëren se në Shqipëri një vepër penale është subjekt i ndjekjes penale publike, përveç nëse bie në kategorinë e krimeve që janë subjekt i ndjekjes private. Në kohën përkatëse, Kodi Penal parashikonte një numër veprash të kryera kundër jetës ose shëndetit të një personi. Këto vepra, përfshirë atë të parashikuar në nenin 88 të KP-së, sipas të cilit prokurori hapi hetimin penal për sulmin me acid, janë subjekt i hetimit nga prokurori me zgjedhjen e tij (shih paragrafin 63 më lart). Gjykata është e kënaqur që, në mungesë të ndonjë argumenti nga ankuesja se dispozitat e ligjit penal ishin joefektive, ekzistonte një kuadër legjislativ efektiv në Shqipëri në kohën përkatëse, në lidhje me krimet kundër jetës dhe shëndetit. Gjykata, më tej, vëren, megjithëse jo në lidhje me çështjen në fjalë, se, pas ndryshimeve legjislative të bëra në vitet 2012 dhe 2013, Kodi Penal përmban dispozita specifike që ndalojnë dhunën në familje dhe

rrahjen, si dhe kriminalizimin si rrethanë rënduese të kryerjes së një veprë tjetër gjatë ose pas një urdhri mbrojtjeje të gjykatës dhënë në lidhje me ndodhjen e dhunës në familje (shih paragrafët 65 dhe 66 më lart).

151. Gjykata, më tej, vëren se ankuesja dyshonte që ish-bashkëshorti i saj kishte qenë sulmuesi/agresori, pas sulmit me acid, duke pasur parasysh edhe dhunën në familje së cilës ajo pretendon se i ishte nënshtruar në të kaluarën. Ankuesja u ankua për dhunën e ish-bashkëshortit ndaj saj për herë të parë, kur dha deklaratën para prokurorit të rrethit pas sulmit me acid më 29 korrik 2009. Deklarata e ankueses është konfirmuar nga pjesëtarët e familjes së ankueses. Sidoqoftë, nuk duket që ankuesja, ndonjëherë para sulmit, të ketë sjellë në vëmendjen e autoriteteve ndonjë rrezik që i është paraqitur në jetën e saj nga ish-bashkëshorti i saj, gjë që do të kishte nxitur detyrimin pozitiv të autoriteteve për të marrë masa parandaluese ose hapa të tjerë të arsyeshëm në mbrojtje të jetës së ankueses (krahasoni dhe kontrastoni *Osman*, cituar më lart, dhe *Civek k. Turqisë*, nr. 55354/11, 23 shkurt 2016). Në këndvështrimin e Gjykatës, në rrethanat e çështjes në fjalë, Gjykata nuk mund të shohë se si autoritetet shtetërore mund të mbahen përgjegjëse për mosparandalimin e sulmit ndaj ankueses.

152. Rezulton se nuk ka pasur shkelje të nenit 2 të Konventës, në lidhje me detyrimin pozitiv të autoriteteve për të mbrojtur jetën dhe integritetin fizik të ankueses.

b) Aspekti procedural

153. Gjykata kujton se detyrimi pozitiv i Shtetit në mbrojtje të jetës së personave brenda juridiksionit të tij kërkon në mënyrë të nënkuptuar se duhet të ekzistojë një formë e hetimit zyrtar efektiv ku ka arsye për të besuar se një individ ka pësuar dëmtime kërcënuese për jetën në rrethana të dyshimta. Hetimi duhet të jetë në gjendje të përcaktojë shkakun e dëmtimit dhe, sipas rastit, identifikimin e personave përgjegjës, me qëllim ndëshkimin e tyre (*shih Mustafa Tunç dhe Fecire Tunç k. Turqisë* [GC], nr. 24014/05, §172, 14 prill 2015). Kurdoherë që ekzistojnë dyshime në lidhje me shfaqjen e dhunës në familje ose dhunës ndaj grave, kërkohet kujdes i veçantë nga autoritetet për t'u marrë me natyrën specifike të dhunës gjatë procedimeve të brendshme (shih *Volodina k. Ruisë*, nr. 41261/17, §92, 9 korrik 2019).



154. Kërkesa për shpejtësi të arsyeshme është e nënkuptuar në kontekstin e një hetimi efektiv në kuptim të nenit 2 të Konventës (shih, midis shumë të tjerëve, *Talpis k. Italisë*, nr. 41237/14, §106, 2 mars 2017). Duhet pranuar që mund të ketë pengesa ose vështirësi të cilat pengojnë progresin në një hetim në një situatë të veçantë. Sidoqoftë, një përgjigje e shpejtë nga autoritetet në hetimin e përdorimit të forcës vdekjeprurëse mund të konsiderohet përgjithësisht si thelbësore për të ruajtur besimin e publikut në respektimin e shtetit të së drejtës dhe në parandalimin e çdo shfaqjeje të tolerancës ndaj akteve të paligjshme (*Armani Da Silva k. Mbretëria e Bashkuar* [GC], nr. 5878/08, §237, 30 mars 2016). Gjithashtu, hetimi duhet të jetë i aksesueshëm për familjen e viktimës në masën e nevojshme për të mbrojtur interesat e veta legjitime (*Giuliani dhe Gaggio* [GC], cituar më lart, §3303).

155. Gjykata do të shqyrtojë tashmë nëse hetimi i kryer nga autoritetet shtetërore ka plotësuar kërkesat e pjesës procedurale të nenit 2 të Konventës. Kjo do të bëhet duke marrë parasysh situatën e përgjithshme të grave në Shqipëri në të cilën ndodhi sulmi me acid dhe përgjegjësinë e autoriteteve për hetimin e incidentit.

156. Gjykata vëren se raportet ndërkombëtare në lidhje me Shqipërinë kanë theksuar në mënyrë të përsëritur një prevalencë të lartë të dhunës ndaj grave të paktën që prej vitit 2003 (shih paragrafët 108–124 më lart). Për më tepër, raportet kombëtare mbështesin pikëpamjen se midis viteve 2007–2013 dhuna ndaj grave ishte një problem i përhapur (shih paragrafët 100–107). Midis viteve 2006 dhe 2012 raportet ndërkombëtare vinin në dukje mosraportimin, moshetimin, mosndjekjen penale dhe mosdënimin e dhunës ndaj grave. Ato sugjeronin se policia dhe autoritetet e ndjekjes penale manifestonin një qasje joefektive kundër dhunës ndaj grave me argumentin e “qëndrimit social dhe vlerave kulturore” dhe se mbizotëronte një klimë butësie ose pandëshkueshmërie ndaj autorëve të dhunës ndaj grave (shih paragrafët 113, 117 dhe 120–122 më lart). Në vëzhgimet përfundimtare të vitit 2010, Komiteti CEDAW rekomandoi, ndër të tjera, që: “zyrtarët publikë, në veçanti zyrtarët e zbatimit të ligjit dhe anëtarët e gjyqësorit të ndërgjegjësohen plotësisht për të gjitha format e dhunës ndaj grave”. Për sa më lart, Gjykata vlerëson se, në kohën e sulmit, ekzistonte

prima facie një klimë e përgjithshme në Shqipëri që ishte e favorshme për dhunën ndaj grave. Për më tepër, raporti i vlerësimit 2017 të GREVIO-s vuri në dukje se dhuna në familje tejkalonte: “të gjitha krimet e tjera si vepra penale me numrin më të lartë të viktimave” (shih paragrafin 109 më lart).

157. Kur një sulm ndodh në një klimë të përgjithshme, siç përshkruhet më lart, hetimi merr një rëndësi edhe më të madhe dhe autoritetet hetimore duhet të jenë më të kujdesshme në kryerjen e një hetimi të plotë, në mënyrë që të sigurojnë zbatimin efektiv të ligjeve të brendshme që mbrojnë të drejtën e jetës. Një kujdes i tillë për të hetuar, ndër të tjera, një sulm me acid – i cili, sipas Komitetit CEDAW dhe raporteve të tjera referuar në paragrafët 93–99 më lart, mund të jetë praktikë e “dhunës me bazë gjinore” ndaj grave – është përsëritur në rekomandimin e përgjithshëm nr. 19, sipas të cilit “Shtetet mund të jenë, gjithashtu, përgjegjës për aktet private nëse nuk veprojnë me kujdesin e duhur për të parandaluar shkeljet e të drejtave ose për të hetuar dhe ndëshkuar akte dhune dhe për sigurimin e kompensimit”, dhe është ripërcaktuar fort në Rekomandimin e Përgjithshëm nr. 35 (shih paragrafët 82 dhe 86 si dhe paragrafin 89 më lart).

158. Duke iu kthyer efektivitetit të hetimit të çështjes në fjalë, Gjykata vëren se është hapur një hetim për sulmin me acid nga prokurori dhe janë kryer disa veprime hetimore në lidhje me E.A., për të cilin u caktua një urdhër shtrëngimi. Në banesën e tij i ushtrua kontroll dhe disa sende në pronësi të tij u seksuestruan. U ndërmorën hapa të tjerë hetimore që përfshinin masat në vijim: u krye një ekzaminim në vendngjarje, u pyetën disa persona, u morën dhe u ekzaminuan pamjet filmike nga videokamera të dy bankave aty pranë, u morën raportet mjekoligjore, dhe u urdhëruan raporte të tjera ekspertimi. Megjithatë, në asnjë moment autoritetet nuk ishin në gjendje të përcaktonin natyrën e substancës së gjetur në enë dhe në rrobat e ankuses. Nuk u mor asnjë raport ekspertimi teknik ose toksikologjik, pasi FNS dhe ISP ose nuk kishin pajisjet e nevojshme të specializuara ose nuk ishte në kompetencën e tyre hartimi i raporteve të tilla (shih paragrafët 30–31 më lart).

159. Në këtë drejtim, është e vështirë për Gjykatën të pranojë që një masë hetimore me rëndësi thelbësore për çështjen, përkatësisht një raport ekspertimi për të mundësuar identifikimin e



substancës së përdorur për të sulmuar ankuesen, nuk është kryer me shpejtësinë dhe vendosmërinë e duhur. U takon autoriteteve vendore të zgjidhin çështjet e kompetencës ose të ngrenë institucione të specializuara për kryerjen e hapave të tillë proceduralë që janë vendimtarë për mbarëvajtjen e hetimit dhe përmbushjen e detyrimeve procedurale, sipas nenit 2 të Konventës.

160. Gjykata vlerëson se rrethanat e sulmit ndaj ankuses – i cili ka shenjat dalluese të një forme të dhunës me bazë gjinore – duhet të kishte nxitur autoritetet të reagonin me kujdes të veçantë në kryerjen e masave hetimore. Kurdo që ekziston dyshimi se një sulm mund të jetë i motivuar nga gjinia, është veçanërisht e rëndësishme që hetimi të kryhet me vrull.

161. Gjykata përfundimisht vëren se vendimi i formës së prerë në çështjen – vendim i datës 2 shkurt 2010, për pezullimin e hetimit, i cili nuk ishte i përshtatshëm për apelim (shih paragrafin 140 më lart) – nuk ofron ndonjë përgjigje të saktë për natyrën e substancës së gjetur në enë dhe në rrobat e ankuses. Për më tepër, me gjithë pyetjet e përsëritura të ankuses në lidhje me ecurinë e hetimit, asaj nuk iu dha asnjë informacion ose dokument në përgjigje. Për rrjedhojë, ajo nuk mund të kundërshtonte (mosveprimin e) hapave hetimore ose t'u kërkonte autoriteteve të merrnin masa të tjera (shih *Piboni*, cituar më lart, §95). Po kështu, ajo nuk mund të paraqiste kërkesë për dëmshpërblim në mungesë të një autori të identifikuar (shih paragrafin 138 më lart).

162. Rrjedhimisht, hetimi i krimit në fjalë, i cili është pezulluar që prej vitit 2010 nga prokurori, nuk mund të përshkruhet si një përgjigje efektive nga autoritetet ndaj sulmit me acid. Ka pasur pra shkelje të nenit 2 të Konventës, në lidhje me detyrimin procedural të Shtetit.

II. SHKELJA E PRETENDUAR E NENIT 8 TË KONVENTËS

163. Ankuesja u ankua për mospagimin nga ana e autoriteteve të një trajtimi psikoterapie ose rehabilitimi, dhe për mungesën e kompensimit financiar. Ajo u bazua në nenin 8 të Konventës, i cili, për sa është i rëndësishëm, citon si më poshtë:

Neni 8

“1. Çdokush ka të drejtën e respektimit të jetës së tij private ...”

164. Qeveria nuk paraqiti ndonjë vëzhgim të veçantë.

165. Gjykata vlerëson, në bazë të materialit të parashtruar, se nuk paraqitet asnjë shkelje në këtë drejtim, dhe për këtë arsye e rrëzon këtë ankim si haptazi të pabazuar në përputhje me nenin 35§§3 (a) dhe 4 të Konventës.

III. SHKELJA E PRETENDUAR E NENIT 13 TË KONVENTËS

166. Ankuesi u ankua për shkelje të nenit 13 të Konventës në lidhje me nenin 2 të Konventës në funksion të faktit se nuk mund të kundërshtonte veprimet e prokurorit dhe se nuk mund të kërkonte kompensim për sulmin aktual.

167. Neni 13 i Konventës parashikon si më poshtë:

“Çdokush, të cilit i janë shkelur të drejtat dhe liritë e përcaktuara në këtë Konventë, ka të drejtën e një zgjidhjeje efektive para një organi kombëtar, pavarësisht se shkelja është kryer nga persona që veprojnë në përmbushje të funksioneve të tyre zyrtare”.

168. Sa i përket pamundësisë së ankuses për të kundërshtuar veprimet e prokurorit, Gjykata vlerëson se ky ankim lidhet me atë të shqyrtuar në nenin 2 më lart dhe për këtë arsye duhet të deklarohet, gjithashtu, i pranueshëm. Sidoqoftë, duke pasur parasysh gjetjet e Gjykatës, sipas nenit 2 të Konventës më lart (shih paragrafët 161 dhe 140), nuk është e nevojshme të shqyrtohet themeli i këtij ankimi.

169. Për sa i përket mundësisë së ankuses për të marrë kompensim nga autori i veprës, Gjykata, gjithashtu, vlerëson se ky ankim është i lidhur me atë të shqyrtuar, sipas nenit 2 më lart dhe për këtë arsye duhet të deklarohet, gjithashtu, i pranueshëm. Sidoqoftë, duke pasur parasysh gjetjet e Gjykatës, sipas nenit 2 të Konventës më lart (shih paragrafët 161 dhe 138), nuk është e nevojshme të shqyrtohet themeli i këtij ankimi.

170. Sa i përket mundësisë së ankuses për të marrë kompensim nga Shteti, Gjykata vëren se procedimet, në lidhje me kërkesën e ankuses për dëmshpërblim u pushuan nga Gjykata e Rrethit Tiranë më 30 maj 2013, për shkak se ankuesja dhe avokati i saj nuk kishin arritur të paraqiteshin (shih paragrafin 53 më lart). Gjykata vëren se ankuesja nuk dha asnjë shpjegim ose ndonjë provë se arsyeja e mospaqitjes në seancat gjyqësore kishte të bënte me pamundësinë e saj për të paguar taksat



gjyqësore. Po kështu, ajo nuk parashtroi që Gjykata e Rrethit kishte refuzuar kërkesën e saj për përjashtim nga kërkesa për të paguar tarifat gjyqësore para se të vendoste pushimin e procedimeve. Në çdo rast, kërkesa e ankueses për dëmshpërblim nuk ishte përcaktuar në terma sasiorë, ku në këtë rast tarifat gjyqësore do të përcaktoheshin si përqindje e kërkesës. Prandaj, në mungesë të ndonjë provueshmërie, kjo pjesë e ankimit duhet të rrëzohet si haptazi e pabazuar në përputhje me nenin 35§§3 (a) dhe 4 të Konventës.

IV. SHKELJA E PRETENDUAR E NENIT 14 TË KONVENTËS

171. Së fundmi, ankuesja u ankua në bazë të nenit 14 të Konventës se autoritetet kishin mbajtur qëndrim pasiv edhe pse ajo kishte shprehur dyshime në lidhje me ish-burrin e saj. Veprimet e autoriteteve kishin treguar se ishin diskriminues ndaj saj për shkak të gjinisë së saj.

172. Duke pasur parasysh faktin që Gjykata tashmë ka shqyrtuar rrethanat e kësaj çështjeje, sipas nenit 2 të Konventës më lart (shih, në veçanti, paragrafët 156 dhe 157), nuk e gjen të nevojshme të shqyrtojë pranueshmërinë ose themelin e këtij ankimi.

V. ZBATIMI I NENIT 41 TË KONVENTËS

173. Neni 41 i Konventës parashikon se:

“Nëse Gjykata konstaton, se ka pasur shkelje të Konventës dhe të Protokolleve të saj, dhe nëse e drejta e brendshme e Palës së Lartë Kontraktuese lejon të bëhet vetëm një ndreqje e pjesshme, Gjykata, kur është e nevojshme, i akordon shpërblim të drejtë palës së dëmtuar.”

A. Dëmi

174. Ankuesja pretendoi 3,730.20 euro, në lidhje me dëmin pasuror – që përbëhet nga shpenzimet që ankuesja ka bërë për trajtimin e saj në Itali – dhe 4,938,469 lekë (afërsisht 36,452 euro), në lidhje me humbjen e fitimeve, shumë kjo që përfaqëson pagën e saj për një periudhë prej një viti. Ankuesja, gjithashtu, pretendoi shumë prej 9,890,004 lekësh (afërsisht 73,000 euro), në lidhje me dëmin jopasuror që përbëhet nga: 4,945,002, në lidhje me integritetin fizik dhe psikologjik të saj; 2,472,501 lekë, në lidhje me dhimbjet dhe vuajtjet që kishte duruar; dhe 2,472,501 lekë, në lidhje me cilësinë e jetës së saj. Ankuesja paraqiti një raport ekspertimi, sipas të cilit llogaritja është bazuar në vendimin unifikues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së

Lartë të datës 14 shtator 2007 (shih paragrafin 88 më lart).

175. Qeveria argumentoi që ankuesja nuk kishte paraqitur një kërkesë civile për dëmshpërblim. Raportekspertimi ishte bazuar në ligjin shqiptar të sigurimeve. Për rrjedhojë, Qeveria i kërkoi Gjykatës të rrëzonte pretendimet e saj si të pabazuara.

176. Gjykata vëren se rregulli që duhet të shterohen mjetet juridike të brendshme, nuk zbatohet për pretendimet për shpërblim të drejtë parashtruar Gjykatës, sipas nenit 41 të Konventës (shih *De Wilde, Ooms and Versyp k. Belgjikës* (neni 50), 10 mars 1972, §§15–16, seria A nr. 14, dhe *Salab k. Hollandës*, nr. 8196/02, §§67, ECHR 2006-IX (ekstrakte)).

177. Gjykata nuk dallon ndonjë lidhje shkakësore midis shkeljes së konstatuar dhe dëmit pasuror të pretenduar; Ajo, rrjedhimisht, e rrëzon këtë pretendim. Nga ana tjetër, Gjykata i akordon ankueses, mbi baza të barabarta, 12,000 euro, në lidhje me dëmin jopasuror, si rezultat i shkeljes së konstatuar, për shkak të paefektshmërisë së hetimit.

B. Kosto dhe shpenzime

178. Ankuesja pretendoi, gjithashtu, 1,500 euro për përfaqësimin e saj para Gjykatës, si dhe 1,220 euro dhe 70,150 lekë (518 euro), për lidhje me shpenzimet e përkthimit, ato administrative si dhe kostot dhe shpenzimet para gjykatave të brendshme dhe Gjykatës.

179. Qeveria nuk paraqiti ndonjë koment të veçantë.

180. Sipas praktikës ligjore të Gjykatës, një ankues ka të drejtën e rimbursimit të kostove dhe shpenzimeve vetëm për atë që është treguar se ato janë bërë realisht dhe domosdoshmërisht dhe janë të arsyeshme për sa i përket sasisë (shih *Gjyli k. Shqipërisë*, nr. 32907/07, §72, 29 shtator 2009). Në çështjen në fjalë, duke pasur parasysh dokumentet në zotërim dhe kriteret e mësipërme, Gjykata çmon të arsyeshme të akordojë shumë prej 2,720 eurosh që mbulon të gjitha kostot sipas çdo kreu.

C. Interesi i munguar

181. Gjykata e çmon të arsyeshme që norma e interesit të munguar duhet të bazohet në normën marxhinale të huas së Bankës Qendrore Evropiane, mbi të cilën duhet të shtohen 3 për qind.



PËR KËTO ARSYE, GJYKATA,
NË MËNYRË UNANIME:

1. Deklaron ankimin sipas nenit 2 të Konventës dhe ankimet sipas nenit 13 të Konventës në lidhje me mungesën e një mjeti juridik për të kundërshtuar veprimet e prokurorit dhe për të kërkuar kompensim nga autori i veprës, të pranueshme, si dhe ankimin, sipas nenit 8 të Konventës dhe ankimin sipas nenit 13 të Konventës, në lidhje me mungesën e një mjeti juridik për të marrë kompensim nga Shteti të papranueshme.

2. Vendos se nuk është shkelur neni 2 i Konventës nga pikëpamja materiale e saj.

3. Vendos se është shkelur neni 2 i Konventës nga pikëpamja procedurale e saj.

4. Vendos se nuk është e nevojshme të shqyrtohet themeli i ankimeve, sipas nenit 13 të Konventës.

5. Vendos se nuk është e nevojshme të shqyrtohet pranueshmëria ose themeli i ankimit, sipas nenit 14 të Konventës.

6. Vendos:

a) se Shteti i paditur duhet t'i paguajë ankueses, brenda tre muajve nga data në të cilën vendimi ka marrë formë të prerë, në përputhje me nenin 44§2 të Konventës, shumat e mëposhtme, të cilat duhet të konvertohen në monedhën e Shtetit të paditur, në normën e zbatueshme në datën e shlyerjes;

i. 12,000 euro (dymbëdhjetë mijë euro), plus çdo taksë që mund të vendoset, në lidhje me dëmin jopasuror;

ii. 2,720 euro (dy mijë e shtatëqind e njëzet euro), plus çdo taksë që mund t'i ngarkohet ankueses, në lidhje me kostot dhe shpenzimet;

b) se nga përfundimi i periudhës prej tre muajsh të përmendur më lart deri në shlyerje, interesi i thjeshtë do të jetë i pagueshëm mbi shumat e mësipërme me një normë të barabartë me normën marxhinale të huas së Bankës Qendrore Evropiane, gjatë periudhës së mospagimit të detyrimeve financiare, plus tre për qind;

7. Rrëzon, në mënyrë unanime, pjesën tjetër të pretendimit të ankueses për shpërblim të drejtë.

Hartuar në gjuhën angleze dhe njoftuar me shkrim më 4 gusht 2020, sipas nenit 77§§2 dhe 3 të Rregullores së Gjykatës.

Stanley Naismith
SEKRETAR

Robert Spano
KRYETAR

VENDIM
Nr. 260, datë 17.11.2020

**MBI FUNKSIONIMIN E KOMISIONIT
DISIPLINOR NË ZHVILLIMIN E
PROCEDURAVE DISIPLINORE NDAJ
PROKURORËVE**

Bazuar në nenin 149, pika 1, nenin 149/a, pika 1, germa “b”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenet 159 dhe 189, të ligjit nr. 115/2016, “Për Organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar, si dhe në Kodin e Procedurave Administrative, Këshilli i Lartë i Prokurorisë

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullores “Mbi funksionimin e komisionit disiplinor në zhvillimin e procedurave disiplinore ndaj prokurorëve”.

2. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e botimit në Fletoren Zyrtare dhe publikohet në faqen e Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

KRYETAR
Gent Ibrahimim

RREGULLORE
**MBI FUNKSIONIMIN E KOMISIONIT
DISIPLINOR NË ZHVILLIMIN E
PROCEDURAVE DISIPLINORE NDAJ
PROKURORËVE**

Kjo rregullore bazohet në nenin 149 pika 1, nenin 149/a, pika 1, germa “b”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenet 100–157, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, në nenet 159–162, të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar, si dhe në Kodin e Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë.



KREU I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1 Qëllimi

1. Qëllimi i kësaj rregulloreje është të përcaktojë rregulla më të detajuara, si dhe mënyrën e organizimit dhe funksionimit të Komisionit Disiplinor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë, në funksion të zhvillimit të procedurave disiplinore, të filluara nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë, ndaj magjistratëve prokurorë në Republikën e Shqipërisë.

2. Kjo veprimtari administrative dhe procedurale bazohet në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, në ligjin nr. 115/2016, “Për Organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar, Kodin e Procedurës Administrative, si dhe në legjislationin e zbatueshëm në Republikën e Shqipërisë, që përmban rregullime specifike që kanë lidhje me këtë veprimtari.

Neni 2 Objekti

Kjo rregullore përcakton;

a) përgjegjësitë dhe kompetencat e Komisionit Disiplinor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë, kryetarit, relatorit dhe anëtarëve, si dhe detyrat e këshilltarit ligjor përgjegjës të Njësisë Mbështetëse të Komisioneve dhe të personelit administrativ të Këshillit;

b) marrëdhëniet e Komisionit Disiplinor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë, me këshilltarin ligjor përgjegjës të Njësisë Mbështetëse të Komisioneve, personelin administrativ të Këshillit, ankuesin, prokurorin dhe Inspektorin e Lartë i Drejtësisë;

c) rregulla për ushtrimin e veprimtarisë administrative dhe procedurale të Komisionit Disiplinor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë në paraqitjen, shqyrtimin dhe administrimin e dokumentacionit që lidhet me procedurat disiplinore;

ç) rregulla për krijimin, trajtimin, qarkullimin, përdorimin, ruajtjen dhe arkivimin e dokumentacionit, që bëhet pjesë e dosjes së procedurës

disiplinore, si dhe sigurimin e aksesit të subjekteve pjesëmarrëse në këtë dokumentacion.

Neni 3 Përkufizime

Në rregullore termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

a) “Ankim” është mjeti procedural i parashikuar në ligji, për kundërshtimin e veprimeve apo të mosveprimeve të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

b) “Ditë” janë ditët kalendarike, me përjashtim të afateve nën 10 ditë, të cilat llogariten me ditë pune.

c) “Fillimi i hetimit disiplinor” është fillimi i procedurës hetimore nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë, me vendimin për fillimin e hetimit, sipas neneve 123 dhe 124, të ligjit “Për statusin”.

ç) “Magjistrat” është subjekti procedural me detyrë prokuror ose i komanduar në një detyrë tjetër, sipas nenit 53, pika 1, e ligjit, “Për statusin”, ndaj të cilit po zhvillohet një procedurë disiplinore nga Inspektori i Lartë të Drejtësisë, kryesisht apo mbi bazën e një ankese.

d) “ILD” është Inspektori i Lartë i Drejtësisë, si autoriteti përgjegjës për pranimin dhe verifikimin e ankesave, hetimin e shkeljeve disiplinore, si dhe për fillimin e procedurës disiplinore ndaj prokurorëve.

dh) “Këshilli” është Këshilli i Lartë i Prokurorisë.

e) “Komisioni” është Komisioni Disiplinor.

ë) “Këshilltari ligjor përgjegjës” është anëtari i personelit të Këshillit, i emëruar në strukturën e Njësisë Mbështetëse të Komisioneve, i cili caktohet nga kryetari i Komisionit, për të mbështetur një nga anëtarët Komisionit gjatë ushtrimit të detyrave të tyre sipas kësaj rregulloreje.

f) “Ligji për qeverisjen” është ligji nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

g) “Ligji për statusin” është ligji nr. 96/2016, “Për statusin e prokurorëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

gj) “Marrëveshje e pranimit” është marrëveshja e përbashkët, me shkrim, nëpërmjet së cilës magjistrati dhe ILD, dakordësojnë pranimin e shkeljes disiplinore që i atribuohet magjistratit, llojin e shkelës dhe masën disiplinore, sipas përcaktimit të nenit 135, të ligjit “Për statusin”.



h) “Përfaqësues” është subjekti procedural përfaqësues i magjistratit apo subjekte të tjera procedurale, i cili legjitimohet si i tillë sipas parashikimeve të neneve 35–38 të Kodit të Procedurës Administrative.

i) “Raporti i hetimit” është akti me të cilin ILD-ja i jep fund hetimit disiplinor, me anë të mbylljes së hetimit ose fillimin e procedimit disiplinor me propozimin për caktimin e masës përkatëse, i hartuar sipas nenit 133 pika 3 e ligjit, “Për statusin”.

j) “Relator” është çdo anëtar i Komisionit Disiplinor, i caktuar me short për një çështje, në zbatim të nenit 161, të ligjit “Për qeverisjen”, i cili kryen dhe kujdeset për zhvillimin e procedurës administrative dhe disiplinore në Komision dhe Këshillit.

Neni 4

Fusha e veprimtarisë së Komisionit

1. Komisioni Disiplinor ka si objekt të veprimtarisë së tij trajtimin e çdo çështje, që ka lidhje me procedurat me natyrë disiplinore, përveç vendimmarrjes si e drejtë ekskluzive e Këshillit, të parashikuara në ligjin, “Për statusin”, si vijon:

a) ankimin ndaj mosveprimit administrativ të ILD-së, në rastin kur nuk zbaton afatet e parashikuara nga pikat 1 deri në 4, të nenit 118 të ligjit;

b) ankimin ndaj vendimit të ILD-së, për dënimin me gjobë, sipas nenit 116 pika 4 dhe nenit 132, pika 4 e ligjit;

c) shqyrtimin e marrëveshjes së përbashkët të pranimit të shkeljes disiplinore, sipas nenit 135 të ligjit, si dhe të ankimit ndaj mosveprimit administrativ të ILD-së, sipas pikës 9 të këtij neni;

ç) shqyrtimin e procedimeve disiplinore, të filluara nga ILD-ja, sipas neneve 138–147 të ligjit dhe, kur është rasti, marrjen e masave disiplinore të parashikuara në ligj;

ç) marrjen e të gjitha masave të nevojshme dhe sigurimin e zbatimit dhe mbikëqyrjen e masave disiplinore, që vendosen në përfundim të një procedimi disiplinor, sipas neneve 148–150 të ligjit;

d) pezullimin e detyruar të magjistratit nga detyra, në bazë të nenit 151 të ligjit;

dh) pezullimin e magjistratit, ndaj të cilit është paraqitur një kërkesë për fillimin e procedimit disiplinor, sipas nenit 127, kryesisht apo mbi kërkesën e ILD-së.

2. Komisioni është kompetent edhe për çdo çështje tjetër të parashikuar me ligj, në përputhje me fushën e veprimtarisë së këtij komisioni.

3. Në shqyrtimin e çështjeve të përcaktuara në pikat 1 dhe 2 të këtij neni, Këshilli dhe Komisioni mbështeten nga anëtarët e personelit administrativ të Këshillit.

Neni 5

Parimet e përgjithshme

Parimet kryesore, mbi bazën e të cilave zhvillon veprimtarinë Komisioni dhe Këshilli janë ligjshmëria, transparenta, mosdiskriminimi, konfidencialiteti dhe mbrojtja e të dhënave, profesionalizmi, përgjegjësia, pavarësia, integriteti, paanësia dhe eficientia.

Neni 6

Parimet e procedimit disiplinor

1. Komisioni dhe Këshilli, në ushtrimin e funksioneve të parashikuara në këtë rregullore dhe në ligj, udhëhiqen dhe synojnë zbatimin e përshtatshëm dhe në mënyrë të balancuar të parimeve të mëposhtme:

a) e drejta për një proces të rregullt, duke përfshirë dhe marrjen e një vendimi brenda një afati të arsyeshëm;

b) parimin e ligjshmërisë, në kuptimin që organi kompetent ka detyrimin të vlerësojë nëse ka shkaqe të mjaftueshme për të besuar se ka ndodhur një shkelje disiplinore, si dhe parimin e “mosdënimit pa ligj”;

c) parimin e akuzës, në kuptimin që çdo institucion shtetëror ose zyrtar duhet të veprojë kryesisht dhe të paraqesë një ankesë nëse ka prova të mjaftueshme për të besuar që ka ndodhur një shkelje disiplinore;

ç) parimin e barazisë para ligjit;

d) prezumimin e pafajësisë;

dh) parimin e dyshimit në favor të subjektit të procedimit disiplinor;

e) parimin e proporcionalitetit;

ë) parimin e pavarësisë dhe paanësisë së institucioneve disiplinore dhe respektimi për pavarësinë të subjektit të proceduar;

f) parimin e drejtësisë së hapur;

g) parimin e konfidencialitetit dhe të drejtën e jetës private dhe mbrojtjen e të dhënave personale.



2. Në balancimin e parimit të drejtësisë së hapur, parimit të konfidencialitetit, së drejtës për jetë private dhe mbrojtjen e të dhënave personale, Këshilli dhe Komisioni duhet të marrin parasysh, veçanërisht:

a) faktin që të garantohet mbrojtja e integritetit dhe figura e subjektit të proceduar nga akuzat e pabaza;

b) rëndësinë që ka informimi i publikut, në lidhje me akuzat e provuara në funksion të administrimit të drejtësisë.

Neni 7

Konflikti i interesit

1. Anëtari i Këshillit, i pranishëm, përkatësisht, në mbledhjen e Këshillit ose të Komisionit, i cili është në dijeni të një konflikti interesi ose të një pengese ligjore, për veten ose për një anëtar tjetër, lidhur me një çështje të rendit të ditës, në përputhje me nenet 172, 173, 174, 175 të ligjit “Për qeverisjen”, është i detyruar për sa më poshtë:

a) të deklarojë natyrën e interesit ose pengesës;

b) të mos marrë pjesë në diskutimin e çështjes përkatëse;

c) të mos marrë pjesë në votimin e çështjes përkatëse.

2. Anëtari i Këshillit nuk merr pjesë në vendimmarrjen e mbledhjes plenare ose komisionit, në rastin kur:

a) anëtari ka paraqitur tek ILLD-ja kërkesën, mbi bazën e së cilës ka nisur procedimi disiplinor;

b) ka marrë vendim si anëtar i komisionit të përkohshëm, për shqyrtimin e ankimeve kundër vendimit të arkivimit ose pushimit e hetimit, ndaj një prokurori, sipas parashikimit të nenit 160, pika 13, të ligjit “Për qeverisjen”.

3. Çdo anëtar i Këshillit, menjëherë pas marrjes së rendit të ditës dhe materialeve për një mbledhje të ardhshme të Këshillit ose të Komisionit, dhe në çdo rast para votimit të çështjes përkatëse, deklaroi konfliktin e interesit ose pengesën ligjore, sipas neneve 172 dhe 173 të ligjit “Për qeverisjen”. Anëtari i Këshillit i cili ka deklaruar konfliktin e interesit ose pengesën nuk merr pjesë në diskutimin ose votimin e çështjes përkatëse në Komision dhe në Këshill.

4. Në rastet e konfliktit të interesit, sipas nenit 174 të ligjit “Për qeverisjen”, anëtari kërkon heqjen dorë nga diskutimi ose votimi. Vendimi për

pranimin e dorëheqjes së anëtarit, merret nga kryetari i Këshillit. Kur dorëheqjen e jep kryetari, vendimi për pranimin e saj merret nga zëvendëskryetari.

5. Nëse një anëtar ka dijeni se një anëtar tjetër i Këshillit ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit ose pengesës ligjore, sipas neneve 172, 173 apo 174 të ligjit “Për qeverisjen”, e deklaron atë menjëherë pas marrjes dijeni, dhe në çdo rast para votimit të çështjes përkatëse.

6. Anëtari për të cilin pretendohet konflikti i interesit ose pengesa ligjore deklaroi qëndrimin e tij në lidhje me këtë pretendim. Nëse anëtari vlerëson se pretendimi qëndron, sipas rastit, ai nuk merr pjesë në diskutimin apo votimin e çështjes përkatëse ose kërkon heqjen dorë. Kur kërkesa për heqje dorë bëhet në mbledhje plenare ose në mbledhje të Komisionit, diskutimi ose votimi i çështjes në fjalë mund të shtyhet për në mbledhjen e radhës.

7. Prokurori i proceduar ose përfaqësuesi ligjor i tij ose ILLD-ja mund të kërkojnë përjashtimin e anëtarit të Këshillit nga pjesëmarrja në shqyrtimin e procedurës administrative vetëm në fazën paraprake të procesit, kur ekziston një nga shkaqet e parashikuara në nenin 174 të ligjit “Për qeverisjen”, dhe anëtari nuk heq dorë vetë nga shqyrtimi i çështjes. Vendimi për përjashtimin e një anëtarit, nga shqyrtimi i një çështjeje në mbledhje plenare ose në Komision, merret nga Këshilli në mbledhje plenare, sipas rregullave të parashikuara në nenin 171 të ligjit “Për qeverisjen”. Kur kërkohet përjashtimi i kryetarit të Këshillit, mbledhja plenare kryesohet nga zëvendëskryetari i Këshillit.

KREU II

ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI

SEKSIONI I

ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I KOMISIONIT DISIPLINOR

Neni 8

Komisioni Disiplinor

1. Komisionit Disiplinor, i përcaktuar nga ligji si Komision i përhershëm, ushtron veprimtarinë e tij, sipas nenit 4 të kësaj rregulloreje.



2. Komisioni përbëhet nga tre anëtarë, dy nga radhët e prokurorëve dhe një jo prokuror, si dhe dy anëtarë zëvendësues, një nga radhët e anëtarëve prokuror dhe një nga radhët e anëtarëve joprokurorë. Anëtarët e përhershëm dhe anëtarët zëvendësues të Komisionit zgjidhen nga Këshilli. Anëtarët e përhershëm dhe anëtarët zëvendësues të Komisionit, shërbejnë për një mandat dy vite e gjysmë nga data e zgjedhjes së tyre.

3. Kryetari i Komisionit zgjidhet në mbledhjen e parë të Komisionit, me propozim të kryetarit të Këshillit. Kryetari i Këshillit është kryetar i Komisionit, në rastin kur është një nga anëtarët e tij.

Neni 9

Kuorumi dhe mbledhja e Komisionit

1. Mbledhja e Komisionit është e vlefshme vetëm kur në të marrin pjesë të gjithë anëtarët e tij. Komisioni mbledhet, në ditën, orën dhe vendin e caktuar nga kryetari. Komisioni mbledhet edhe me propozim të një anëtar.

2. Kryetari i Komisionit cakton rendin e ditës për mbledhjen, pas konsultimit me anëtarët. Para mbledhjes, çdo anëtar i komisionit mund të kërkojë shtimin e çështjeve të tjera në rendin e ditës. Ato përfshihen nëse votojnë, pro kërkesës, jo më pak se dy anëtarë.

3. Mbledhjet e Komisionit drejtohen nga kryetari i Komisionit.

4. Komisioni ka të drejtë të kërkojë çdo dokumentacion, i cili konsiderohet i nevojshëm dhe ndihmës për veprimtarinë e tij sipas ligjit

5. Çdo anëtar i Komisionit ka të drejtë të dëgjohet për mendimin e tij, në lidhje me çështjen që diskutohet. Vendimet në komision merren me shumicë votash të të gjithë anëtarëve.

6. Rregullat e zhvillimit të mbledhjes së Komisionit janë të njëjta me ato të zhvillimit të mbledhjes plenare të Këshillit, për aq sa ato janë të zbatueshme. Rregullat për pjesëmarrjen dhe vendimmarrjen në distancë në Këshill, zbatohen për aq sa është e mundur edhe për Komisionin.

Neni 10

Detyrat dhe përgjegjësitë e kryetarit dhe anëtarëve të Komisionit

1. Kryetari i Komisionit është përgjegjës, për:

a) funksionimin e duhur të Komisionit;

b) mbikëqyrjen e punës dhe administrimin e Komisionit;

c) kujdeset për hedhjen e shortit, për caktimin e relatorit;

ç) përgatitjen për mbledhjen;

d) shpërndarjen e të gjitha materialeve të mbledhjes, në kohën e duhur, për anëtarët e Komisionit;

dh) caktimin e orës, datës dhe vendit të mbledhjes;

e) caktimin rendit të ditës dhe kryesimin e mbledhjeve të Komisionit;

ë) ndarjen e barabartë dhe të drejtë të detyrave, duke marrë në konsideratë angazhimin profesional të anëtarëve të Komisionit;

f) caktimin e këshilltarit ligjor përgjegjës, për të asistuar anëtarin në përmbushjen e detyrave të tij;

g) raportimin në Këshill për punën e realizuar nga Komisioni.

2. Detyrat dhe përgjegjësitë e anëtarëve të Komisionit janë:

a) të marrin pjesë, të respektojnë dhe zbatojnë procedurat për mbledhjet e Komisionit;

b) të realizojnë brenda afateve kohore detyrat e caktuara nga Komisioni dhe Këshilli;

c) të informojnë sa më herët të jetë e mundur kryetarin, kur nuk mund të marrin pjesë në mbledhjen e Komisionit;

ç) të mos nxjerrin asnjë informacion sensitiv nga mbledhjet me dyer të mbyllura të Komisionit;

d) të shmangin favorizimin, anshmërinë ose diskriminimin mbi çfarëdo baze, kur shqyrtojnë çështje, marrin vendime ose votojnë për çështje që i paraqiten Komisionit;

dh) të përdorin ekskluzivisht adresën e postës zyrtare të Këshillit për të gjitha komunikimet e brendshme dhe të jashtme që lidhen me punën dhe aktivitetet e Komisionit dhe të Këshillit.

Neni 11

Zëvendësimi i anëtarit të Komisionit

1. Në rastin kur një nga anëtarët e Komisionit heq dorë nga pjesëmarrja në mbledhjen e Komisionit ose përjashtohet për shkak të konfliktit të interesit, pengese tjetër ligjore, si dhe kur ai mungon në detyrë, arsye të tjera pamundësie të përkohshme, në shqyrtimin e çështjes, futet anëtar zëvendësues.



2. Anëtari zëvendësues shërben si anëtar aktiv i Komisionit, sa herë që një anëtar i përhershëm nuk është në gjendje të ushtrojë funksionin për arsye objektive ose pengese ligjore. Anëtarët joprokurorë mund të zëvendësojnë vetëm anëtarët joprokurorë dhe anëtarët prokurorë mund të zëvendësojnë vetëm anëtarët prokurorë të Komisionit.

3. Kohëzgjatja e zëvendësimit varet nga natyra e arsyes dhe rrethanave për të cilat është bërë zëvendësimi:

a) nëse anëtari i përhershëm që zëvendësohet, ka pengesë ligjore në trajtimin e një çështje konkrete, anëtari zëvendësues merr pjesë për kohën e nevojshme për përfundimin e çështjes.

b) nëse gjendja e padisponueshmërisë së anëtarit të përhershëm zgjat më shumë se 7 ditë, atëherë anëtari zëvendësues shërben deri në përfundim të kësaj çështje.

4. Nëse një anëtar zëvendësues i Komisionit zëvendëson kryetarin e Komisionit, kryetari i ri zgjidhet me short ndërmjet anëtarëve të përhershëm të komisionit. Kryetari i ri ushtron këtë funksion, për çështjen për të cilën ka filluar procedimi disiplinor, për sa kohë zgjat gjendja e zëvendësimit të anëtarit të përhershëm. Nëse një anëtar zëvendësues i Komisionit zëvendëson një anëtar të Komisionit, i cili shërbente si relator, zgjidhet një relator i ri me short. Në çdo rast, nëse anëtari zëvendësues shërben si relator, ai ushtron funksionin e anëtarit zëvendësues deri në përfundim të çështjes për të cilën ai është caktuar si relator.

SEKSIONI II

ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I STRUKTURAVE MBËSHTETËSE TË KOMISIONIT

Neni 12

Njësia Mbështetëse e Komisioneve

1. Komisioni asistohet në veprimtarinë e tij nga Njësia Mbështetëse e Komisioneve, e cila përbën strukturën ndihmëse dhe këshillimore, që mbështet punën profesionale të anëtarëve të Komisionit.

2. Njësia Mbështetëse e Komisioneve ushtron veprimtari këshilluese dhe ndihmëse në procesin vendimmarrës, duke përfshirë:

- a) përgatitjen e çështjes për shqyrtim;
- b) kryerjen e kërkimeve shkencore;

c) dhënien e opinioneve ligjore;

ç) ndjek ecurinë e ankimit të palëve ndaj vendimit të Këshillit për çështjen konkrete të trajtuar, duke informuar në vazhdimësi njësinë e shërbimeve të përgjithshme ligjore, përgjegjëse për përfaqësimin e KLP-së, në gjyq.

3. Kryetari i Komisionit cakton një këshilltar ligjor përgjegjës, nga Njësia Mbështetëse e Komisioneve, për secilin nga anëtarët e Komisionit, të caktuar si relator.

4. Këshilltari ligjor përgjegjës, gjatë shqyrtimit të një çështje në Komision, ka kryesisht detyrat e mëposhtme:

a) jep mendimin e tij relatorit të çështjes, pranë të cilit është caktuar, në lidhje me mënyrën se si do të procedohet me shqyrtimin e saj dhe veprimet procedurale që duhet të kryhen nga relatori dhe Komisioni, me qëllim përgatitjen sa më të shpejtë të çështjes për në Këshill;

b) përgatit projektaktet dhe relacionet, duke dhënë mendimin e tij si mbi pranueshmërinë dhe mbi zgjidhjen në themel të çështjes;

c) kryen çdo detyrë tjetër të caktuar nga relatori i çështjes ose Komisioni.

5. Këshilltar ligjor përgjegjës, në çdo kohë, kur merr dijëni për ekzistencën e një konflikti interesi ose pengese ligjore në lidhje me një çështje, është i detyruar të deklarojë natyrën e konfliktit të interesit ose pengesës dhe të heqë dorë nga pjesëmarrja në veprimtarinë e Komisionit gjatë shqyrtimit të kësaj çështjeje. Në këtë rast zbatohen dispozitat e rregullores së Këshillit, “Për parandalimin e konfliktit të interesave dhe deklarimin e pasurive në ushtrimin e funksioneve publike në Këshillin e Lartë të Prokurorisë”. Kërkesa për dorëheqje i drejtohet kryetarit të Komisionit, i cili kur vendos pranimin, cakton dhe këshilltarin ligjor përgjegjës zëvendësues nga Njësia Mbështetëse e Komisioneve.

Neni 13

Personeli administrativ i Këshillit

1. Komisioni me kërkesë të kryetarit të tij, në varësi të ngarkesës së punës, mbështetet në veprimtarinë e tij nga anëtarët e personelit administrativ të Këshillit, të cilët ushtrojnë veprimtari ndihmëse, duke përmbushur këto detyra, por pa u kufizuar në to:



a) regjistrimin e të dhënave në regjistrat e posaçëm në lidhje me çështjet e paraqitura për shqyrtim në Këshill dhe në veçanti:

i. identifikon natyrën e çështjes;

ii. regjistron dhe numëron atë në regjistrin përkatës;

iii. krijon dosjen e çështjes.

b) përcjelljen e çështjes kryetarit të Këshillit për të vijuar sa më shpejt të jetë e mundur, me procedurat për hedhjen e shortit;

c) dorëzimin e dosjes së çështjes te relatori dhe bashkëpunimin me këshilltarin ligjor përgjegjës, për mbarëvajtjen e të gjithë procedurës;

ç) mbajtjen e procesverbalit të mbledhjeve të Komisionit;

d) mbajtjen e të gjitha komunikimeve të vazhdueshme të njoftimeve dhe të akteve shkresore, me subjektet ankuese/kërkuese ose me përfaqësuesit e tyre, gjatë shqyrtimit të çështjes, mbi bazën e urdhërimeve të Komisionit ose të Këshillit;

dh) redaktimin e akteve të Komisionit në këndvështrimin gjuhësor;

e) numërtimin e vendimit pas përfundimit të plotë të shqyrtimit të çështjes dhe dhënies së vendimit;

ë) marrjen e masave për njoftimin e akteve sipas urdhërimeve të relatorit;

f) marrjen në dorëzim të dosjes nga relatori në përfundim të procedurës dhe depozitimin e saj për arkivim;

g) vënien në dispozicion të strukturave të Këshillit dhe Komisionit çdo lloj informacioni, dokumentacioni dhe statistike, për qëllime të procedurës, duke përfshirë edhe fazën e ekzekutimit të vendimeve përfundimtare, sipas përcaktimeve të nenit 148–150, të ligjit për statusin.

2. Me fillimin e procedimit disiplinor, sipas kësaj rregulloreje, Sekretari i Përgjithshëm me kërkesë të kryetarit të Komisionit, cakton personelin administrativ përgjegjës për kryerjen e detyrave të përcaktuara në pikën 1, të këtij neni. Në mungesë të kërkesës së kryetarit për caktimin e personelit administrativ ndihmës, të gjitha detyrat e përcaktuara në pikën 1, të këtij neni, përmbushen nga Njësia Mbështetëse e Komisionit.

3. Personeli administrativ i caktuar, sipas pikës 2 të këtij neni, në çdo kohë, kur merr dijeni për ekzistencën e një konflikti interesi ose pengese ligjore në lidhje me një çështje, është i detyruar të

deklarojë natyrën e konfliktit të interesit ose pengesës dhe të heqë dorë nga pjesëmarrja në veprimtarinë e Komisionit gjatë shqyrtimit të kësaj çështjeje. Në këtë rast zbatohen dispozitat e rregullores së Këshillit, “Për parandalimin e konfliktit të interesave dhe deklarimin e pasurive në ushtrimin e funksioneve publike në Këshillin e Lartë të Prokurorisë”. Kërkesa për dorëheqje i drejtohet Sekretarit të Përgjithshëm, i cili kur vendos pranimin, cakton dhe personelin administrativ zëvendësues nga anëtarët e personelit të Këshillit.

SEKSIONI III

VEPRIMTARIA ADMINISTRATIVE

Neni 14

Depozitimi për shqyrtim

1. Në Këshill depozitohen për shqyrtim administrativ aktet e parashikuara në ligj, të tilla si:

a) ankimi i magjistratit ndaj mosveprimit administrativ të ILD-së, në rastin kur brenda afatit 3-mujor nga marrja e ankesës, nuk ka vendosur arkivimin ose fillimin e hetimit, për shkeljen e pretenduar, sipas parashikimeve të nenit 118, pikat 1 deri në 4, të ligjit “Për statusin”;

b) ankimi ndaj vendimit të ILD-së për dënimin me gjobë sipas nenit 116, pika 4 dhe nenit 132, pika 4, të ligjit “Për statusin”;

c) marrëveshja e përbashkët e magjistratit dhe e ILD-së, për pranimin e shkeljes disiplinore, sipas nenit 135 të ligjit “Për statusin”;

ç) ankimi ndaj mosveprimit administrativ të ILD-së, për rifillimin ose vazhdimin e veprimeve hetimore disiplinore ndaj prokurorit brenda 1 muaji nga dita e refuzimit të marrëveshjes nga Këshilli, sipas përcaktimeve të nenit 135, pika 9 e ligjit “Për statusin”;

d) ankimi sipas nenit 121, pika 3, ndaj vendimit të ILD-së për arkivimin e ankesës që nuk përmbush kriteret e pikës 1 të nenit 120 të ligjit “Për statusin”, si dhe ankimin, sipas nenit 122 pika 5, të ligjit “Për statusin”, për rastet kur ILD-ja, arkivon ankesën për mungesë të fakteve që do të justifikonin fillimin e hetimit.

dh) ankimi sipas nenit 134, pika 2, të ligjit “Për statusin”, ndaj vendimit të ILD-së për mbylljen e hetimit sipas pikës 1 të këtij neni.



e) kërkesa e ILD-së, për procedim disiplinor, së bashku me raportin hetimor dhe dosjen përkatëse;

ë) kërkesa e ILD-së për pezullimin e magjistratit nga detyra, si dhe kërkesat e palëve për ndryshimin ose revokimin e pezullimit të vendosur.

f) referimi i ecurisë disiplinore nga institucioni në të cilin magjistrati është komanduar, sipas përcaktimeve të nenit 53, pika 12, të ligjit, “Për statusin”.

g) marrëveshja e pranimit e dakordësuar ndërmjet magjistratit dhe ILD-së, lidhur me shkëlqen disiplinore që i atribuohet magjistratit.

2. Data e administrimit në Këshill, e akteve të parashikuara në pikën 1, në regjistrin përkatës, është:

a) data e depozitimit në Këshill, në rastin kur akti paraqitet personalisht ose nëpërmjet një përfaqësuesi të zgjedhur, nga subjekti përkatës;

b) data e depozitimit në Këshill nga shërbimi postar, në rastin kur akti është dërguar nëpërmjet shërbimit postar;

c) data e mbërritjes në adresën elektronike zyrtare të Këshillit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për komunikimin dhe dokumentin elektronik.

Neni 15

Regjistri i posaçëm

1. Pranë Komisionit, krijohet dhe administrohet një regjister fizik dhe elektronik i posaçëm, në të cilin regjistrohen:

a) çështjet në lidhje me ankimet, e paraqitura në Këshill, nga subjektet e përcaktuara në ligj dhe sipas kësaj rregulloreje;

b) kërkesat për pezullimin e magjistratit nga ushtrimi i detyrës gjatë një procedure disiplinore, si dhe ato për ndryshimin apo revokimin e pezullimit;

c) çështjet në lidhje me procedimet disiplinore, si dhe vendimet e formës së prerë të marra në këto procedime, si dhe të gjithë ecurinë që i përket fazës së ekzekutimit të masave disiplinore.

2. Nëse është e nevojshme, Këshilli, për nevoja të punës, mund të miratojë edhe regjistra të tjerë, duke përcaktuar llojin e të dhënave që do të hidhen në secilin prej tyre.

Neni 16

Formimi i dosjes

Për çdo çështje, të regjistruar për shqyrtim sipas nenit 14 të kësaj Rregulloreje, formohet një dosje e veçantë, në të cilën administrohet dhe numërohet, i gjithë dokumentacioni, i krijuar dhe i mbledhur gjatë procedurës së shqyrtimit të kësaj çështje në Komision, si dhe në Këshill.

Neni 17

Procedura e shortit për zgjedhjen e relatorit

1. Procedura e shortit realizohet menjëherë, duke u bazuar në parimet e transparencës, objektivitetit dhe në shpërndarjen rastësore dhe të barabartë të ngarkesës së punës midis anëtarëve të Komisionit.

2. Përveç rasteve të konfliktit të interesit apo pamundësisë në ushtrimin e funksionit, bazuar në arsye që lidhen me ngarkesën dhe efektivitetin e punës, me kërkesën e motivuar të kryetarit ose të çdo anëtari të Komisionit, Këshilli, mund të vendosë:

a) përjashtimin e një anëtari të komisionit nga shorti;

b) përfshirjen në procedurat e shortit, për caktimin e relatorit, të anëtarëve zëvendësues. Në këtë rast anëtari zëvendësues që përfshihet në short, zgjidhet sipas përkatësisë, prokuror ose jo prokuror, të anëtarit që zëvendëson.

c) rregulla të tjera për mënyrën e hedhjes së shortit, në varësi të rrethanave dhe në funksion të rritjes së efektivitetit dhe transparencës.

3. Në çdo rast, në procedurën e shortit për caktimin e relatorit të çështjes, nuk mund të marrin pjesë më pak se tre anëtarë.

4. Shorti hidhet midis anëtarëve të Komisionit, duke u bazuar në forma elektronike për caktimin e relatorit. Deri në përcaktimin dhe vendosjen e këtyre, shorti hidhet manualisht, sipas procedurës së vendosur në Këshill.

Neni 18

Kalimi i çështjes te relatori

Pas përfundimit të procedurës së shortit, personeli administrativ kompetent ose Njësia e Mbështetjes së Komisioneve i dorëzon menjëherë relatorit, dosjen e regjistruar, e cila përmban të



gjithë dokumentacionin që lidhet me çështjen që do të shqyrtohet.

Neni 19

Radha e shqyrtimit

Radha e shqyrtimit të çështjeve përcaktohet duke pasur në konsideratë përparësitë e procedimeve disiplinore dhe kërkesave me natyrë urgjente, si edhe datën e depozitimit të çështjes në Këshill.

Neni 20

Veprimet paraprake të relatorit dhe të Komisionit në përgatitjen e çështjes

1. Relatori përgatit çështjen për shqyrtim në mbledhjen e Komisionit, si dhe në Këshill.

2. Relatori, me mbështetjen e këshilltarit përgjegjës dhe personelit administrativ të caktuar, kryen dhe kujdeset për detyrat si më poshtë, por pa u kufizuar në to:

a) përgatit relacionin paraprak mbi çështjen, që do të diskutohet nga Komisioni dhe Këshilli;

b) kryen të gjitha procedurat për të siguruar administrimin e dokumentacionit të nevojshëm dhe të informacionit shtesë për procesin e vendimmarrjes së Komisionit dhe Këshillit;

c) merr masat për të hartuar të gjitha aktet procedurale, deri në përfundimin e çështjes;

ç) koordinon me kryetarin e Këshillit ose Komisionit për përgatitjen, respektivisht, të mbledhjes së Këshillit ose Komisionit;

d) njofton subjektin e procedimit administrativ.

3. Nën kujdesin e relatorit të çështjes, këshilltari përgjegjës, pas studimit të çështjes përgatit një relacion paraprak dhe e shpërndan atë tek anëtarët e Komisionit. Nëse anëtarët e Komisionit kanë pyetje apo kërkesa për shpjegime në lidhje me të, ia dërgojnë ato relatorit dhe këshilltarit përgjegjës.

4. Pas mbylljes së veprimeve përgatitore, kryetari i Komisionit, me kërkesë të relatorit dhe në koordinim me anëtarin tjetër, cakton datën, orën dhe vendin e shqyrtimit të çështjes.

5. Komisioni, pas shqyrtimit të çështjes, vendos me shumicën e votave e të gjithë anëtarëve, në lidhje me relacionin paraprak, relacionin përfundimtar dhe projektvendimet që do të kalojnë për shqyrtim në Këshill.

6. Në rast se njëri nga anëtarët e komisionit, përfshirë edhe relatorin, ka mendim ndryshe, ai pasqyrohet në relacionin përfundimtar të komisionit.

Neni 21

Diskutimi dhe votimi në mbledhje plenare

1. Në diskutimin e çështjes relatori flet i pari. Anëtarët e Këshillit diskutojnë pas relatorit sa herë e çmojnë të nevojshme.

2. Pas përfundimit të diskutimeve lidhur me një çështje, kryetari fton anëtarët për të votuar mbi propozimin e ardhur nga Komisioni. Nëse gjatë diskutimeve, një anëtar i Këshillit, që mund të jetë edhe anëtar i mbetur në pakicë në komision, ka një propozim të ndryshëm nga ai i paraqitur nga Komisioni, fillimisht votohet mbi propozimin e Komisionit dhe me pas propozimi ndryshe.

3. Votimi është i hapur dhe publik. Kryetari shpall rezultatet e votimit, duke treguar sa vota janë dhënë pro ose kundër propozimit mbi të cilin u votua. Votimi bëhet në të njëjtën kohë nga të gjithë anëtarët. Votimi kryhet në formë elektronike. Kur votimi elektronik nuk është i mundur, anëtarët votojnë duke ngritur dorën. Pasi të japin të gjithë votën e tyre “pro” dhe “kundër”, kryetari i Këshillit jep rezultatin e votimit. Në rast votimi të barabartë, vota e kryetarit është përcaktuese.

4. Vendimi përgatitet në aq kopje sa duhen për njoftimin e subjekteve, si dhe një kopje tjetër për praktikën dokumentare të çështjes.

Neni 22

Mënyrat e njoftimit të akteve

1. Aktet e Këshillit gjatë procedurave, sipas kësaj rregulloreje, u njoftohen palëve në një ose disa nga format e mëposhtme:

a) personalisht ose përfaqësuesit ligjor kur janë të pranishëm në çastin e shpalljes së aktit;

b) me postë të porositur në adresën e vendit të punës të marrësit;

c) në adresën postare elektronike të depozituar zyrtarisht nga subjekti i aktit administrativ.

2. Vendimi i Këshillit bëhet publik në faqen zyrtare të Këshillit, i shoqëruar me arsyetimin përkatës, pasi të redaktohen për sigurimin e anonimitit të subjekteve, përveç kur në ligj parashikohet ndryshe.



Neni 23

Arkivimi i praktikës dokumentare

Praktika dokumentare arkivohet në Zyrën e Protokoll-Arkivit së Këshillit në përputhje me legjislacionin në fuqi mbi arkivat.

KREU III

PROCEDIMI DISIPLINOR

Neni 24

Paraqitja e kërkesës për fillimin e procedimit disiplinor

1. Kërkesa për fillimin e procedimit disiplinor depozitohet në Këshill nga ILD-ja ose nga përfaqësuesi i autorizuar prej tij. Bashkë me kërkesën depozitohet raporti i hetimit dhe dosja përkatëse sipas nenit 133 të ligjit “Për statusin”.

2. Brenda 3 ditëve nga regjistrimi, kërkesa për fillimin e procedimit disiplinor i nënshtrohet, procedurës së shortit për caktimin e relatorit të çështjes. Shorti hidhet në praninë e të gjithë anëtarëve të komisionit, nën kujdesin e kryetarit të tij. Në rastin kur kërkesa përmban kërkimin për pezullimin e magjistratit nga detyra, procedura e shortit në caktimin e relatorit të çështjes zhvillohet menjëherë.

3. Relatori verifikon nëse kërkesa plotëson kriteret formale të parashikuara në pikën 1 të këtij neni. Kërkesa që nuk plotëson këto kriteret konsiderohet e metë. Relatori njofton ILD-në, me shkrim, duke i caktuar një afat jo më shumë se 5 ditë për plotësimin e të metave të konstatuara. Në rast se ILD-ja plotëson të metat brenda afatit të caktuar, afati për fillimin e procedimit disiplinor, do të konsiderohet data e plotësimit të këtyre të metave. Në rast se ILD-ja nuk plotëson të metat brenda afatit 5-ditor të caktuar, Komisioni, menjëherë me propozim të relatorit, vendos kalimin e çështjes për vendimmarrje në Këshill. Këshilli vendos mbi pranueshmërinë e kërkesës së ILD-së, brenda 10 ditëve nga plotësimi i afatit të caktuar.

4. Në rast se konstatohet mosplotësim i kriterëve formale, Këshilli merr vendim për mospranimin e kërkesës së paraqitur nga ILD-ja.

Neni 25

Shqyrtimi paraprak i çështjes

1. Kur kërkesa vlerësohet se i plotëson kriteret formale, mbi bazën e relacionit të relatorit, Komisioni mund t'i propozojë Këshillit të vendosë, mbylljen e procedimit disiplinor pa seancë dëgjimore, sipas nenit 139 të ligjit “Për statusin” ose caktimin e seancës dëgjimore, e cila duhet të jetë brenda një muaji nga dita e marrjes së dosjes nga ILD-ja. Afati për caktimin e seancës dëgjimore, mund të zgjatet deri në dy muaj, për shkaqe të rëndësishme, të cilat bëhen publike.

2. Në rastin kur kërkesa e ILD-së plotëson kriteret formale të pranueshmërisë, Komisioni brenda 3 ditëve nga fillimi i procedimit, i propozon Këshillit marrjen e vendimit për caktimin e datës së seancës dëgjimore. Në këtë rast Këshilli duhet të mbajë në vlerësim:

a) njoftimin e palëve në procedurë për datën e seancës, të paktën 15 ditë para saj; si dhe

b) afatin brenda të cilit magjistrati duhet të paraqesë parashtrësat me shkrim sipas nenit 141, pika 2, germa “a”, të ligjit “Për statusin”.

3. Kur Këshilli mbyll procedimin disiplinor sipas, përcaktimeve të nenit 139 të ligjit “Për statusin”, merr vendim të arsyetuar me shkrim, i cili përmban shkaqet e mbylljes së procedimit.

4. Vendimet sipas këtij neni u njoftohen palëve në procedurë, brenda 5 ditëve, nga marrja e tyre.

Neni 26

Të drejtat e magjistratit pas vendimit të caktimit të seancës dëgjimore

1. Relatori, me njoftimin e vendimit të Këshillit për caktimin e seancës dëgjimore, i bën të ditur magjistratit të drejtat, si vijon:

a) të njihet me dokumentet e dosjes dhe të marrë kopje të tyre, brenda pesë ditëve nga paraqitja e kërkesës së tij;

b) të paraqesë parashtrësë me shkrim brenda një afati të caktuar;

c) të marrë pjesë në seancë dëgjimore;

ç) të thërrasë dëshmitarë, që mund të dëshmojnë fakte me interes për çështjen;

d) të paraqesë dokumente;

dh) të marrë masa të tjera për paraqitjen e provave në mbështetje të mbrojtjes së tij;



e) të përfaqësohet në seancë, sipas parashikimeve në Kodin e Procedurës Administrative;

ë) të kërkojë përjashtimin e relatorit, të një ose disa anëtarëve të Këshillit, nga pjesëmarrja në shqyrtimin e procedurës disiplinore, vetëm gjatë fazës paraprake të procesit, kur ekziston një nga shkaqet e nenit 174, të ligjit “Për qeverisjen” dhe anëtari nuk heq dorë vetë nga shqyrtimi i çështjes;

f) të kërkojë kompensimin e shpenzimeve të arsyeshme ligjore, në raste kur nuk vendoset masë disiplinore.

2. Komisioni, mbi propozimin e relatorit, mund të vendosë kufizimin e së drejtës së aksesit me dosjen vetëm në rastet dhe mënyrën e parashikuar në nenin 141, pika 1/1, të ligjit “Për statusin”. Magjistrati ka të drejtë të kërkojë ndryshimin e këtij vendimi nga mbledhja plenare e Këshillit, sipas nenit 191 të ligjit “Për qeverisjen”.

Neni 27

Veprimet paraprake

1. Veprimet paraprake janë të gjitha ato veprime procedurale, të cilat kanë si qëllim përgatitjen e çështjes për seancë dëgjimore. Ato kryhen nga ana e Komisionit, me anë të relatorit të çështjes.

2. Komisioni dhe relatori, në këtë fazë të procedurës, kujdesen për kryerjen e detyrave që lidhen me:

a) shqyrtimin e të gjithë faktorëve që kanë rëndësi për çështjen dhe të dokumentacionit të depozituar nga subjektet procedurale;

b) njoftimin e magjistratit të proceduar se ndaj tij ka filluar një procedim disiplinor, si dhe njoftimin e të drejtave të tij, sipas nenit 141, pika 2, e ligjit “Për statusin”;

c) njoftimin e subjekteve procedurale për vendimin e caktimit të seancës dëgjimore dhe afatin brenda të cilit magjistrati i proceduar duhet të paraqesë parashtrimit me shkrim;

ç) marrjen e vendimeve nga Këshilli, për:

i. pranueshmërinë e provave;

ii. thirrjen, angazhimin e ekspertëve dhe përcaktimin e detyrave të tyre, kur e konsideron të përshtatshme, ose kërkon nga ILD -ja thirrjen e ekspertëve;

iii. marrjen e provave shtesë, duke përfshirë edhe thirrjen e dëshmitarëve;

iv. kryerjen e hetimeve të mëtejshme nga ILD -ja, duke specifikuar elementet që mungojnë dhe afatin;

v. paraqitjen nga ana e magjistratit të të dhënave, dokumenteve ose çdo lloj prove, si marrjen pjesë të tij në seance dëgjimore në trajtimin e çështjes;

vi. bashkimin e procedimeve sipas nenit 140 të ligjit “Për statusin”;

vii. ndryshimin ose shtimin e objektit të procedimit disiplinor, sipas nenit 144 të ligjit “Për statusin”;

viii. pezullimin e procedimit disiplinor sipas neneve 145 dhe 126 të ligjit “Për statusin”;

d) kryerjen e çdo veprimi tjetër që vlerësohet i nevojshëm ose i përshtatshëm;

dh) si dhe përgatitjen e relacionit paraprak mbi çështjen, i cili duhet t’u vihet në dispozicion anëtarëve të Këshillit, jo më vonë se 7 ditë para datës së caktuar për zhvillimin e seancës dëgjimore. Ky relacion, përmban në mënyrë të përmbledhur:

i. të dhënat e subjekteve procedurale;

ii. objektin e kërkesës;

iii. parashtrimin e pretenduar të fakteve dhe rrethanave;

iv. pretendimet e organit procedues dhe parashikimet ligjore, mbi të cilat bazohet kërkimi;

v. parashtrimet e subjektit të proceduar;

vi. çështjet apo rrethanat për të cilat Komisioni, vlerëson se duhet të sqarohen në seancën dëgjimore;

vii. si dhe çdo propozim të Komisionit, për marrjen e vendimeve, sipas pikës 2, geramat “ç” dhe “d” të këtij neni.

Neni 28

Publiciteti i seancës

1. Seanca dëgjimore është publike.

2. Këshilli, kryesisht ose me kërkesë të palëve, mund të vendosë zhvillimin e seancës me dyer të mbyllura, në rastet:

a) kur publiciteti i seancës mund të dëmtojë moralin e shoqërisë ose mund të bëjë publike të dhëna sekrete në interes të sigurisë kombëtare, nëse kjo kërkohet nga autoritetet kompetente;

b) kur është e nevojshme të mbrohet e drejta e jetës private, të mbrohen të dhënat personale të magjistratit ose një personi tjetër;

c) kur nga publiku ka shfaqje që prishin zhvillimin normal të seancës dëgjimore.



3. Kur Këshilli zhvillon mbledhje me dyer të mbyllura, publiku dhe media largohen nga salla e mbledhjeve. Në çdo rast votimi është i hapur dhe publik.

Neni 29

Solemniteti i seancës

1. Gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore respektohen rregullat e solemnitetit, të cilat janë:

a) respektimi i orarit të caktuar për zhvillimin e seancës nga pjesëmarrësit;

b) respektimin e rendit dhe i qetësisë gjatë zhvillimit të seancës;

c) respektimin nga palët të kërkesave për të parashtruar në bazë të fakteve të pretenduara shpjegimet e nevojshme e të dobishme për shqyrtimin e çështjes;

ç) respektimin e anëtarëve të Këshillit dhe të të gjithë pjesëmarrësve të tjerë në gjykim;

d) mbajtjen e togës së posaçme nga avokatët dhe veshjes serioze dhe të përshtatshme nga pjesëmarrësit e tjerë në sallë.

2. Në rast se palët në seancë nuk respektojnë rregullat e solemnitetit, Kryetari i Këshillit merr masat për zhvillimin e duhur të seancës. Nëse është e nevojshme, ndërpret diskutimin ose u heq palëve të drejtën e fjalës, ose mund të urdhërojë largimin e personave nga salla.

3. Prania e shtypit të shkruar dhe elektronik në sallë, gjatë seancës dëgjimore publike, është e lejuar, për sa kohë nuk pengon zhvillimin normal të seancës. Regjistrimi audio, video dhe fotografimi nga mediet e pranishme, gjatë seancës, si rregull, nuk lejohet. Regjistrimi audio, video dhe fotografimi realizohen ,sipas rregullave të hollësishme të marrëdhënieve me medien, të miratuara me rregullore të posaçme të Këshillit.

4. Për sigurimin e solemnitetit dhe garantimin e zhvillimit normal të seancës, Kryetari i Këshillit ndihmohet nga punonjësi i ngarkuar për sigurinë dhe, në mungesë të tij nga drejtori i kabinetit të kryetarit, i cili kryen kryesisht detyrat e mëposhtme.

a) ndihmon në rregullimin e të pranishmëve në sallë;

b) ndihmon në shmangien e sjelljes së papërshtatshme të personave të pranishëm në sallë;

c) kryen çdo veprim tjetër të nevojshëm për mbarëvajtjen e seancës dëgjimore.

Neni 30

Zhvillimi i seancës dëgjimore

1. Kryetari, pasi deklaron hapjen e seancës dëgjimore, verifikon kuorumin e nevojshëm për zhvillimin e saj. Nëse ndonjë anëtar i Këshillit merr pjesë në mbledhje në distancë, kryetari merr masa për realizimin e këtij komunikimi.

2. Pas hapjes së seancës dëgjimore, kryetari i Këshillit, si drejtues i seancës, kryen këto veprime procedurale:

a) verifikon legjitimitimin procedural të palëve dhe të përfaqësuesve të tyre, sipas dispozitave të Kodit të Procedurës Administrative;

b) pyet palët nëse kanë ndonjë kërkesë procedurale, që lidhet me legjitimitimin apo zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor;

c) deklaron të hapur shqyrtimin e procedimit disiplinor;

ç) u bën të njohur palëve që përmbajtja e parashtrimeve me shkrim nuk përsëritet gjatë seancës dëgjimore, sipas nenit 142, pika 4 e ligjit, “Për statusin”;

d) u jep të drejtën e fjalës sipas radhës:

i. organit procedues, i cili paraqet argumentet që shkelja disiplinore është kryer dhe propozon masat disiplinore që duhet të merren;

ii. subjektit të proceduar ose përfaqësuesit të tij, për të paraqitur argumentet mbrojtëse. Në çdo rast magjistrati i proceduar ka të drejtën e fjalës i fundit.

iii. secilit prej anëtarëve të Këshillit që ka pyetje për palët, apo rrethana për të sqaruar. Fillimisht kjo e drejtë i jepet relatorit.

dh) komunikon vendimin e Këshillit:

i. për shtyrjen e seancës dëgjimore, në çdo rast jo më shumë se një muaj, kur e konsideron të nevojshme marrjen e provave shtesë;

ii. për administrimin e provave, që plotësojnë kushtet e pranueshmërisë, kanë lidhje me objektin e procedimit dhe kanë rëndësi në zgjidhjen e drejtë të çështjes;

iii. për thirrjen e ekspertëve dhe caktimin e detyrave;

iv. çdo vendim tjetër të marrë gjatë seancës dëgjimore;

e) mbyll fazën e shqyrtimit dhe fton palët për pretendimet e fundit;

ë) njofton datën e shpalljes së vendimit të arsyetuar, brenda 2 javëve nga data e mbylljes së seancës dëgjimore.



3. Këshilli, gjatë seancës dëgjimore, me kërkesë ose kryesisht, merr çdo vendim sipas nenit 36, pika 2, germa “ç” dhe “d”, të kësaj rregulloreje.

4. Për zhvillimin dhe dokumentimin e seancës dëgjimore respektohen, me aq sa është e mundur, dhe rregullat e parashikuara për zhvillimin e mbledhjeve plenare.

Neni 31

Përgjegjësia disiplinore e Magjistratit të Komanduar

1. Magjistrati i Komanduar ka përgjegjësi disiplinore të njëjtë me magjistratët që ushtrojnë detyrën si prokuror, në përputhje me parashikimet e dispozitave që rregullojnë përgjegjësinë disiplinore, sipas ligjit, “Për statusin”.

2. Ecuria disiplinore mund të fillohet edhe nga institucionin në të cilin prokurori i komanduar ushtron detyrën, sipas parashikimeve që zbatohen për anëtarët e institucionit në të cilin magjistrati është komanduar, në përputhje me nenin 53, pika 12, e ligjit, “Për statusin”.

3. Në rastet kur institucioni në të cilin magjistrati është komanduar propozon shkarkimin e magjistratit si masë disiplinore, magjistrati i komanduar mund të kërkojë referimin e çështjes në Këshill.

4. Në rast se magjistrati kërkon referimin e çështjes në Këshill, sipas përcaktimit të pikës 3 të këtij neni, atëherë procedimi disiplinor zhvillohet në përputhje me ligjin, “Për statusin”, pjesa V, “Përgjegjësia disiplinore, civile dhe penale”.

Institucioni në të cilin është komanduar magjistrati merr pjesë në procedurën disiplinore me të drejtat dhe detyrimet e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

5. Në rastet kur çështja nuk kërkohet të referohet në Këshill nga magjistrati, procedimi disiplinor zhvillohet nga institucioni në të cilin magjistrati është komanduar, sipas parashikimeve që zbatohen për anëtarët e institucionit në të cilin magjistrati është komanduar. Nëse në përfundim të procedimit disiplinor sipas kësaj pike, vendoset shkarkimi i magjistratit të komanduar, ky shkarkim sjell ndërprerjen e menjëhershme të komandimit të këtij magjistrati, i cili konstatohet me vendim të Këshillit.

Në këtë rast, secili anëtar i Këshillit ka të drejtë që, në përputhje me parashikimet ligjore të nenit

119 të ligjit “Për statusin”, të paraqesë ankesë tek ILD-ja, të shoqëruar me praktikën e plotë disiplinore si dhe vendimin e shkarkimit të magjistratit të komanduar.

Neni 32

Masat për shmangien e vonesave

1. Në rastet kur ndonjëra nga palët nuk paraqitet në seancë dëgjimore, ndonëse është njoftuar dhe nuk ka pasur shkaqe të ligjshme për t’u paraqitur, Këshilli deklaron mungesën dhe seanca zhvillohet pa praninë e palës.

2. Në rastin kur magjistrati ose përfaqësuesi i tij, dëshmitari, eksperti ose përkthyesi cenojnë dinjitetin e ILD-së ose të Këshillit, ose kryejnë ndonjë veprim, që në mënyrë të dukshme ka për qëllim të vonojë procedurën, Këshilli paralajmëron magjistratin dhe e udhëzon mbi pasojat e kësaj sjelljeje. Në rast se sjellja vazhdon, Këshilli vendos dënimin me gjobë deri në 100 000 lekë subjektin shkelës. Përsëritja e sjelljes përbën shkak për dhënie sërish të dënimit me gjobë dhe, nëse vlerësohet e përshtatshme, për fillimin e hetimit disiplinor ose penal.

3. Ndaj vendimit të dënimit me gjobë mund të ushtrohet ankimi brenda 24 orëve nga marrja dijani e tij në Gjykatën Administrative të Apelit. Këshilli i njofton vendimin për dënimin me gjobë Dhomës Kombëtare të Avokatisë ose institucioneve përgjegjëse për ekspertët ose përkthyesit.

Neni 33

Bashkimi i procedimeve disiplinore

Këshilli vendos bashkimin e procedimeve disiplinore, në rastet e mëposhtme:

a) procedimi disiplinor u referohet të njëjtave fakte dhe të njëjtut magjistrat të proceduar;

b) kur prokurori dhe gjyqtari janë të përfshirë në të njëjtën shkelje. Në këtë rast, të dy Këshillat vendosin bashkimin e procedimeve, sipas rregullave të përbashkëta të miratuara paraprakisht prej tyre.



Neni 34

Ndryshimi ose shtimi i objektit të procedimit disiplinor të magjistratit

1. Kur Këshilli çmon se çështja nuk mund të zgjidhet në mënyrë të drejtë dhe të rregullt, pa marrë në shqyrtim një ose disa pretendime të tjera për shkeljen disiplinore ndaj të njëjtit magjistrat, ka të drejtë:

a) të urdhërojë ILD-në të ndryshojë ose të shtojë objektin e procedimit disiplinor, në përputhje me ligjin, “Për statusin”, si dhe të hetojë këto pretendime të tjera të paktën brenda afatit një mujor;

b) të vendosë mbi pretendimet e ndryshuara ose të shtuara, nëse nuk është i nevojshëm hetim i mëtejshëm, pasi të ketë dëgjuar palët në procedim.

2. Në këto raste, ILD-ja vepron sipas parashikimeve të pikës 1, të nenit 136, të ligjit “Për statusin”:

a) kërkon të ndërpresë procedimin disiplinor, vendos për shtimin ose ndryshimin e objektit të hetimit, kryen hetimin e nevojshëm dhe paraqet raportin e hetimit të mëtejshëm brenda një muaji nga ndërprerja e procedimit;

b) i kërkon Këshillit që të shtojë ose ndryshojë objektin e hetimit, nëse nuk është e nevojshme kryerja e hetimeve të mëtejshme, pasi të ketë marrë mendimin e palëve.

Neni 35

Pezullimi i procedimit disiplinor

1. Këshilli vendos pezullimin e procedimit disiplinor kur është duke u zhvilluar hetim penal ose një proces gjyqësor penal, administrativ ose civil, ku njëra nga palët është magjistrati i proceduar dhe shkelja e dyshuar lidhet me të njëjtat fakte, për të cilat do të merret vendimi disiplinor.

2. Procedimi disiplinor pezullohet deri në administrimin nga Këshilli të vendimit të formës së prerë të institucionit kompetent.

3. Ankuesi, magjistrati i proceduar, gjykata, prokuroria dhe subjektet proceduese njoftohen me shkrim për vendimin e pezullimit, brenda 5 ditëve nga marrja e tij. Gjykata, prokuroria e interesuar ose institucione të tjera i dërgojnë Këshillit, pa vonesë, çdo vendim që merret gjatë hetimit dhe procesit përkatës.

4. Këshilli u referohet vetëm fakteve mbi të cilat bazohet vendimi i formës së prerë i gjykatës. Vendimi i formës së prerë i gjykatës, në favor të magjistratit të proceduar, nuk pengon procedimin disiplinor të Këshillit për të përcaktuar përgjegjësinë disiplinore të tij.

5. Vendimi për pezullimin e procedimit nuk ankimohet.

Neni 36

Marrja e vendimit në një procedim disiplinor

1. Këshilli vendos për datën e marrjes së vendimit, datë e cila caktohet brenda dy javëve nga përfundimi i seancës dëgjimore.

2. Komisioni miraton dhe i paraqet Këshillit brenda 4 ditëve nga përfundimi i seancës dëgjimore, relacionin përfundimtar si dhe projekt vendimin, bashkë me propozimin për vendimmarrje. Propozimi sipas këtij relacioni shqyrtohet në mbledhjen e radhës së Këshillit, por jo më vonë se 7 ditë nga data e paraqitja e relacionit përfundimtar të Komisionit.

3. Relatori i çështjes garanton aksesin e të gjithë anëtarëve të Këshillit në njohjen e akteve të administruara në dosje, gjatë shqyrtimit të çështjes dhe para marrjes së vendimit përfundimtar.

4. Pas shqyrtimit të fakteve dhe provave, Këshilli:

a) rrëzon kërkesën për procedim disiplinor, për shkak se faktet e pretenduara nuk kanë ndodhur ose ato nuk përbëjnë shkelje disiplinore;

b) pranon kërkesën dhe vendos një ose më shumë masa disiplinore.

5. Vendimi jepet i arsyetuar me shkrim, brenda dy javëve nga përfundimi i seancës dëgjimore.

Neni 37

Përgatitja e vendimit

1. Arsyetimi dhe zbardhja e plotë e vendimit bëhet nga relatori brenda dy javëve, nga data e përfundimit të seancës dëgjimore, sipas arsyetimit të shumicës së anëtarëve që kanë votuar pro vendimit.

2. Nëse pas votimit të vendimit, relatori është në pakicë, kryetari i Këshillit, cakton një anëtar tjetër nga shumica për të arsyetuar vendimin përfundimtar.



3. Anëtarët e mbetur në pakicë, mund të kërkojnë që opinioni i tyre kundër t'i bashkëngjitet vendimit të Këshillit. Në këtë rast, pakica është përgjegjëse për hartimin dhe dorëzimin të relatorit të opinionit të tyre brenda afatit të caktuar nga Këshilli për zbardhjen e vendimit. Në të njëjtën mënyrë veprohet edhe për rastin e mendimit paralel.

4. Anëtarët e Këshillit shqyrtojnë dhe miratojnë me anë të nënshkrimit versionin përfundimtar të vendimit.

Neni 38

Publikimi i vendimeve disiplinore

1. Këshilli publikon, brenda 2 javëve, çdo vendim të formës së prerë për shkarkimin e magistratëve në faqen zyrtare.

2. Këshilli publikon ekstrakte të çdo vendimi përfundimtar për çështje disiplinore, duke përcaktuar rrethanat e fakteve, provat e administruara, vlerën provuese të tyre, si dhe llojin e shkeljes disiplinore të kryer sipas këtyre fakteve. Botimi i ekstrakteve duhet të mbrojtë të dhënat personale dhe të garantojë mbrojtjen e konfidencialitetit. Në çdo rast në ekstrakt nuk botohet asnjë informacion që mund të tregojë identitetin e magistratit.

KREU IV

PROCEDURA TË VEÇANTA

SEKSIONI I

SHQYRTIMI ADMINISTRATIV I ANKIMEVE

Neni 39

Paraqitja e ankimit

1. Ankimi paraqitet nga pala ankuese ose nga përfaqësuesi i zgjedhur prej saj. Përfaqësuesi legjitimohet si i tillë dhe kryen disa ose të gjitha veprimet procedurale, sipas parashikimeve të nenit 38, të Kodit të Procedurës Administrative.

2. Çdo akt drejtuar Këshillit vlerësohet si ankim edhe nëse nuk është emërtuar shprehimisht si i tillë, por del nga përmbajtja e këtij akti dhe është mjaftueshëm i qartë. Ankimi paraqitet në formë të shkruar, në gjuhën shqipe, qartë dhe kuptueshëm, si dhe duhet të përmbajë:

a) adresimin e ankesës në Këshillin e Lartë të Prokurorisë;

b) emrin, atësinë, mbiemrin, vendbanimin ose vendqëndrimin e ankuesit dhe/ose të përfaqësuesit të tij, në rastin e personave fizikë;

c) emërtimin e personit juridik ankues, përfaqësuesin e tij ligjor, vendbanimin ose vendqëndrimin dhe/ose përfaqësuesin e zgjedhur;

ç) vendimin e ILD-së kundër të cilit paraqitet ankimi ose mosveprimin administrativ të ILD-së;

ç) parashtrimin e objektit dhe shkaqeve të ankimit;

d) aktet procedurale, të cilat i bashkëlidhen ankimit, të tilla si:

i. akti i përfaqësimit, në rast se ankimi paraqitet nga përfaqësuesi i zgjedhur i ankuesit;

ii. kopje të vendimit të ILD-së objekt ankimi;

iii. dokumente, prova apo materiale të tjera që shoqërojnë ankimin, në origjinal ose të njësuar me origjinalin;

dh) nënshkrimin e ankuesit ose të përfaqësuesit të tij, në rast se ankimi paraqitet prej këtij të fundit, sipas tagrave të dhëna shprehimisht në aktin e përfaqësimit.

Neni 40

Verifikimi i ankimit

Relatori verifikon nëse ankimi plotëson kriteret formale të parashikuara në pikën 2, të nenit 39, të kësaj rregulloreje. Ankimi që nuk plotëson këto kriteret konsiderohet i metë. Relatori njofton ankuesin, me shkrim, duke i caktuar një afat 10 ditë për plotësimin e të metave të konstatuara. Në rast se ankuesi nuk plotëson të metat brenda afatit të caktuar, mbi bazën e relacionin të relatorit, Komisioni i propozon mbledhjes plenare mospranimin e ankimit.

Neni 41

Shqyrtimi paraprak i ankimit

1. Pas verifikimit të kriterëve formale të ankimit, relatori verifikon kushtet e pranueshmërisë së tij për shqyrtim. Ankimi është i pranueshëm për shqyrtim nëse plotëson këto kushte:

a) është bërë kundër një vendimi apo mosveprimi administrativ të ILD-së;

b) ankuesi ka legjitimitet sipas parashikimeve të ligjit "Për statusin";



c) është paraqitur brenda afateve të parashikuara në ligj.

2. Për ankimin që nuk plotëson kushtet e pranueshmërisë, sipas pikës 1, të këtij neni, mbi relacionin e relatorit, Komisioni i propozon mbledhjes plenare, refuzimin e tij.

Neni 42

Pushimi i shqyrtimit të ankimit

1. Ankuesi mund të heqë dorë nga ankimi deri sa Këshilli nuk ka marrë një vendim, në lidhje me të. Në rast të heqjes dorë nga ankimi, Komisioni i propozon mbledhjes plenare pushimin e shqyrtimit të ankimit.

2. Në të njëjtën mënyrë veprohet edhe në rastin kur objekti për të cilin kishte nisur shqyrtimi ankimit apo qëllimi i tij është bërë i pamundur.

Neni 43

Shqyrtimi në themel i ankimit

1. Pas verifikimit të plotësisë të kushteve të pranueshmërisë, relatori përgatit relacionin dhe projekt aktin për shqyrtimin në themel të ankimit. Mbi relacionin e relatorit, Komisioni i propozon mbledhjes plenare pranimin ose rrëzimin e ankimit.

2. Në rastin e ankimit, mbi gjobën e vendosur nga ILD -ja ndaj personave apo subjekteve që nuk përmbushin kërkesat e tij, sipas nenit 132, pika 4, të ligjit “Për statusin”, relatori kërkon menjëherë nga ILD -ja, një kopje të akteve që kanë shërbyer për marrjen e vendimit.

3. Në rastin e ankimit ndaj mosveprimit administrativ, relatori i kërkon që menjëherë ILD -ja, të paraqesë pa vonesë një kopje të dosjes së çështjes dhe arsyet e mosveprimit administrativ.

Neni 44

Ankimi kundër vendimeve të arkivimit dhe pushimit të çështjes nga ILD-ja

1. Ankimet drejtuar Këshillit, që kundërshtojnë vendimin e ILD-së për arkivimin e ankesave ose pushimin/mbylljen e hetimit të filluar mbi bazën e tyre, shqyrtohen nga një komision i përkohshëm. Ky komision, përbëhet nga dy anëtarë joprokurorë dhe një anëtar prokuror.

2. Vendimet e këtij Komisioni janë përfundimtare dhe nuk mund të apeloohen para mbledhjes plenare të Këshillit.

3. Anëtarët e përhershëm dhe ata zëvendësues të Komisionit Disiplinor si rregull, nuk mund të jenë anëtarë të këtij komisioni të përkohshëm.

4. Në çdo rast anëtari i Komisionit Disiplinor, që ka marrë pjesë në komisionin e përkohshëm për trajtimin e një ankese si më sipër, nuk mund të marrë pjesë në mbledhje të Komisionit, dhe Këshillit, që shqyrton procedimin disiplinor, për të njëjtën çështje. Në këtë rast, ky anëtar zëvendësohet në këtë çështje në Komision nga anëtari zëvendësues, sipas përcaktimit të nenit 17 pikës 2, germa “b”, të kësaj rregulloreje.

5. Rregullat e parashikuara në këtë seksion zbatohen edhe nga ky Komision i përkohshëm, për aq sa gjejnë zbatim.

SEKSIONI II

SHQYRTIMI ADMINISTRATIV I KËRKESËS PËR PEZULLIMIN NGA DETYRA E MAGJISTRATIT

Neni 45

Paraqitja e kërkesës

1. Kërkesa për pezullimin e magjistratit nga detyra paraqitet në Këshill nga ILD-ja ose nga përfaqësuesi i autorizuar prej tij. Kërkesa duhet të jetë e argumentuar dhe i bashkëlidhet i gjithë dokumentacioni mbështetës shtesë, nëse ka, mbi të cilin është mbështetur vendimmarrja e ILD-së, sipas nenit 152, pika 1, e ligjit, “Për statusin”.

2. Pas regjistrimit, kërkesa i nënshtrohet menjëherë procedurës së shortit në Komision, për caktimin relatorit të çështjes, nëse paraqitet njëkohësisht me kërkesën për procedim disiplinor. Nëse procedimi disiplinor ka filluar, kërkesa i kalon menjëherë për shqyrtim relatorit të çështjes.

Neni 46

Shqyrtimi i kërkesës

1. Komisioni, brenda 48 orëve nga caktimi i relatorit të çështjes apo paraqitja e kërkesës, mbi relacionin e relatorit, i propozon mbledhjes plenare të Këshillit:

a) rrëzimin e kërkesës;



b) pranimin e kërkesës dhe pezullimin e magjistratit nga detyra.

2. Këshilli merr vendim në lidhje me kërkesën brenda 3 ditëve nga paraqitja e saj.

3. Këshilli vepron në të njëjtën procedurë edhe për rastet e pezullimit kryesisht të magjistratit nga detyra, sipas neneve 151 dhe 152 të ligjit “Për statusin”. Në këtë rast afatet llogariten nga dita e marrjes së informacionit nga ILD-ja apo prokuroria ose gjykata përkatëse ose nga konstatimi i rrethanave të parashikuara në nenin 152 të ligjit “Për statusin”.

4. Magjistrati ka të drejtë të ankimojë vendimin për pezullimin nga detyra në Gjykatën e Apelit Administrativ. Paraqitja e ankimit nuk pezullon ekzekutimin e vendimit.

Neni 47

Paraqitja dhe shqyrtimi i kërkesave në lidhje me kohëzgjatjen dhe revokimin e pezullimit

1. Kërkesa për ndryshimin e kohëzgjatjes së pezullimit apo revokimin e pezullimit paraqitet në Këshill nga ILD-ja apo magjistrati. Kërkesa duhet të jetë e argumentuar dhe i bashkëlidhet i gjithë dokumentacioni mbështetës shtesë, nëse ka, i cili duhet të provojë që pezullimi nuk mund të vazhdojë, për shkak se arsyet e vendosjes së pezullimit, të parashikuara në nenet 151 dhe 152 të ligjit “Për statusin”, kanë pushuar së ekzistuari.

2. Pas regjistrimit, kërkesa i kalon menjëherë për shqyrtim relatorit të çështjes.

3. Këshilli vepron në të njëjtën procedurë edhe për rastet e ndryshimit të kohëzgjatjes së pezullimit apo revokimit të pezullimit kryesisht, sipas nenit 156 të ligjit “Për statusin”.

4. Mbi relacionin e relatorit, Komisioni i propozon mbledhjes plenare, sipas rastit:

- a) ndryshimin e kohëzgjatjes së pezullimit;
- b) revokimin e pezullimit; ose
- c) lënien në fuqi të pezullimit.

Neni 48

Shqyrtimi i marrëveshjes së përbashkët të pranimit

Këshilli vepron në të njëjtën procedurë edhe për rastet e shqyrtimit të marrëveshjes së përbashkët të pranimit, sipas nenit 135 të ligjit “Për statusin”, për aq sa gjen zbatim.

KREU V DISPOZITAT E FUNDIT

Neni 49

Akte të tjera të zbatueshme

Në organizimin dhe në funksionimin e Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Komisionit Disiplinor dhe personelit administrativ, sipas kësaj rregulloreje, gjejnë zbatim rregullore të tjera të brendshme të Këshillit, për aq sa nuk parashikohet ndryshe në këtë rregullore.

Neni 50

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi në datën e botimit në Fletoren Zyrtare, si dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

VENDIM

Nr. 261, datë 17.11.2020

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR TRANSFERIMIN E PROKURORËVE NËPËRMJET PROCEDURËS SË LËVIZJES PARALELE”

Këshilli i Lartë i Prokurorisë bazuar në nenin 149/a, pika 1, shkronja “A”, të Kushtetutës, si edhe në nenet 42 dhe 43, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Komisionit të Karrierës,

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullore “Për transferimin e prokurorëve nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ky vendim hyn në fuqi në datën e botimit në Fletoren Zyrtare dhe publikohet edhe në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

**KRYETAR
Gent Ibrahimi**



RREGULLORE
PËR PROCEDURËN E LËVIZJES
PARALELE TË PROKURORËVE

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti

Ky akt përcakton rregulla të detajuara për kriteret dhe procedurën që zbaton Këshilli i Lartë i Prokurorisë për vlerësimin dhe renditjen e prokurorëve që kandidojnë për transferim nëpërmjet procedurës për lëvizje paralele, sipas ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Neni 2
Fusha e zbatimit

Rregullat e parashikuara në këtë Rregullore janë të zbatueshme për vlerësimin dhe renditjen e prokurorëve që kandidojnë dhe që përmbushin kushtet ligjore në procedurën për lëvizje paralele për çdo pozicion të lirë të përhershëm, për pozicionet që pritet të bëhen të përhershme, brenda 3 muajve, si dhe për aq sa është e mundur edhe për pozicionet e lira të përkohshme.

Këto rregulla zbatohen për prokurorët që kandidojnë dhe që përmbushin kushtet ligjore për lëvizjen paralele në pozicionet e mëposhtme:

- prokuror në një prokurori pranë gjykatës së shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm;
- prokuror në një prokurori pranë gjykatës së apelit të juridiksionit të përgjithshëm.

Neni 3
Subjektet

Subjekte të këtij vendimi janë prokurorët që kandidojnë për lëvizje paralele, sipas përcaktimeve të nenit 43, pika 2, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar dhe konkretisht:

- prokurorët pranë gjykatave të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm;

- prokurorët pranë gjykatave të apelit të juridiksionit të përgjithshëm;
- prokurorët e komanduar;
- prokurorët në skemë delegimi.

Neni 4
Përkufizime

Për qëllime të kësaj Rregulloreje, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

a) **“Dosje personale”** nënkupton dosjen e kandidatit, sipas përcaktimeve të nenit 38 të ligjit për statusin.

b) **“Këshilli”** është Këshilli i Lartë i Prokurorisë.

c) **“Komisioni”** është Komisioni i Zhvillimit të Karrierës pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

ç) **“Kandidat”** është prokurori që ka paraqitur kërkesën pranë Këshillit për lëvizje paralele.

d) **“Ligji për qeverisjen”** është ligji nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

e) **“Ligji për statusin”** është ligji nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

f) **“Lëvizje paralele”** është kalimi me kërkesë i prokurorit:

i. nga një pozicion në një prokurori të juridiksionit të përgjithshëm në një pozicion në një prokurori të juridiksionit të përgjithshëm të të njëjtut nivel;

ii. nga një pozicion i komanduar në një pozicion në një prokurori të të njëjtut nivel me atë të pozicionit që ka pasur përpara komandimit;

iii. nga një pozicion i komanduar përkohësisht sipas nenit 40 të ligjit për statusin në një pozicion në një prokurori pranë gjykatës të shkallës së parë;

iv. nga një pozicion në një prokurori pranë gjykatës të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm në një pozicion në një prokurori pranë gjykatës së apelit të juridiksionit të përgjithshëm, në rastin kur prokurori:

- është vlerësuar, të paktën dy herë, me vlerësim jo më të ulët se “shumë mirë”, në dy vlerësimet e fundit, si dhe ka përvojë profesionale, sipas parashikimit të nenit 47, pika 4, të ligjit për statusin;

- ka shërbyer në skemë delegimi për të paktën katër vjet dhe gjatë kësaj periudhe është caktuar, të paktën për një vit, në një pozicion në nivel apeli, si



dhe ka përvojë profesionale, sipas parashikimit të nenit 47, pika 4, të ligjit për statusin.

g) **“Nivel vlerësimi”** është rezultati i përgjithshëm i vlerësimit etik dhe profesional të prokurorit sipas sistemit të vlerësimit të kohës;

Në rastin e prokurorit të komanduar, njihet si nivel vlerësimi në kuptim të këtij vendimi, vlerësimi etik dhe profesional nga institucioni ku prokurori është komanduar.

Në rastin e prokurorit të riemëruar, që nuk i është nënshtruar vlerësimit etik dhe profesional ose prokurorit të komanduar që nuk ka vlerësim etik dhe profesional nga institucioni ku është komanduar, nivel vlerësimi në kuptim të kësaj rregulloreje do të konsiderohet vlerësimi i kryer nga Këshilli, sipas nenit 49 të ligjit për statusin.

h) **“Periudhë kalimtare”** nënkupton periudhën deri në realizimin e procedurave të vlerësimit sipas ligjit për statusin, por jo më vonë se afati i caktuar për përfundimin e procesit të rivlerësimit kalimtar të magistratëve, në përputhje me përcaktimin e nenit 25, të ligjit nr. 48/2019, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtareve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

i) **“Përvojë në pozicionet e komanduara”** nënkupton përvojën e veçantë të punës së kandidatit si prokuror i komanduar: në pozicionin e ndihmës magistratit në Gjykatën e Lartë, në Gjykatën Kushtetuese ose në Prokurorinë e Përgjithshme; në pozicionin e inspektorit në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë; në pozicione të tjera në Këshillin e Lartë Gjyqësor, në Këshillin e Lartë të Prokurorisë, në Ministrinë e Drejtësisë, në Avokaturën e Shtetit, në Shkollën e Magistraturës, në çdo institucion tjetër brenda sistemit të drejtësisë dhe përafrimit të legjislacionit, sipas nenit 53, pika 2; ose në një institucion tjetër të ndryshëm nga këto, kur komandimi është bërë për një interes publik, sipas nenit 54, pika 7, të ligjit për statusin.

j) **“Pikëzim”** nënkupton vlerësimin me pikë të secilit kriter sipas sistemit të vlerësimit etik dhe profesional të rregulluar nga ligji për statusin dhe vendimet e Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

k) **“Pozicion i lirë”** në kuptim të këtij vendimi nënkupton atë pozicion të lirë apo që pritet të bëhet i lirë brenda tre muajve, në një prokurori pranë gjykatës së shkallës së parë apo të apelit të juridiksionit të përgjithshëm, që mund të

plotësohet nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele.

l) **“Pozicion i lirë i përhershëm”** është pozicioni në një prokurori pranë gjykatës të juridiksionit të përgjithshëm, në të cilin nuk ka prokuror të caktuar në mënyrë të përhershme.

m) **“Pozicion i lirë i përkohshëm”** nënkupton pozicionin në një prokurori pranë një gjykate të juridiksionit të përgjithshëm, kur prokurori që e ka atë në mënyrë të përhershme është në pamundësi për të ushtruar funksionin për të paktën 3 muaj, por ka të drejtën për t’u kthyer.

n) **“Procedurë lëvizjeje paralele”** nënkupton procesin administrativ të verifikimit të kushteve ligjore të kandidimit për kandidatët për një pozicion të lirë, si dhe renditjen e kandidatëve të kualifikuar, me qëllim për të përzgjedhur kandidatin e renditur më lart.

o) **“Relator”** nënkupton anëtarin e përhershëm ose zëvendësues të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës.

p) **“Vendim verifikimi”** nënkupton vendimin e Këshillit të Lartë të Prokurorisë për kualifikimin ose skualifikimin e një kandidati, të marrë në përfundim të verifikimit të kushteve ligjore të kandidimit në një procedurë lëvizjeje paralele.

q) **“Vendim për renditjen e kandidatëve”** nënkupton vendimin e Këshillit të Lartë të Prokurorisë të marrë në përfundim të një procedure përzgjedhjeje për lëvizjen paralele, bazuar në 4 kriteret e përcaktuara në nenin 43, pika 7, 8 dhe 9, të ligjit për statusin, si dhe në rregullat e detajuara për kriteret dhe procedurën të përcaktuara në këtë rregullore.

r) **“Vendim për lëvizjen paralele”** nënkupton vendimin e Këshillit të Lartë të Prokurorisë për transferimin e kandidatit të renditur më lart në një procedurë përzgjedhjeje.

s) **“Vjetërsi si magistrat”** nënkupton përvojën e përgjithshme të punës së kandidatit, si prokuror ose gjyqtar, përfshirë edhe si i komanduar, si dhe si anëtar i Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

t) **“Vlerësim i mëparshëm”** vlerësimet më të fundit etike dhe profesionale të kandidatit, duke përfshirë edhe vlerësimin e përsheptuar të kandidatit sipas nenit 97 të ligjit për statusin; vlerësimin e kryer nga institucioni, në të cilin magistrati është komanduar, sipas nenit 53, pika 11, të ligjit për statusin si dhe vlerësimin e kandidatit të riemëruar ose të komanduar, sipas



nenit 49 të ligjit për statusin dhe rregullave të vendosura nga Këshilli.

KREU II RREGULLA TË PËRGJITHSHME TË PROCEDURËS SË LËVIZJES PARALELE

Neni 5

Shpallja e procedurës së lëvizjes paralele

1. Këshilli organizon, të paktën çdo 3 muaj, procedurën e lëvizjes paralele për çdo pozicion që është i lirë ose që pritet të bëhet i lirë brenda 3 muajve, në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm pranë gjykatave të shkallës së parë dhe të apelit, me përjashtim të rasteve, kur:

- a) nuk ka pozicion të lirë;
- b) kjo mund të passjell cenim të rëndë të funksionalitetit të prokurorive.

2. Për rastin përjashtimor të nenit 5 të shkronjës “b” të kësaj rregulloreje, Këshilli mund:

- a) të organizojë procedurën e lëvizjes paralele vetëm për disa nga pozicionet e lira;
- b) të shtyjë organizimin e procedurave të lëvizjes paralele për të gjitha pozicionet e lira deri në verifikimin e situatës së moscenimit të rëndë të funksionalitetit të gjykatave.

3. Shpallja e procedurës së lëvizjes paralele për çdo pozicion të lirë bëhet me vendim të Këshillit, mbi propozimin e Komisionit.

4. Në vendimin e hapjes së procedurës së lëvizjes paralele Këshilli përcakton:

- a) kushtet ligjore të kandidimit;
- b) afatin e kandidimit, i cili mund të jetë nga dy deri në katër javë nga data e shpalljes së procedurës;
- c) informacionin dhe dokumentacionin që i bashkëlidhet kandidimit;
- ç) procedurën e kandidimit dhe vendin e dorëzimit të dokumentacionit;
- d) të drejtën për të kandiduar deri në 3 pozicione të lira, duke i renditur ato sipas preferencës.

5. Nëse një kandidat rendit në kërkesën e tij më shumë se 3 pozicione të lira, atëherë Këshilli konsideron vetëm 3 pozicionet e para në renditje. Kur kandidati nuk ka renditur pozicionet sipas preferencës, pozicionet preferenciale do të vlerësohen sipas citimit në kërkesë. Në numrin e kandidimeve nuk llogaritet kandidimi i tërhequr.

Neni 6

Dokumentacioni i nevojshëm për kandidim

1. Kandidatët shprehin interesin për kandidim nëpërmjet një kërkesë, së cilës i bashkëlidh dokumentacionin e kërkuar nga Këshilli në vendimin për shpalljen e lëvizjes paralele, si dhe kopje të çdo dokumentacioni provues për aftësitë dhe kualifikimet e kandidatit që nuk gjenden në dosjen personale.

2. Komisioni, në çdo moment mund të kërkojë dokumentacion shtesë ose sqarime nga kandidatët, kur vlerëson se ai është i nevojshëm për procedurën e konkurrimit.

Neni 7

Radha e plotësimit të pozicioneve të lira

1. Komisioni identifikon pozicionet e lira apo që pritet të bëhen të lira, brenda 3 muajve. Pozicioni i lirë i përhershëm në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm plotësohet me radhë si më poshtë:

a) nga prokurori që transferohet për shkak të papajtueshmërisë ambientale apo për shkak të ndryshimeve në strukturën administrative ose në kompetencën tokësore të prokurorive;

b) nga një prokuror i caktuar përkohësisht në këtë pozicion, i cili paraqet kërkesë për caktimin e përhershëm, në rastin e ndryshimit nga Këshilli të këtij pozicioni nga i përkohshëm në të përhershëm sipas nenit 59 të ligjit për statusin;

c) nga magjistratët që transferohen për shkak të lëvizjes paralele.

2. Pozicioni i lirë i përhershëm në prokuroritë pranë gjykatave të apelit të juridiksionit të përgjithshëm plotësohet me radhë si më poshtë:

a) nga prokurori që ka të drejtën për t'u caktuar në një nivel apeli;

b) nga prokurori që transferohet për shkak të papajtueshmërisë ambientale apo për shkak të ndryshimeve në strukturën administrative ose në kompetencën tokësore të prokurorive;

c) nga një prokuror i caktuar përkohësisht në këtë pozicion, i cili paraqet kërkesë për caktimin e përhershëm, në rastin e ndryshimit nga Këshilli të këtij pozicioni nga i përkohshëm në të përhershëm sipas nenit 59 të ligjit për statusin;

ç) nga magjistratët që transferohen për shkak të lëvizjes paralele.



3. Pozicioni i lirë i përkohshëm, në prokuroritë pranë gjykatave të apelit dhe të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm, plotësohet fillimisht nga prokurori që ka të drejtën për t'u kthyer. Në vijim, ky pozicion plotësohet me radhë sipas rregullave të parashikuara nga pika 1 e kësaj rregulloreje për prokuroritë pranë gjykatës së shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm, si dhe sipas rregullave të parashikuara në pikën 2 të kësaj rregulloreje për prokuroritë pranë gjykatës së apelit të juridiksionit të përgjithshëm.

Neni 8

Kushtet ligjore për lëvizjen paralele të prokurorëve

1. Në procedurën e lëvizjes paralele për një pozicion të lirë mund të kandidojë çdo prokuror i cili përmbush kriteret e mëposhtme:

- a) të jetë prokuror i Republikës së Shqipërisë;
- b) të mos ketë masë disiplinore në fuqi;
- c) të mos ketë qenë anëtar i Këshillit në tri vitet e fundit;
- ç) të ketë të paktën një vit përvojë profesionale në fushën përkatëse të së drejtës gjatë 5 viteve të fundit, përveç rastit të parashikuar nga neni 40, pika 2, germa “b” e ligjit për statusin;
- d) të ketë paraqitur kërkesën për transferim nëpërmjet procedurës për lëvizje paralele për pozicionet e lira ose që priten të bëhen të lira sipas vendimit të Këshillit. Kandidati që nuk ka përcaktuar pozicionet për të cilat kandidon, do të konsiderohet se nuk ka paraqitur kërkesë në kuptim të këtij vendimi.

2. Në procedurën e lëvizjes paralele për një pozicion të lirë në prokuroritë pranë gjykatës së shkallës së dytë të juridiksionit të përgjithshëm, mund të kandidojë edhe prokurori pranë gjykatës së shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm, i cili plotëson njërin prej kushteve të mëposhtme:

- a) ka shërbyer në skemë delegimi për të paktën katër vjet dhe gjatë kësaj periudhe është caktuar, të paktën për një vit, në një pozicion në nivel apeli, si dhe ka përvojë profesionale, sipas parashikimit të nenit 47, pika 4, të ligjit për statusin;
- b) është vlerësuar, të paktën dy herë, me vlerësim jo më të ulët se “shumë mirë”, në dy vlerësimet e fundit, si dhe ka përvojë profesionale, sipas parashikimit të nenit 47, pika 4, të ligjit për statusin.

Neni 9

Fazat e procedurës së lëvizjes paralele

1. Procedura e lëvizjes paralele zhvillohet në tri faza, si më poshtë:

a) në fazën e parë bëhet verifikimi i kandidatëve për plotësimin e kushteve ligjore të kandidimit;

b) në fazën e dytë bëhet renditja e kandidatëve të kualifikuar, sipas numrit të vlerësimeve etike dhe profesionale. Konkretisht:

i. fillimisht shqyrtohen kandidimet e prokurorëve, të cilët kanë dy vlerësime etike dhe profesionale;

ii. nëse nuk ka kandidime nga prokurorë me dy vlerësime etike dhe profesionale, atëherë shqyrtohen kandidimet e prokurorëve të cilët kanë një vlerësim etik dhe profesional;

iii. nëse nuk ka as kandidime nga prokurorë me një vlerësim etik dhe profesional, atëherë shqyrtohen kandidimet e prokurorëve, të cilët nuk kanë asnjë vlerësim etik dhe profesional;

c) në fazën e tretë merret vendimi për transferimin e kandidatit të renditur më lartë.

2. Për çdo procedurë lëvizjeje paralele caktohet një relator me short.

3. Në ushtrimin e përgjegjësive të tij relatori ndihmohet nga Njësia Mbështetëse e Komisioneve dhe personeli administrativ i Këshillit, të cilët kanë detyrimin të ndjekin procedurat, të kryejnë veprimet dhe të përgatisin aktet përkatëse, sipas udhëzimeve të relatorit.

Neni 10

Parimet e renditjes së prokurorëve

Renditja e prokurorëve kryhet bazuar në parimin e pavarësisë, meritokracisë, promovimit dhe të zhvillimit të karrierës. Procesi i transferimit nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele mbështetet në parimet e efikasitetit, të procesit të rregullt ligjor, si dhe të parimit të konfidencialitetit.

Neni 11

Të drejtat e kandidatit

1. Kandidati njoftohet për relatorin e procedurës së lëvizjes paralele jo më vonë se 3 ditë nga caktimi i tij.

2. Kandidati ka të drejtë të kërkojë përjashtimin e relatorit për një nga shkaqet e parashikuara në



nenin 75 të ligjit për qeverisjen, jo më vonë së 3 ditë, nga marrja dijani e shkakut të përjashtimit, duke e shoqëruar kërkesën, kur është rasti, me aktet provuese të shkakut të përjashtimit. Këtë të drejtë kandidati e ka edhe ndaj çdo anëtari tjetër të Këshillit.

3. Këshilli vendos për kërkesën e kandidatit për përjashtimin e relatorit dhe/ose të çdo anëtari tjetër të Këshillit, jo më vonë së 7 ditë nga paraqitja e saj.

4. Kandidati ka të drejtë që, në çdo fazë të procedurës së lëvizjes paralele, me kërkesë, të njihet me dokumentet e dosjes së tij, si edhe të marrë kopje të tyre, sipas rregullave të Kodit të Procedurave Administrative.

5. Kandidati ka të drejtë që, në momentin e kandidimit për lëvizjen paralele, të kërkojë kryerjen e vlerësimit etik dhe profesional me procedurë të përshpejtuar, sipas parashikimeve të nenit 97 të ligjit për statusin dhe akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij. Në këtë rast kandidati duhet të ketë ushtruar detyrën përgjatë gjithë vitit të fundit kalendarik, si dhe të mos jetë vlerësuar për dy vitet e fundit kalendarike. Në këtë rast, procedura e përshpejtuar e vlerësimit të prokurorit kandidues bëhet pjesë e procedurës së lëvizjes paralele që zhvillon Këshilli për pozicionin e lirë.

6. Kandidati i komanduar, të cilit, gjatë apo në përfundim të komandimit, nuk i është bërë vlerësimi etik dhe profesional nga institucioni ku ai është komanduar, ka të drejtë që, në momentin e kandidimit për lëvizjen paralele, të kërkojë të vlerësohet për aftësitë profesionale si kandidati jogyqtar në Gjykatën e Lartë, sipas parashikimeve të nenit 49, të ligjit për statusin, për aq sa gjejnë zbatim, si dhe akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij. Në këtë rast periudha e komandimit duhet të ketë zgjatur jo më pak se një vit kalendarik.

7. Kandidati i riemëruar, i cili nuk ka një vlerësim etik dhe profesional si prokuror ose nuk ka një vlerësim profesional në momentin e riemërimit, nëse ka ushtruar këtë detyrë përgjatë gjithë vitit të fundit kalendarik, ka të drejtë që, në momentin e kandidimit për lëvizjen paralele, të kërkojë kryerjen e vlerësimit me procedurë të përshpejtuar, sipas parashikimeve të nenit 97 të ligjit për statusin dhe akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij. Nëse kandidati nuk ka ushtruar detyrën e prokurorit përgjatë gjithë vitit të fundit kalendarik, si dhe nëse para kandidimit ka jo më

pak se një vit përvojë profesionale, ai ka të drejtë të kërkojë të vlerësohet për aftësitë profesionale sipas parashikimeve të nenit 49, të ligjit për statusin, si dhe akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij.

8. Kryesisht, apo mbi kërkesën e Këshillit, kandidati ka të drejtë të paraqesë shpjegime me shkrim për fakte, rrethana apo çështje ligjore që lidhen me kushtet ligjore të kandidimit dhe/ose kriteret e renditjes, si dhe të depozitohë, kur është rasti, dokumente shkresore në mbështetje të këtyre shpjegimeve.

9. Kandidati ka të drejtë të tërhiqet nga kandidimi në çdo kohë, derisa nuk ka përfunduar procedura e lëvizjes paralele, duke depozituar kërkesën e tij me shkrim.

Neni 12

Dorëheqja dhe përjashtimi për shkak të konfliktit të interesit

1. Anëtari i Komisionit dhe/ose çdo anëtar tjetër i Këshillit, në çdo kohë kur merr dijani për ekzistencën e një konflikti interesi ose të një pengese ligjore sipas neneve 72, 73, 74 dhe 75, të ligjit për qeverisjen, është i detyruar të deklarojë natyrën e konfliktit të interesit ose pengesës dhe të heqë dorë nga pjesëmarrja në procedurën e lëvizjes paralele për atë pozicion të lirë.

2. Për dorëheqjen e çdo anëtari të Këshillit vendos kryetari i tij. Kur dorëheqjen e jep kryetari i Këshillit, vendimi merret nga zëvendëskryetari i tij.

3. Këshilli vendos për kërkesën e kandidatit për përjashtimin e një anëtari të tij.

4. Për nëpunësit e Njësisë Mbështetëse të Komisioneve dhe personelin administrativ të Këshillit zbatohen dispozitat e Kodit të Procedurave Administrative dhe të ligjit “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” mbi paanësinë e administratës publike.

Neni 13

Afatet

1. Afatet në procedurën e lëvizjes paralele caktohen në ditë, në javë ose në muaj. Përfundimi i afatit mund të përcaktohet edhe me një datë të caktuar kalendarike.



2. Kur afati caktohet në ditë, në llogaritjen e tij përjashtohet dita kur ka ndodhur ngjarja, nga e cila fillon të ecë afati.

3. Afati i përcaktuar në javë mbaron me kalimin e asaj dite, që është e njëjta me ditën, në të cilën ka ndodhur ngjarja, nga e cila ka filluar të ecë afati.

4. Afati i përcaktuar në muaj mbaron me kalimin e asaj dite, atij muaji, që ka të njëjtin numër me atë të ditës, në të cilën ka ndodhur ngjarja nga e cila ka filluar të ecë afati. Kur një ditë e tillë mungon në muajin e fundit, afati mbaron me kalimin e ditës së fundit të këtij muaji.

5. Të shtunat, të dielat dhe ditët e festave zyrtare nuk pengojnë fillimin dhe kohëzgjatjen e afateve. Kur dita e fundit e një afati bie e shtunë, e diel ose një ditë feste zyrtare, afati mbaron në ditën e punës që vjen pas saj.

6. Dita e fundit e afatit vazhdon deri në orën 24:00 të saj.

Neni 14 Njoftimet

1. Njoftimet dhe kërkesat e Këshillit drejtuar kandidatit dhe anasjelltas, si rregull bëhen në rrugë elektronike. Ato konsiderohen të marra ditën e nesërme të dërgimit në rrugë elektronike.

2. Adresa elektronike e Këshillit i bëhet e ditur kandidatit me njoftimin e fillimit të procedurës së lëvizjes paralele.

3. Adresë elektronike e kandidatit konsiderohet adresa zyrtare e tij, por ai mund të zgjedhë një adresë tjetër elektronike, duke ia bërë atë të ditur në kohë Këshillit. Kandidati merr masa për aksesueshmërinë e adresës së tij elektronike.

KREU III FAZA E PARË E PROCEDURËS SË LËVIZJES PARALELE

Neni 15 Fillimi i procedurës së verifikimit të kandidatëve dhe caktimi i relatorit

1. Këshilli, jo më vonë se 7 ditë nga përfundimi i afatit të kandidimit për një pozicion të lirë, vendos fillimin e verifikimit të kandidatëve për plotësimin e kushteve ligjore të kandidimit. Në këtë rast, Këshilli përcakton listën e kandidatëve që kanë kandiduar për pozicionin e lirë, duke mospërfshirë atë

kandidat që ka kandiduar jashtë afatit ose ka kandiduar për më shumë se tri pozicione të lira, sipas nenit 5 pika 4 e këtij vendimi. Kandidati që nuk përfshihet në listën e kandidatëve për atë pozicion të lirë, ka të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 5 ditëve, nga dita e njoftimit të vendimit.

2. Në të njëjtin vendim për fillimin e verifikimit të kandidatëve, Këshilli cakton relatorin për atë procedurë lëvizjeje paralele.

3. Përjashtimisht, për arsye të motivuara që lidhen me ngarkesën dhe efektivitetin e punës, mbi kërkesën e çdo anëtari të Komisionit, Këshilli mund të vendosë përjashtimin e tij nga shorti. Me propozimin e Komisionit, Këshilli mund të vendosë që në procedurat e shortit për caktimin e relatorit, të përfshihen edhe anëtarët zëvendësues të Komisionit.

Neni 16 Identifikimi i kandidatëve sipas numrit të vlerësimeve etike dhe profesionale

1. Relatori verifikon numrin e vlerësimeve etike dhe profesionale për secilin kandidat, duke bërë kategorizimin e tyre, sipas numrit të vlerësimeve që ata kanë, respektivisht me dy vlerësime, me një vlerësim dhe pa asnjë vlerësim. Verifikimi bazohet në të dhënat e dosjeve personale të kandidatëve. Në këtë rast, në llogaritjen e numrit të vlerësimeve etike dhe profesionale për çdo kandidat, relatori bazohet edhe në vendimin e Këshillit për përfshirjen e kandidatëve, mbi kërkesat e tyre, në programin e vlerësimit të përshpejtuar ose në kërkesën e kandidatit për kryerjen e vlerësimit sipas nenit 49 të ligjit për statusin.

Neni 17 Radha e shqyrtimit të kandidaturave

1. Procedura e lëvizjes paralele për një pozicion të lirë fillimisht vazhdon për kandidatët që kanë apo mund të kenë dy vlerësime etike dhe profesionale.

2. Në rastin kur për pozicionin e lirë nuk ka kandidatë që kanë apo mund të kenë dy vlerësime etike dhe profesionale, ose kur kandidatët e kësaj kategorie janë tërhequr nga kandidimi, ose kur ata nuk janë kualifikuar për mosplotësim të kritereve të kandidimit, procedura e lëvizjes paralele vazhdon



për kandidatët që kanë apo mund të kenë një vlerësim etik dhe profesional.

3. Nëse për arsyet e parashikuara në pikën 2 të këtij neni, procedura e lëvizjes paralele nuk mund të vazhdojë për kandidatin me një vlerësim etik dhe profesional, atëherë ajo vazhdon për kandidatët që nuk kanë asnjë vlerësim etik dhe profesional.

4. Nëse për të njëjtat arsye, procedura e lëvizjes paralele nuk mund të vazhdojë edhe për kandidatët pa asnjë vlerësim etik dhe profesional, atëherë ajo konsiderohet e përfunduar dhe pozicioni rishpallet përsëri.

5. Për pozicionet e lira në një prokurori pranë një gjykate të shkallës së dytë të juridiksionit të përgjithshëm, shqyrtohen në mënyrë të njëkohshme kandidimet e prokurorëve në nivel apeli me kandidimet e prokurorëve në shkallë të parë kur plotësojnë kushtet e përcaktuara në nenin 8 pika 2, germat “a” dhe “b” të kësaj rregulloreje.

6. Për plotësimin e pozicioneve të lira në një prokurori pranë një gjykate të shkallës së dytë të juridiksionit të përgjithshëm, zbatohen të njëjtat rregulla të parashikuara në pikat 1, 2, 3 dhe katër të këtij neni.

Neni 18

Veprimet procedurale të relatorit

1. Pas caktimit të relatorit, kandidati njoftohet për fillimin e verifikimit të kushteve ligjore të kandidimit, për relatorin e procedurës, si dhe për të drejtën që ka për të kërkuar përjashtimin e tij dhe/ose të çdo anëtarit tjetër të Këshillit, jo më vonë se 3 ditë nga njoftimi ose nga marrja dijeni e shkakut të përjashtimit, duke shoqëruar kërkesën, kur është rasti, me aktet provuese të shkakut të përjashtimit.

2. Relatori kujdeset për verifikimin e plotësimin nga kandidatët të kushteve ligjore të kandidimit dhe në veçanti, për:

a) administrimin dhe shqyrtimin e dokumentacionit që gjendet në dosjen personale të çdo kandidati apo dhe të atij që paraqitet nga ata gjatë verifikimit;

b) përgatitjen e relacionit për çdo kandidat, ku përkrahur veprimet e kryera dhe dokumentet e administruara gjatë verifikimit, si dhe një përmbledhje faktike të tyre për aq sa është e nevojshme për kualifikimin ose jo të kandidatit,

duke i bashkëlidhur relacionit kopje të këtyre dokumenteve;

c) përgatitjen e projektvendimeve për kualifikimin ose jo për çdo kandidat;

ç) koordinimin me kryetarin e Komisionit për përgatitjen e mbledhjes së Komisionit;

d) koordinimin me kryetarin e Këshillit për përgatitjen e mbledhjes plenare të Këshillit;

dh) njoftimet për kandidatët.

3. Në rastin e kandidatit, që ka kandiduar njëkohësisht në më shumë se një pozicion të lirë në proces shqyrtimi nga Këshilli, verifikimi i plotësimin nga ai të kushteve ligjore të kandidimit realizohet:

a) nga relatori i procedurës për të cilën verifikimi i kandidatëve ka filluar më parë, në rastin e procedurave me afate të ndryshme të kandidimit për ato pozicione;

b) nga relatori i procedurës për të cilën ka më pak kandidatë, në rastin e fillimit njëkohësisht të verifikimit të kandidatëve për ato pozicione dhe kur kjo nuk është e mundur, nga relatori i procedurës së hapur e para, sipas rendit kronologjik të vendimeve të Këshillit për ato pozicione.

Neni 19

Veprimet verifikuese të relatorit

1. Verifikimi i kandidatit në kuadër të një procedurë lëvizje paralele është i vlefshëm edhe për çdo procedurë tjetër kandidimi të njëkohshme për pozicione të lira të së njëjtës fushë të së drejtës.

2. Nëse nga shqyrtimi i dokumentacionit të dosjes personale, relatori vlerëson se ka mangësi, njofton menjëherë kandidatin, duke i caktuar një afat jo më shumë se 5 ditë, për të dhënë sqarime ose për të plotësuar mangësitë. Mungesa e përgjigjes së kandidatit nuk pengon vijimin e procedurës së përzgjedhjes për lëvizjen paralele.

3. Për verifikimin e kriterit të përvojës profesionale në fushën përkatëse të së drejtës të përshtatshme për pozicionin e lirë, relatori kërkon informacion dhe dokumentacion nga prokuroritë ku kandidati ka ushtruar detyrën ose institucioni ku ka qenë i komanduar.

4. Bazuar në gjetjet e verifikimit, nëse vlerëson që mund të procedohet me skualifikimin e kandidatit, pasi vë në dijeni Komisionin, me vendim të këtij të fundit, relatori njofton kandidatin lidhur me gjetjet paraprake dhe dokumentacionin përkatës, si edhe për të drejtën që, brenda një afati



5-ditor nga dita e njoftimit, të paraqesë në rrugë elektronike dhe/ose në zyrën përkatëse të Këshillit, qëndrimin dhe shpjegimet përkatëse lidhur me gjetjet e verifikimit, si edhe të çdo dokumentacioni mbështetës të nevojshëm sipas vlerësimit të tij.

5. Në pamundësi objektive ose për motive të tjera të justifikuara për të paraqitur qëndrimin dhe shpjegimet brenda afatit 5-ditor, kandidati njofton menjëherë Këshillin, duke i parashtruar edhe motivet përkatëse. Nëse motivet vlerësohen të justifikuara, relatori i cakton kandidatin një afat të ri të arsyeshëm për të paraqitur qëndrimet dhe shpjegimet lidhur me gjetjet e verifikimit.

6. Në rastin kur, në përfundim të afatit të caktuar, kandidati nuk parashtron shpjegime për gjetjet paraprake të verifikimit, relatori procedon me përgatitjen e relacionit mbi gjendjen e faktit dhe ligjin e zbatueshëm, duke e dërguar çështjen menjëherë për shqyrtim përpara Komisionit.

7. Kur kandidati njofton tërheqjen nga kandidimi, relatori përgatit relacionin ku përshtkruhen shkurtimisht veprimet e kryera dhe projektvendimin mbi përfundimin e procedurës së lëvizjes paralele për atë kandidat, duke e dërguar menjëherë për shqyrtim përpara Komisionit.

8. Në përfundim të verifikimit për çdo kandidat, relatori njofton kryetarin e Komisionit dhe i paraqet për shqyrtim Komisionit relacionin dhe dokumentacionin e administruar, si dhe projektvendimin për kualifikimin ose jo të kandidatin.

Neni 20

Shqyrtimi nga Komisioni

1. Kryetari i Komisionit, menjëherë pas njoftimit nga relatori për çështjen e përgatitur për shqyrtim, thërret mbledhjen e Komisionit, duke u kujdesur për njohjen e anëtarëve me materialet e çështjes.

2. Në mbledhjen e Komisionit, relatori paraqet përmbledhjen e veprimeve procedurale dhe verifikuese të kryera, si edhe të fakteve që kanë rezultuar gjatë verifikimit.

3. Komisioni, pasi dëgjon relatorin, nëse vlerëson që verifikimi dhe dokumentacioni përkatës është i paplotë, i kërkon relatorit plotësimin e verifikimit ose të dokumentacionit të nevojshëm, duke evidentuar sipas rastit veprimet verifikuese dhe/ose dokumentacionin, për të cilët

lind nevoja e plotësimit apo saktësimit. Në rast të kundërt, Komisioni vendos për kalimin e çështjes për shqyrtim në Këshill.

Neni 21

Shqyrtimi nga Këshilli

1. Kryetari i Këshillit, pas njoftimit nga relatori për çështjen e përgatitur për shqyrtim, thërret mbledhjen e Këshillit. Dita dhe koha e zhvillimit të mbledhjes së Këshillit, së bashku me relacionin e përgatitur nga relatori, i njoftohet kandidatin.

2. Në mbledhjen e Këshillit, relatori parashtron përmbledhjen e veprimeve procedurale të kryera, faktet që kanë rezultuar gjatë verifikimit të kandidatin, si dhe jep sqarime për pyetje të anëtarëve të Këshillit.

3. Nëse Këshilli vlerëson se verifikimi i kandidatin nuk është i plotë, ai cakton një seancë tjetër për shqyrtimin e çështjes. Në këtë rast, Këshilli ngarkon relatorin për plotësimin e mangësive të evidentuara. Në seancën e radhës për shqyrtimin e çështjes, relatori i bën të ditur Këshillit për plotësimin e mangësive të evidentuara.

4. Në përfundim të bisedimeve, Këshilli vendos për miratimin e projektvendimit të verifikimit të kandidatin sikundër ai është propozuar nga relatori apo me ndryshime, sipas propozimit të çdo anëtari. Në përfundim të votimit, kryetari deklaron rezultatin e votimit. Kur votat ndahen në mënyrë të barabartë, vota e kryetarit të Këshillit është përcaktuese.

5. Pas bisedimit dhe votimit, Këshilli vendos:

- a) kualifikimin e kandidatin në procedurën e lëvizjes paralele;
- b) skualifikimin e kandidatin nga procedura e lëvizjes paralele;
- c) përfundimin për kandidatin të procedurës së lëvizjes paralele për shkak të tërheqjes së tij nga kandidimi.

Neni 22

Vendimi i verifikimit dhe e drejta e ankimit

1. Vendimi i verifikimit arsyetohet, sipas kërkesave të nenit 99 të Kodit të Procedurave Administrative lidhur me formën dhe përmbajtjen e aktit administrativ.

2. Vendimi i verifikimit i njoftohet kandidatin sipas kërkesave të nenit 190 të ligjit për qeverisjen



dhe bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit, i shoqëruar me arsyetimin përkatës.

3. Ndaj vendimit të Këshillit për skualifikimin e kandidatit në procedurën e lëvizjes paralele, kandidati mund të bëjë ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 5 ditëve, nga dita e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

4. Në rastin kur Gjykata Administrative e Apelit pranon ankimin e kandidatit dhe shfuqizon vendimin, Këshilli, brenda dy javëve nga njoftimi i vendimit gjyqësor, rishikon vendimin e tij në masën e nevojshme për zbatimin e vendimmarrjes së gjykatës.

5. Vendimi i Këshillit për përfundimin e procedurës së lëvizjes paralele për kandidatin që tërhiqet nga kandidimi, është i paankimueshëm.

KREU IV FAZA E DYTË E PROCEDURËS SË LËVIZJES PARALELE

Neni 23

Fillimi i procedurës së përzgjedhjes

1. Procedura e përzgjedhjes fillon menjëherë pas përfundimit me vendim të formës së prerë të verifikimit të të gjithë kandidatëve dhe, kur është rasti, edhe të vlerësimit etik dhe profesional të tyre.

2. Në procedurën e përzgjedhjes përfshihen të gjithë kandidatët e kualifikuar.

Neni 24

Kriteret e renditjes së kandidatëve

1. Për zbatimin e kriterëve të renditjes së kandidatëve, sipas numrit të vlerësimeve etike dhe profesionale, si rregull konsiderohen vlerësimet e bëra, sipas ligjit për statusin dhe vendimeve përkatëse të Këshillit në zbatim të tij.

2. Kur Këshilli pranon kërkesën e kandidatit për kryerjen e vlerësimit etik dhe profesional, sipas parashikimit të nenet 11 pika 5, 6 dhe 7, të kësaj rregulloreje, vlerësimi i kandidatit bëhet pjesë e procedurës së lëvizjes paralele dhe ky vlerësim etik dhe profesional përfshihet në numrin e vlerësimeve të kandidatit.

3. Në rastin e kandidatit të komanduar, niveli i vlerësimit etik dhe profesional i institucionit ku është komanduar, njihet si nivel vlerësimi edhe në kuptim të kësaj rregulloreje, duke mbajtur në konsideratë në këtë rast nivelet e vlerësimit të institucionit sipas ligjit të tij të posaçëm dhe nivelet e vlerësimit, sipas sistemit të kohës për vlerësimin etik dhe profesional të prokurorëve. Në rastin kur niveli maksimal i vlerësimit etik dhe profesional në institucionin ku kandidati është komanduar është “shumë mirë”, konvertimi sipas sistemit të vlerësimit në fuqi (ligjit për statusin), bëhet sipas tabelës së mëposhtme:

Niveli i vlerësimit sipas sistemit të vlerësimit etik dhe profesional të institucionit ku magjistrati është komanduar	Niveli i vlerësimit sipas sistemit të vlerësimit etik dhe profesional në fuqi (ligjit për statusin)
Shumë mirë	Shkëlqyeshëm
Mirë	Mirë
Mjaftueshëm	Mjaftueshëm
I pamjaftueshëm	I pamjaftueshëm

Niveli i vlerësimit konvertohet në pikë sipas sistemit të vlerësimit në fuqi (ligjit për statusin) si më poshtë:

Niveli i vlerësimit	Pikët
Shkëlqyeshëm	100
Shumë mirë	89
Mirë	69
Mjaftueshëm	49
I pamjaftueshëm	29



4. Në rastin e kandidatit të komanduar si dhe të kandidatit të riemëruar, vlerësimi për aftësitë profesionale të të cilit kryhet nga Këshilli, sipas parashikimeve të nenit 49 të ligjit për statusin dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, nivelet e vlerësimit sipas pikëve janë si më poshtë:

Niveli i vlerësimit	Pikët
Shkëlqyeshëm	90–100
Shumë mirë	70–89
Mirë	50–69
Mjaftueshëm	30–49
I pamjaftueshëm	0–29

Neni 25

Hapat e renditjes së kandidatëve me dy vlerësime etike dhe profesionale

1. Për renditjen e kandidatëve me dy vlerësime etike dhe profesionale ndiqen deri në tre hapa, ku në secilin prej tyre bëhet një vlerësim krahasues i treguesve të kriterëve dhe përparësive të përcaktuara dhe të renditura në nenin 43, pika 7, të Ligjit për Statusin, si dhe të detajuara në këtë vendim.

2. Hapi pasues i renditjes ndiqet vetëm nëse në përfundim të hapit paraardhës nuk arrihet të bëhet renditja e kandidatëve me rezultate të njëjta më të larta.

Neni 26

Përparësitë e renditjes së kandidatëve për hapin e parë

1. Rënditja e kandidatëve bazohet në vlerësimin krahasues të niveleve të dy vlerësimeve të mëparshme etike dhe profesionale. Kandidati me nivelet më të larta të vlerësimit etik dhe profesional, renditet më lart.

2. Në rast se ka më shumë se një kandidat me rezultate të njëjta, për renditjen e kandidatëve me rezultatet më të larta zbatohen përparësitë sipas radhës së mëposhtme:

a) “niveli i vlerësimit të fundit”, sipas kësaj përparësie, kandidati me nivelin më të lartë të vlerësimit të fundit etik dhe profesional, renditet më lart;

b) “përvoja si prokuror i komanduar sipas nenit 53 të ligjit për statusin, si prokuror në skemën e delegimit sipas nenit 45, të ligjit për statusin ose si anëtar i Këshillit, që i ka mbaruar mandati tri vite përpara kandidimit”, sipas kësaj përparësie, kandidati që ka një nga këto përvoja, renditet më lart;

Faqe | 14560

c) “kohëzgjatja e përvojës si prokuror i komanduar, si prokuror në skemën e delegimit ose si anëtar i Këshillit”, sipas kësaj përparësie, kandidati me përvojën me kohëzgjatjen më të madhe në vite, renditet më lart;

ç) “shumëllojshmëria e përvojave si prokuror i komanduar, si prokuror në skemën e delegimit ose si anëtar i Këshillit”, sipas kësaj përparësie, kandidati që ka më shumë nga këto përvoja, renditet më lart.

3. Në rast se edhe pas zbatimit të përparësive, sipas pikave 1 dhe 2 të këtij neni ka më shumë se një kandidat me rezultate të njëjta, renditja e kandidatëve me rezultatet më të larta bazohet në pikëzim, sipas skemës së pikëve të miratuar nga Këshilli në lidhje me:

a) vlerësimin etik dhe profesional të prokurorëve, sipas ligjit për statusin;

b) vlerësimin etik dhe profesional të kandidatëve, sipas përcaktimeve të nenit 49, të ligjit për statusin.

Sipas kriterit të renditjes të parashikuar në këtë pikë, kandidati me totalin më të lartë të pikëve në dy vlerësimet e mëparshme etike dhe profesionale, renditet më lart.

Neni 27

Prokurori i komanduar

1. Përvoja si prokuror i komanduar, si prokuror në skemën e delegimit, ose si anëtar i Këshillit konsiderohet si përparësi në renditje sipas nenit 24, të këtij vendimi, vetëm në ato raste kur prokurori ka kryer të gjithë periudhën e komandimit ose të mandatit.

2. Prokurori konsiderohet se e ka kryer të gjithë periudhën e komandimit edhe në rastin kur Këshilli, kryesisht, për shkaqe të shpallura në



momentin e komandimit, ka përfunduar komandimin e tij para afatit.

Neni 28

Kriteri dhe përparësitë e renditjes së kandidatëve për hapin e dytë

1. Në rast se pas vlerësimit të bërë edhe nenit 26 të këtij vendimi, ka më shumë se një kandidat me rezultate të njëjta, renditja e kandidatëve me rezultatet më të larta bazohet në përvoja profesionale specifike që kërkohet për pozicionin e lirë.

2. Kandidati me përvojën profesionale specifike me kohëzgjatjen më të madhe, renditet më lart. Përvoja profesionale fillimisht vlerësohet sipas specifikave të pozicionit të lirë, për të cilin po zhvillohet procedura e lëvizjes paralele.

Neni 29

Kriteret dhe përparësitë e renditjes së kandidatëve për hapin e tretë

1. Në rast se edhe pas zbatimit të përparësive sipas nenit 28 të këtij vendimi, ka më shumë se një kandidat me rezultate të njëjta, Këshilli rendit kandidatët sipas vjetërsisë si magjistrat. Kandidati me vjetërsinë më të madhe renditet më lart.

2. Vjetërsia si magjistrat është treguesi që individualizon meritat e kandidatit në procedurën e lëvizjes paralele sipas kohëzgjatjes që ai ka ushtruar detyrën e prokurorit ose gjyqtarit, pavarësisht llojit të pozicionit.

3. Treguesi i vjetërsisë pikëzohet me radhë sipas kriterëve të mëposhtme:

- a) vjetërsia në detyrën e prokurorit;
- b) vjetërsia në detyrën e gjyqtarit.

4. Në vlerësimin e vjetërsisë në detyrën e prokurorit ose gjyqtarit sipas këtij neni përfshihet edhe përvoja në një pozicion të komanduar.

Neni 30

Vjetërsia si jurist

Në rast se edhe pas zbatimit të përparësive sipas nenit 29 të këtij vendimi, ka më shumë se një kandidat me rezultate të njëjta, renditja e kandidatëve bazohet në vjetërsinë si jurist. Kandidati me vjetërsinë më të madhe renditet më lart.

Neni 31

Intervista nga Këshilli

1. Në rast se pas vlerësimit të bërë edhe nenit 26 të kësaj rregulloreje, ka më shumë se një kandidat me rezultate të njëjta Komisioni paraqet në Këshill listën e kandidatëve të radhitur deri në këtë fazë.

2. Këshilli njofton për intervistë kandidatët dhe pas intervistës bën vlerësimin e tyre, duke vendosur përfundimisht për renditjen e kandidatëve.

Neni 32

Hapat e renditjes së kandidatëve me një vlerësim etik dhe profesional

1. Për renditjen e kandidatëve me një vlerësim etik dhe profesional ndiqen deri në tre hapa, ku në secilin prej tyre bëhet një vlerësim krahasues i treguesve të kriterëve dhe përparësive të përcaktuara dhe të renditura në nenin 43, pikat 7 dhe 8, të ligjit për statusin, si dhe të detajuara më poshtë në këtë vendim.

2. Hapi pasues i renditjes ndiqet vetëm nëse në përfundim të hapit paraardhës nuk arrihet të bëhet renditja e kandidatëve me rezultate të njëjta më të larta.

Neni 33

Kriteret dhe përparësitë e renditjes së kandidatëve për hapin e parë

1. Renditja e kandidatëve bëhet duke u bazuar njëkohësisht në vlerësimin krahasues të:

a) rezultatit të vlerësimit etik dhe profesional përkatës;

b) renditjes në listën e të diplomuarve në Shkollën e Magjistraturës ose në vlerësimin profesional në rastin e prokurorit të riemëruar sipas nenit 36 të ligjit për statusin.

2. Për kandidatin e komanduar dhe, kur është rasti, edhe atë të riemëruar, sa i përket vlerësimit etik dhe profesional, zbatohen rregullat sipas nenit 24 të kësaj rregulloreje.

3. Sipas kriterit të pikës 1 të këtij neni, kandidati me rezultatet më të larta sipas shkronjave “a” dhe “b”, të kësaj pike, renditet më lart.

4. Në rast se ka më shumë se një kandidat me rezultate të njëjta, për renditjen e kandidatëve me rezultatet më të larta zbatohen përparësitë sipas radhës së mëposhtme:



a) “niveli i vlerësimit etik dhe profesional”, sipas kësaj përparësie, kandidati që ka nivelin më të lartë të vlerësimit etik dhe profesional, sipas shkronjës “a”, të pikës 1, të këtij neni, renditet më lart;

b) “përvoja si prokuror i komanduar ose si prokuror në skemën e delegimit”, sipas kësaj përparësie, kandidati që ka një nga këto përvoja, renditet më lart;

c) “kohëzgjatja e përvojës si prokuror i komanduar ose si prokuror në skemën e delegimit”, sipas kësaj përparësie, kandidati me përvojën me kohëzgjatjen më të madhe në vite, renditet më lart;

ç) “shumëllojshmëria e përvojave si prokuror i komanduar ose si prokuror në skemën e delegimit”, sipas kësaj përparësie, kandidati që ka më shumë nga këto përvoja, renditet më lart.

5. Në rast se edhe pas zbatimit të përparësive sipas pikës 4 të këtij neni, ka më shumë se një kandidat me rezultate të njëjta, renditja e kandidatëve me rezultatet më të larta bazohet:

a) në skemën e pikëve të miratuar nga Këshilli, në lidhje me:

- vlerësimin etik dhe profesional të prokurorëve sipas ligjit për statusin;

- vlerësimin etik dhe profesional të kandidatëve sipas përcaktimeve të nenit 49 të ligjit për statusin;

b) në vlerësimin përfundimtar me pikë të bërë nga Shkolla e Magjistraturës pas vitit të tretë të programit të formimit fillestar. Sipas kriterit të renditjes të parashikuar në këtë pikë, kandidati me totalin më të lartë të pikëve në vlerësimin etik dhe profesional dhe në vlerësimin përfundimtar të Shkollës së Magjistraturës, renditet më lart.

Neni 34

Komandimi

Përvoja si prokuror i komanduar ose si prokuror në skemën e delegimit, konsiderohet si përparësi në renditje, sipas pikës 4 të nenit 33 të këtij vendimi, vetëm në ato raste kur prokurori ka kryer të gjithë periudhën e komandimit. Prokurori konsiderohet se ka kryer të gjithë periudhën e komandimit edhe në rastin kur Këshilli, kryesisht, për shkaqe të shpallura në momentin e komandimit, ka përfunduar komandimin e tij para afatit.

Neni 35

Kriteri dhe përparësitë e renditjes së kandidatëve për hapin e dytë

Në rast se pas vlerësimit të bërë edhe nenit 33 të këtij vendimi, ka më shumë se një kandidat me rezultate të njëjta, renditja e kandidatëve me rezultatet më të larta bazohet në përvojën profesionale specifike që kërkohet për pozicionin e lirë.

Kandidati me përvojën profesionale specifike me kohëzgjatjen më të madhe, renditet më lart. Përvoja profesionale fillimisht vlerësohet sipas specifikave të pozicionit të lirë, për të cilin po zhvillohet procedura e lëvizjes paralele

Neni 36

Kriteret dhe përparësitë e renditjes së kandidatëve për hapin e tretë

Në rast se pas vlerësimit të bërë edhe sipas nenit 35 të kësaj rregulloreje ka më shumë se një kandidat me rezultate të njëjta, renditja e kandidatëve me rezultatet më të larta bazohet në vjetërsinë si magjistrat. Kandidati me vjetërsinë më të madhe, renditet më lart. Zbatohen rregullat e parashikuara në pikat 2, 3 dhe 4 të nenit 29 të këtij vendimi.

Neni 37

Vjetërsia si jurist

Në rast se edhe pas zbatimit të përparësive sipas nenit 36 të këtij vendimi, ka më shumë se një kandidat me rezultate të njëjta, renditja e kandidatëve bazohet në vjetërsinë si jurist. Kandidati me vjetërsinë më të madhe renditet më lart.

Neni 38

Intervista nga Këshilli

1. Në rast se pas vlerësimit të bërë edhe nenit 37 të këtij vendimi, ka më shumë se një kandidat me rezultate të njëjta Komisioni paraqet në Këshill listën e kandidatëve të radhitur deri në këtë fazë.

2. Këshilli njofton për intervistë kandidatët dhe pas intervistës bën vlerësimin e tyre, duke vendosur përfundimisht për renditjen e kandidatëve.



Neni 39

Hapat e renditjes së kandidatëve pa asnjë vlerësim etik dhe profesional

Për renditjen e kandidatëve pa asnjë vlerësim etik dhe profesional ndiqet një hap, në të cilin bëhet një vlerësim krahasues i treguesve të kritereve dhe përparësive të përcaktuara dhe të renditura në nenin 43, pikat 7, 8 dhe 9, të ligjit për statusin dhe të detajuara më poshtë në këtë rregullore.

Neni 40

Kriteret dhe përparësitë e renditjes së kandidatëve për hapin e parë

1. Kandidatët pa asnjë vlerësim etik dhe profesional renditen duke u bazuar në renditjen në listën e të diplomuarve në Shkollën e Magjistraturës ose në vlerësimin profesional në rastin e magjistratit të riemëruar sipas nenit 36 të ligjit për statusin. Sipas këtij kriteri, kandidati me rezultatet më të larta, renditet më lart.

2. Në rast se ka më shumë se një kandidat me rezultate të njëjta, për renditjen e kandidatëve me rezultatet më të larta zbatohen përparësitë sipas radhës së mëposhtme:

a) “përvoja si prokuror i komanduar ose si prokuror në skemën e delegimit”, sipas kësaj përparësie, kandidati që ka një nga këto përvoja, renditet më lart;

b) “kohëzgjatja e përvojës si prokuror i komanduar ose si prokuror në skemën e delegimit”, sipas kësaj përparësie, kandidati me përvojën me kohëzgjatjen më të madhe në vite, renditet më lart;

c) “shumëllojshmëria e përvojave si prokuror i komanduar ose si prokuror në skemën e delegimit”, sipas kësaj përparësie, kandidati që ka më shumë nga këto përvoja, renditet më lart.

3. Përvoja si prokuror i komanduar ose si prokuror në skemën e delegimit, konsiderohet si përparësi në renditje sipas pikës 2 të këtij neni, vetëm në ato raste kur prokurori ka kryer të gjithë periudhën e komandimit. Prokurori konsiderohet se ka kryer të gjithë periudhën e komandimit edhe në rastin kur Këshilli, kryesisht, për shkaqe të shpallura në momentin e komandimit, ka përfunduar komandimin e tij para afatit. Zbatohen rregullat e parashikuara në pikat 2, 3 dhe 4, të nenit 29 të kësaj rregulloreje.

4. Në rast se edhe pas zbatimit të përparësive sipas pikës 2, të këtij vendimi, ka më shumë se një kandidat me rezultate të njëjta, renditja e kandidatëve me rezultatet më të larta bazohet në vlerësimin përfundimtar me pikë të bërë nga Shkolla e Magjistraturës pas vitit të tretë të programit të formimit fillestar.

Neni 41

Veprimet procedurale dhe verifikuese të relatorit

1. Në procedurën e përzgjedhjes së kandidatëve për lëvizjen paralele, relatori kujdeset në veçanti për:

a) administrimin dhe shqyrtimin e dokumentacionit të kandidatëve, që gjendet në dosjen e tyre personale apo që paraqitet nga ata gjatë procedurës së përzgjedhjes;

b) përgatitjen e relacionit që përmban përshkrimin e dokumenteve të administruara, si dhe një përmbledhje faktike të tyre për aq sa është e nevojshme për renditjen e kandidatëve, duke i bashkëlidhur atij kopje të këtyre dokumenteve;

c) përgatitjen e projektvendimit të renditjes së kandidatëve;

ç) koordinimin me kryetarin e Komisionit për përgatitjen e mbledhjes së Komisionit;

d) koordinimin me kryetarin e Këshillit për përgatitjen e mbledhjes plenare të Këshillit; dh) njoftimet për kandidatët.

2. Në procedurën e përzgjedhjes së kandidatëve për lëvizjen paralele janë të zbatueshme rregullat sipas nenit 19 pikat 2, 3, 7.

3. Në përfundim të vlerësimit për çdo kandidat, relatori njofton kryetarin e Komisionit dhe i paraqet për shqyrtim Komisionit relacionin dhe dokumentacionin e administruar, si dhe projektvendimin për renditjen e kandidatëve.

Neni 42

Shqyrtimi nga Komisioni i projektvendimit të renditjes së kandidatëve

Për shqyrtimin nga Komisioni të projektvendimit të renditjes së kandidatëve janë të zbatueshme rregullat e nenit 20, të këtij vendimi.



Neni 43

Shqyrtimi dhe miratimi nga Këshilli i projektvendimit të renditjes së kandidatëve

1. Për shqyrtimin nga Këshilli të projektvendimit të renditjes së kandidatëve janë të zbatueshme rregullat e nenit 21 për pikat 1, 2 dhe 3 të kësaj rregulloreje.

2. Këshilli vendos për miratimin e projektvendimit të renditjes të kandidatit sikundër ai është propozuar nga relatori apo me ndryshime, sipas propozimit të çdo anëtarit. Në përfundim të votimit, kryetari deklaron rezultatin e votimit. Kur votat ndahen në mënyrë të barabartë, vota e kryetarit të Këshillit është përcaktuese.

Neni 44

Vendimi për renditjen e kandidatëve dhe e drejta e ankimit

Për vendimin e renditjes së kandidatëve janë të zbatueshme rregullat e nenit 22 të këtij vendimi.

KREU V

FAZA E TRETË E PROCEDURËS SË LËVIZJES PARALELE

Neni 45

Vendimi i transferimit

1. Jo më vonë se 7 ditë nga marrja formë të prerë sipas ligjit të vendimit për renditjen e kandidatëve në një procedurë lëvizje paralele, mbi projektvendimin e përgatitur nga relatori, Këshilli merr vendim për transferimin në atë pozicion të lirë të kandidatit të renditur më lart.

2. Vendim i Këshillit i njoftohet prokurorit të transferuar, prokurorive respektive, si dhe bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit. Një kopje e vendimit bëhet pjesë e dosjes personale të prokurorit të transferuar.

KREU VI

DISPOZITA PËR PERIUdhËN KALIMTARE

Neni 46

Rregulla të përgjithshme

1. Gjatë periudhës kalimtare sipas nenit 25, paragrafi 3, i ligjit nr. 48/2019, për renditjen e kandidatëve në një procedurë lëvizje paralele zbatohen rregullat, sipas kreut IV, të kësaj rregulloreje, përveç sa parashikohet ndryshe në këtë krye.

2. Për zbatimin e kritereve të renditjes së kandidatëve sipas numrit të vlerësimeve etike dhe profesionale, si rregull konsiderohen vlerësimet e bëra sipas ligjit për statusin. Vlerësimet e mëparshme etike dhe profesionale të kandidatit të realizuara përpara hyrjes në fuqi të ligjit për statusin, konsiderohen të vlefshme për efekt të kësaj rregulloreje.

3. Procedura e lëvizjes paralele do të zhvillohet mbi bazën e vlerësimeve etike dhe profesionale ekzistuese, deri në miratimin e rregullave nga Këshilli, për:

a) vlerësimin etik dhe profesional të prokurorëve;

b) të vlerësimit etik dhe profesional të kandidatit me procedurë të përsheptuar, sipas nenit 97 të ligjit për statusin;

c) vlerësimin etik dhe profesional të kandidatëve, sipas përcaktimeve të nenit 49 të ligjit për statusin.

Neni 47

Konvertimi dhe pikëzimi

1. Konvertimi i niveleve të mëparshme të vlerësimit sipas sistemeve të mëparshme të vlerësimit etik dhe profesional me ato sipas sistemit të vlerësimit në fuqi bëhet sipas tabelës së mëposhtme:

Niveli i vlerësimit, sipas sistemeve të mëparshme të vlerësimit etik dhe profesional	Niveli i vlerësimit sipas sistemit të vlerësimit etik dhe profesional në fuqi (ligjit për statusin)
Nëse të gjithë kriteret e vlerësimit, sipas sistemit të mëparshëm janë “shumë mirë”	Shkëlqyeshëm
Nëse një nga kriteret e vlerësimit, sipas sistemit të mëparshëm është më pak se “shumë mirë”	Shumë mirë
Mirë	Mirë



Mjaftueshëm	Mjaftueshëm
I pamjaftueshëm	I pamjaftueshëm

2. Niveli i vlerësimit konvertohet në pikë sipas sistemit të vlerësimit në fuqi (ligjit për statusin) si më poshtë:

Niveli i vlerësimit	Pikët
Shkëlqyeshëm	100
Shumë mirë	89
Mirë	69
Mjaftueshëm	49
I pamjaftueshëm	29

Neni 48

Kandidatët e caktuar përkohësisht

Për kandidatët e caktuar përkohësisht sipas nenit 59 të ligjit për statusin përpara miratimit të kësaj rregullore për transferimin nëpërmjet procedurës për lëvizjen paralele, nuk do të aplikohen dispozitat e nenit 59, pikat 6 dhe 7, të ligjit për statusin.

Neni 49

Lëvizja paralele në vendet e lira të përkohshme

Kriteret dhe kushtet e përcaktuara në këtë rregullore zbatohen për sa është e mundur edhe për vendet e lira të përkohshme.

Neni 50

Të fundit

1. Për zbatimin e kësaj Rregulloreje ngarkohet Komisioni i Zhvillimit të Karrierës pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

2. Kjo rregullore hyn në fuqi në ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2020

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 320 lekë